



# Koha

www.koha.mk

**Sportistja  
shqiptare vazhdon  
të diskriminohet**

FAQE 12-13

E përditshme informative Viti XI • Numri 3137 • E hënë-e mërkurë 31 korrik-2 gusht 2017 15 DEN



## Fillojnë taktizimet për lokalet

Shkup, 30 korrik - Partitë politike si në taborin politik maqedonas ashtu dhe në atë shqiptar kanë filluar me përgatitjet partiake dhe kalkulimet e radhës në funksion të zgjedhjeve lokale, që me gjasë do të mbahen me 15 tetor të këtij viti. Te VMRO-ja opozitare, që aktualisht

mban mbi 90 % të komunave më shumicë maqedonase, së fundmi ka ndryshuar pothuajse gjysma e Komitetit Ekzekutiv, ku emrat më të përfolur në skandalin e përgjimeve u larguan nga organi më i lartë vendimmarrës partiak, si Gordana Jankullovka, Mile

Janakiveksi, Sasho Mijallkov, Martin Protugjer dhe disa të tjerë. Siç flitet në kuluaret e kësaj partie, këto lëvizje u bënë për shkak se në zgjedhje lokale duan të nxjerrin rezultat sa më pozitiv dhe nëse do t'i fitojnë, sërish me një distancë të theksuar me LSDM-në... **FAQE 3**

Lojërat e fatit, zgjidhje e problemeve, apo...

# Shpresa vdes e fundit



Nervozizëm i madh, lojë nervash gjatë tërë kohëzgjatjes së lojërave të ndryshme, sidomos të futbollit, dhe në fund në vend të gëzimit shkaktohet hidhërim dhe dëshpërim. Kjo është pasqyra e zakonshme në bastoret sportive që si zakonisht mund të vërehet në ditët e shtuna dhe të diela në tërë Maqedoninë. Sociologët thonë se në kushte kur njerëzve ju shteren mundësitë e tjera, ata ju kthehen lojërave të fatit **FAQE 3**

■ NË FOKUS

**Aliu dhe  
misteri i 40  
tonëve ar**



Si fillim në histori thuhet se Kalaja që tani ka marrë emrin e Porto Palermos është ndërtuar nga Ali Pashai si dhuratë për gruan e tij, Vasiliqinë, por a është e vërtetë kjo, apo është ndërtuar si fortesë për të mbrojtur diçka më të madhe, një thesar ndoshta? **FAQE 9**

■ GLOBI

**BE nis duelin  
juridik me  
Poloninë**

FAQE 15

■ RAJON

**Vetëvendosje  
po i vjelë  
tenderët  
millionësh  
në Komunën  
e Prishtinës**

FAQE 16

■ SPORT

**Ekstradimi  
i Morinës,  
i parregullt**



FAQE 11

## Pensionet e luftëtarëve më të larta se paga mesatare



Shkup, 30 korrik - Përfundimisht me muajin maj të këtij viti numri i përgjithshëm i pensionistëve kap shifrën prej 315 000, kurse pensioni mesatar është 13.000 mijë denarë. Pensione më të ulëta marrin bujqit, pensionistët e moshës, invalidët e punës, kurse pensione më të larta marrin per-

sonat pjesëmarrës në luftë. Statistikat e Fondit pensional tregojnë se në strukturë dominojnë shfrytëzuesit e pensioneve të moshës me 62 për qind, 24 për qind marrin pensione familjare, 12 për qind kanë pensione invalidore, ndërsa 0.48 për qind janë pensionistë të luftës, që njëherit marrin

edhe pensione më të larta në Maqedoni. Nga numri i përgjithshëm i pensionistëve, 190.000 apo 63 për qind marrin pensione në vlerë prej 10.775 denarë deri më 36 mijë denarë. Rreth 7 për qind e të pensionuarve marrin pensione në vlerë prej 8.437 denarë deri më 10.775 denarë. **FAQE 4**





Vlerësohet se lojërat e fatit popullarizohen sidomos në kohën e krizës dhe papunësisë së madhe, andaj edhe njerëzit shpesh në mbushjen e ndonjë tiketi shohin mundësinë që të fitojnë të holla shtesë, me të cilat do të paguajnë ndonjë borxh të mbetur privat apo ndaj shtetit.

Lojërat e fatit, zgjidhje e problemeve, apo...

# Shpresa vdes e fundit

**Nervozizëm i madh, lojë nervash gjatë tërë kohëzgjatjes së lojërave të ndryshme, sidomos të futbollit, dhe në fund në vend të gëzimit shkaktohet hidhërim dhe dëshpërim. Kjo është pasqyra e zakonshme në bastoret sportive që si zakonisht mund të vërehet në ditët e shtuna dhe të diela në tërë Maqedoninë. Sociologët thonë se në kushte kur njerëzve ju shteren mundësitë e tjera, ata ju kthehen lojërave të fatit**



vestimin e pak të hollave do të fitojnë shumë të madhe parash. Pikërisht ky sistem i lojërave të fatit mbështetet në atë psikologji, sidomos tek njerëzit që për çdo ditë ballafaqohen me probleme të ndryshme të mbi-jetesës", thotë sociologu Ilija Acevski.

Nga ana tjetër, hulumtimet e Qendrës për hulumtimin e politikave tregoi se pjesa më e madhe e qytetarëve që shkojnë në bastore janë të rinjtë, por nuk mbesin mbas as më të moshuarit dhe atë me status të rrezikuar social. Hulumtimet treguan se bile 72 për qind e qytetarëve shkojnë në bastore për shkaqe ekonomike, gjegjësisht të mungesës së mjeteve financiare.

Ndryshe, të dhënat tregojnë se qytetarët në Maqedoni për të dalë nga problemet financiare për çdo vit harxhojnë më shumë se 200 milion euro. Këtë e dëshmojnë edhe raportet financiare të bizneseve më të mëdha, sipas të cilave ndër 200 firmat me të ardhura më të mëdha në Maqedoni renditen edhe gjashtë biznese të lojërave të fatit. Gjashtë bizneset e bastoreve sportive dhe kazinove, në vitin e kaluar kanë pasur qarkullim prej afër 200 milionë euro, gjegjësisht qytetarët kanë harxhuar afër 200 milionë euro në shpresë se do dalin prej problemeve financiare.

Koha | **Fisnik PASHOLLI**

**Shkup, 30 korrik** – Të prirë nga fitimi gjoja shumë i lehtë, në vitet e fundit po mbushen plot e përplot ambientet jo vetëm të bastoreve sportive, por edhe ambientet ku luhen lojërat e fatit dhe bixhozi. Pamjet në bastore, sidomos në fundjavë janë të njëjta, të stërmbohura me lojtarë dhe me sytë e fiksuar ndaj ekraneve që tregojnë luhatjen e rezultateve të ndeshjeve të ndryshme sportive. Nervozizëm i madh, lojë nervash gjatë tërë kohëzgjatjes së lojërave të

ndryshme, sidomos të futbollit, dhe në fund në vend të gëzimit shkaktohet hidhërim dhe dëshpërim. Kjo është pasqyra e zakonshme në bastoret sportive që si zakonisht mund të vërehet në ditët e shtuna dhe të diela në tërë Maqedoninë. Sociologët thonë se në kushte kur njerëzve ju shteren mundësitë e tjera, ata ju kthehen lojërave të fatit. Këtë e dëshmon edhe rritja e madhe e numrit të bastoreve që mund t'i gjejsh në çdo cep të qyteteve dhe fshatrave në tërë Maqedoninë. Vlerësohet se lojërat e fatit popullarizohen sidomos në kohën e krizës dhe

papunësisë së madhe, andaj edhe njerëzit shpesh në mbushjen e ndonjë tiketi shohin mundësinë që të fitojnë të holla shtesë, me të cilat do të paguajnë ndonjë borxh të mbetur privat apo ndaj shtetit.

Bastoret sportive në vend kanë një ofertë të larmishme, duke filluar ligat më të fuqishme evropiane, siç janë kampionatet franceze, italiane, gjermane, angleze, por edhe të shumicës së ligave të futbollit në tërë botën, basketbollit, hendbollit, formula një, hokej, tenis, garave me qen etj. Në buletinet ekziston një përzgjedhje e madhe e

sporteve të ndryshme. Ofrohen edhe llojet e ndryshme të fitimit në rast se ia qëlloni se si do të përfundojë ndonjë lojë, sa gola do të shënohen si do të përfundojë pjesa e parë ose dytë e kështu me radhë. Çdo kush mund ta provojë fatin dhe në rast se fiton, atëherë të hollat i merr ditën e ardhshme. Në ndërkohë, sociologët thonë se luajtja e lojërave të fatit shpesh paraqet një iluzion të të varfërve për pasurim të shpejtë.

"Është një devizë e vjetër se kur njerëzit nuk kanë nga t'ia mbajnë dhe i kanë harxhuar të gjitha mundësitë, atëherë thjesht ngiiten për lojërat

e fatit", thotë sociologia Keti Arsovska.

Sociologët thonë se në momentet kur mjetet për jetesë nuk na mjaftojnë dhe kur humbet shpresa, atëherë qytetarët përpiqen që vetë të gjinden, duke i shfrytëzuar ato pak të holla që i kanë në disponim që të gjejnë fatin përmes vënies bast apo në tavolinën e lojërave të fatit.

"Luajtja e lojërave të fatit, sidomos është e lidhur me atë kategori të popullatës që është e varfër, dhe e përfshirë në aspektin social. Kjo veprimtari paraqet një hapësirë ku ata kërkojnë ndonjë shpresë se me in-

Analizë e institutit sloven IFIMES

## Maqedonia dhe BeH me hyrje të përshpejtuar në NATO dhe BE

**Lubjanë, 30 korrik** - Maqedonia dhe Bosnja e Hercegovina do të kenë trajtim të përshpejtuar në përgatitjet për hyrje në NATO dhe BE, vlerëson Instituti ndërkombëtar i Lubjanës për studime juglindore dhe ballkanike (IFIMES) në analizën e vizitës së paradokohshme të kryeministrit të Maqedonisë në Sarajevë. Në tekstin nën titull "Fryma e Zaevit po përhapet në BeH dhe rajon", Instituti thekson se vizita e kryeministrit të Maqedonisë në Sarajevë ka një sërë porosish gjeopolitike dhe i paralajmëron proceset e ardhshme politike në rajon. Me mbështetjen për Zaevin dhe Maqedoninë do të vihen në test të gjithë aktorët e Ballkanit Perëndimor, kështu edhe Serbia, përkatësisht presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, por edhe Shqipëria dhe kryeministri i saj, Edi Rama, konsideron IFIMES. "Vizita e Zaevit në BeH është një sinjal i llojit të vet, e ndoshta edhe i



fundit dhe udhërrëfyes për Aleksandar Vuçiq të kyçet dhe ta mbështesë rrugën e Maqedonisë dhe BeH-së drejt anëtarësimit të barabartë në BE dhe NATO", vlerësohet në analizë. Sipas IFIMES, në qarqe të caktuara ndërkombëtare ekziston koncepti, sipas të cilit, me

marrëveshje të re strategjike ndërmjet SHBA-së dhe Rusisë, Serbia do të mund të bëhet pjesë e sferës ruse të interesit përmes Organizatës së Marrëveshjes për siguri kolektive. Instituti, duke iu referuar "burimeve të besueshme" nga Brukseli dhe Uash-

ingtoni, në analizë pohon se tashmë po përgatiten vendime të caktuara të kahëzuara drejt ndryshimeve të Marrëveshjes së Dejtonit, me të cilën u përfundua Lufta në BeH në vitin 1995, para së gjithash në pjesën e cila ka të bëjë me lidhjet speciale paralele mes

### KUÇAN: BALLKANI MBETET FUÇI BARUTI, PROBLEM EDHE MAQEDONIA

Perëndimi vazhdon të mbyllë sytë para faktit se Ballkani Perëndimor edhe më tutje paraqet fuçi baruti, deklaroi ish-presidenti sloven, Millan Kučan në intervistë për gazetën e Podgoricës "Pobjeda". "Kam përshtypje se Brukseli në masë të madhe nuk i njeh gjendjet në Ballkanin Perëndimor, kështu që fitohet përshtypja se politika që po zbaton nuk është përherë parimore", thotë Kučan. Ai vlerëson se krahas BeH-së, pikë kryesore nevralgjike e Ballkanit është Kosova, ndërkaq "problem mbetet edhe Maqedonia". "Vendi i vetëm që mundi të ikë nga ai kazan është Mali i Zi", shton ish-presidenti sloven. Sipas Kučan, me insistimin e interesit të kapitalit, Evropa shpesh i lëshon vlerat etike në të cilat bazohet ideja evropiane.



shteteve nënshkruese të dokumentit dhe heqjes së tyre, përkatësisht anulimit të njëanshëm të vendeve të caktuara nga lidhjet paralele. Ato vendime,

sipas IFIMES, fillimisht kanë të bëjnë me Serbinë, për shkak të përmbajtshmërisë së saj ndaj NATO-s dhe lidhshmërisë politike me Rusinë.





Zgjedhjet lokale, mobilizim edhe pse nuk është caktuar data

# Fillojnë taktizimet për lokalet

Edhe pse 15 tetori është përfolur si datë kur duhet të mbahen zgjedhjet lokale, përderisa ato nuk janë caktuar, kjo datë vazhdon të mbetet e pasigurtë dhe mund të lëvizë. Kjo për shkakun, siç thonë burime brenda partive politike, u konvenon të gjithëve. Partitë në pushtet dëshirojnë të shtrijnë pushtetin, kurse opozita synon konsolidimin

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 30 korrik - Partitë politike si në taborin politik maqedonas ashtu dhe në atë shqiptar kanë filluar me përgatitjet partiake dhe kalkulimet e radhës në funksion të zgjedhjeve lokale, që me gjasë do të mbahen me 15 tetor të këtij viti. Te VMRO-ja opozitare, që aktualisht mban mbi 90 % të komunave me shumicë maqedonase, së fundmi ka ndryshuar pothuajse gjysma e Komitetit Ekzekutiv, ku emrat më të përfolur në skandalin e përgjimeve u larguan nga organi më i lartë vendimmarrës partiak, si Gordana Jankulovska, Mile Janakivski, Sasho Mijalkov, Martin Protugier dhe disa të tjerë. Siç flitet në kuluaret e kësaj partie, këto lëvizje u bënë për shkak se në zgjedhjet lokale duan të nxjerrin rezultat sa më pozitiv dhe nëse do t'i fitojnë, sërish me një distancë të theksuar me LSDM-në do të kërkojnë me ngulm zgjedhje të parakohshme parlamentare bashkë me zgjed-



hjet presidenciale që do të mbahen në prill të vitit të ardhshëm. Por të qenurit në opozitë për herë të parë pas vitit 2006, dhe pas skandalit të përgjimeve dhe krizës politike dhe institucionale nga viti 2014 e kënde, dhe kur kësaj i shtohet edhe fakti se disa prej funksionarëve më të latë partiak përfshirë dhe kryetarin e partisë Nikolla Gruevski aktualisht po ndiqen penalisht në Prokuroria Speciale Publike, kjo ka dhënë dhe efektet e para jo vetëm brenda në parti, por edhe në koalicion me partitë më të vogla, të cilat në disa cikle zgjedhore jo pak vota i kanë sjellë VMRO-së. Në këtë pikë flitet se partia e ish ministrit të mbrojtjes L Lazar Elenovski dhe disa parti tjera do të braktisin shumë shpejtë koalicion me VMRO-në dhe mund të kenë një afrim me partinë kundërshtarë LSDM para zgjedhjeve lokale. Nga ana tjetër, në taborin e majtë maqedonas të entuziazmuar nga fakti se kanë marr pushtetin pas më shumë se një dekadë

në opozitë, po shpresojnë se me ndërrimin e qindra kuadrove në poste udhëheqëse me të VMRO-së dhe më realizmin e disa premtimeve kyçe të zgjedhjeve parlamentare, si rritja e rrogës minimale, kthimi i TVSH-së sa një rrogë mesatare në fund të çdo viti, fillimi i rritje së rrogës mesatare, fillimi i reforma në gjyqësor dhe në media, krejt këto do t'u sigurojnë fitore në zgjedhjet lokale. Por vonesa disamujore në zgjedhjen e Qeverisë dhe distanca e shkurtër me datën 15 tetor, për të cilën kohë më parë janë marrë vesh me partitë tjera parlamentare, krejt këto ia vështirësojnë punën LSDM-së në shtrirjen e pushtetit. Prandaj, siç merr vesh gazeta KOHA nga burime partiake, në këtë parti seriozisht po shqyrtohet kohëve të fundit edhe një shtyrje tjetër e zgjedhjeve lokale. Po të njëjtat burime, me kusht anonimiteti, thonë se është e mundur që lokalet të mbahen bashkë me zgjedhjet presidenciale në mars apo

prill të vitit 2018-të. Po këto burime shtojnë se një shtyrje tjetër e zgjedhjeve lokale do t'i konvenonte edhe BDI-së e cila pas qeverisjes së gjatë me VMRO-në, po shpreson që bashkë me LSDM-në të realizojë disa premtime kyçe për shqiptarët, si ligji për gjuhën shqipe dhe investime më të mëdha në vendbanimet shqiptare, e me këtë të ngrit rejtungun e saj. Nga BDI flitet një kohë të gjatë se përzgjedhja e kandidatave për zgjedhjet lokale do të shkojë në dy kahe, njëra që do të kandidohen ish eksponentë të luftës së 2001-shit, dhe tjera në disa komuna do të kandidojnë njerëz më kredibilitet të lartë moral dhe profesional dhe jo kushtimisht të lidhur me strukturat partiake në nivel degës, por që janë figura që gëzojnë autoritet në popullatën lokale. Qasja e parë flitet se mbështetet nga zëvendëskryeministri për SMO Hazbi Lika, ndërsa qasja e dytë nga deputetë me kredibile si në këtë legjislaturë dhe atë para-

prake, që nuk duan të rrëshqas BDI edhe më shumë në grupacione lokale në nivel degësh dhe këshillash vendor. Sa i përket lëvizjeve me partitë tjera rreth koalicioneve të mundshme, ka zëra se BDI-do të bashkëpunojë por dhe mund të lidh koalicion parazgjedhor jo vetëm me RDK-në, por edhe me UNITETIN, por me këtë të fundit jo edhe nënkryetari Zylfi Adili dhe pjesa e madhe e strukturave e partiake që i shpallën besnikëri koalicionit Aleanca për Shqiptarët. Burimet të gazetës KOHA pranë partisë UNITETI thonë se LR-PDSH në kongresin e fundit veç më ka konfirmuar se është e gatshme që të punojë drejt kalimit të ASH-së në parti politike dhe pjesa më e madhe e strukturave të UNITETI-t do jenë pjesë e partisë së re, por se kjo do të dihet kur do të organizohet kongresi zgjedhor. Ndryshe, nga LR-PDSH flitet se kryetari i saj Zijadin Sela është e sigurt se do të garojë për kryetar të Komunës së Strugës, ndërsa sekretari i Përgjithshëm Arben Taravari për kryetar të Komunës së Gostivarit, ndërsa për kandidatura tjera si ajo e nënkryetarit Agon Ferati në komunën e Tetovës mbetet ende për t'u shqyrtuar dhe në fund do të shihet se kush do të kandidojnë nga BDI, PDSH dhe BESA në këtë komunë. Nga Lëvizja BESA ndonëse jozyrtarisht nuk japin emra dhe informacione, burime të gazetës KOHA në këtë flasin për kandidatura të sigurta të Bilall Kasamit në Komunën e Tetovës dhe Shaban Zendelit në

Komunën e Likovës, ndërsa në Komunën e Çarit, ku kjo parti pretendon fitore të sigurt, si emra më të mundshëm përmenden anëtarët e kryesisë, Kastriot Rexhepi dhe Skënder Rexhepi-Zejd, ndërsa në komunë Haraçinës BESA mund të garojë më ish kryetarin e kësaj komune Basri Bajramin. "Lëvizja BESA është në konsultim me të gjitha strukturat e saj, këshillat vendor dhe lokal gjithandej Maqedonisë për emra të mundshëm për kryetarë komunash. Deri tani nuk kemi ndonjë emër konkret, por opinioni do të jetë i njoftuar me kohë edhe për kandidatin e mundshëm, por edhe me ekspertë, të cilët do t'i qëndrojnë prapa kryetarit të komunës gjatë asaj fushate. Të gjitha emrat dhe lajmet që qarkullojnë në opinionin dhe portale të ndryshme janë dashakeqe dhe tendençioze dhe me siguri burojnë nga oponentët tanë politik, të cilët i ka kapur frika se do t'i humbin komunat e tyre", thotë për gazetën KOHA Faton Fazliu, shefi i kabinetit të kryetarit të Lëvizjes BESA. LR-PDSH kohë më parë ka theksuar për KOHA se do të garojë e vetme në zgjedhjet lokale, kurse BESA tha se synon t'i fitojë të gjitha komunat, ndërsa pas takimit të fundit mes Bilall Kasamit dhe Menduh Thaçit, janë shtuar zërat për një bashkëpunim të mundshëm mes këtyre dy partive opozitare. Ndryshe, kryetari i Parlamentit Talat Xhaferi, ka theksuar se më 6 gusht do të caktojë datën për mbajtjen e zgjedhjeve lokale.

## Ja ku do të pushojnë kryeministri Zaev dhe ministrat

Shkup, 30 korrik - Kryeministri, Zoran Zaev, pushimin vjetor do ta shfrytëzojë prej më 3 deri më 6 gusht dhe me familjen e tij do të qëndrojë në Ohër. Nëse ia lejojnë obligimet e punës ai do të shfrytëzojë edhe një pjesë të fundjavave gjatë gushtit, kumtoi Sektori qeveritar për marrëdhënie me opinionin, i cili informoi edhe për pushimet vjetore të ministrave. Zëvendëskryetarja e Qeverisë dhe ministrja e Mbrojtjes, Radmila Shekerinska Jankovska, do t'i shfrytëzojë pesë ditë për pushim me familjen të cilin do ta kalojë në Greqi. Zëvendëskryetari i Qeverisë, i obliguar për Çështje ekonomike dhe koordinim me resorët ekonomik, Koço Angjushhev, për pushim do t'i shfrytëzojë vetëm fundjavat në gusht, pa ndonjë



destinacion të caktuar. Zëvendëskryetari i Qeverisë, i obliguar për Çështje Evropiane, Bujar Osmani, nuk do të shfrytëzojë pushim klasik, por nëse e lejojnë obligimet e punës, do t'i shfrytëzojë disa fundjava, me siguri në Shqipëri. Ministri i Financave, Dragan Tevdovski, disa ditë me familjen do të qëndrojnë në Greqi, ndërsa min-

istri i obliguar për Komunikime, Transparençë dhe Llogaridhënie, Robert Popovski, nuk do të shfrytëzojë pushim zyrtar, por do t'i shfrytëzojë fundjavat e gushtit që t'i kalojë disa ditë me familjen në lokacione në Maqedoni dhe Greqi. Ministri i Shëndetësisë, Arben Taravari, pushimin do ta kalojë në Bullgari. Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe

Ekonomisë së Ujërave Lupço Nikollovski, pushimin e tij do ta shfrytëzojë në gusht, ndërsa lokacionin nuk e ka përcaktuar akoma. Në Greqi për disa ditë pushim me familjen do të udhëtojë edhe ministri i Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov, si dhe ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Damjan Mançevski, ndërsa në Shqipëri dhe në Strugë do të pushojë ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi. Ministri i obliguar për Diasporën, Edmond Ademi do t'i shfrytëzojë katër ditë për pushim në Greqi, ndërsa planifikon një fundjavë ta ndajë edhe për Open Festivalin në Strumicë. Ministri i Punëve dhe Politikës Sociale, Milla Carovska pushimin në kohëzgjatje prej pesë ditësh do ta shfrytëzojë

gjatë gushtit, ndërsa lokacionin nuk e ka përcaktuar akoma. Pesë ditë do t'i shfrytëzojë edhe ministri i Kulturës, Robert Allagiovski, në një lokacion afër Selanikut në Greqi. Ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugareski do të shfrytëzojë ditë gjatë gushtit, por akoma nuk ka vendosur se në cilin lokacion. Ministri pa resor i obliguar për Investime të Huaja, Ramiz Merko disa ditë do t'i kalojë me familjen në Strugë. Ministri pa resor për Investime të Huaja, Zorica Apostollska do ta shfrytëzojë javën e fundit të gushtit të shkojë në pushim me familjen dhe do t'i vizitojë shtëpitë familjare në Oteshevë dhe Llazaropole. Dy fundjava të zgjatura gjatë gushtit do t'i shfrytëzojë ministri pa resor i obliguar për përmirësimin e klimës in-

vestuese për ndërmarrjet vendore, Zoran Shapuriq. Pushimin nuk do ta shfrytëzojë ministri pa resor i obliguar për përmirësimin e gjendjes me romët, Samka Ibrahimovski. Deri më tani pushimin nuk e kanë planifikuar edhe ministri i Punëve të Brendshme Oliver Spasovski, ministri i Vetëqeverisjes Lokale Suhejl Fazliu, ministrja e Arsimit dhe Shkencës Renata Treanska Deskovska, ministri i Drejtësisë Bilan Salji dhe zëvendëskryetari i Qeverisë, i obliguar për zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit dhe Sistemit politik, Hazbi Lika. Pushim nuk do të shfrytëzojë edhe ministri pa resor i obliguar për investime të huaja, Adnan Qahili, kumtoi Sektori për marrëdhënie me opinionin në kuadër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.





Pensioni mesatar 13 mijë denarë, kurse rroga 370 euro

# Pensionet e luftëtarëve më të larta se paga mesatare

Nga numri i përgjithshëm i pensionistëve, 190.000 apo 63 për qind marrin pensione në vlerë prej 10.775 denarë deri më 36 mijë denarë. Rreth 7 për qind e të pensionuarve marrin pensione në vlerë prej 8.437 denarë deri më 10.775 denarë. Ndërkaq, 0.6 për qind nga numri i përgjithshëm i pensionistëve marrin pensione të larta nga 36.000 denarë deri më 47.000 denarë, respektivisht këto janë 18 mijë persona që marrin pensione lufte



**Koha** Zejnulla VESELI

Shkup, 30 korrik – Përfundimisht me muajin maj të këtij viti numri i përgjithshëm i pensionistëve kap shifrën prej 315 000, kurse pensioni mesatar është 13.000 mijë denarë. Pensione më të ulëta marrin bujqit, pensionistët e moshës, invalide të punës, kurse pensione më të larta marrin personat pjesëmarrës në luftë. Statistikat e Fondit pensional tregojnë se në strukturë dominojnë shfrytëzuesit e pensioneve të moshës me 62 për qind, 24 për qind marrin pensione familjare, 12 për qind kanë

pensione invalide, ndërsa 0.48 për qind janë pensionistë të luftës, që njëherit marrin edhe pensione më të larta në Maqedoni. Nga numri i përgjithshëm i pensionistëve, 190.000 apo 63 për qind marrin pensione në vlerë prej 10.775 denarë deri më 36 mijë denarë. Rreth 7 për qind e të pensionuarve marrin pensione në vlerë prej 8.437 denarë deri më 10.775 denarë. Ndërkaq, 0.6 për qind nga numri i përgjithshëm i pensionistëve marrin pensione të larta nga 36.000 denarë deri më 47.000 denarë, respektivisht këto janë 18 mijë persona që marrin pensione lufte. Në anën tjetër, rroga mesatare në Maqedoni e paguar në muajin maj ka qenë 32.393 denarë apo 370 euro, që krahasuar më

muajin prill është për 5 për qind më e lartë. Sipas të dhënave të Entit statistikor rritja e rrogës mesatare është falë rritjes së rrogave në sektorin e komunikimeve dhe të informacioneve, në administratën publike dhe mbrojtje, sigurimin e detyrueshëm social dhe në xehetari. Megjithatë edhe pse të dhënat statistikore tregojnë rritje të rrogës mesatare në Maqedoni ekspertët ekonomik shprehën se bëhet fjalë vetëm për numra statistikore të cilat nuk e pasqyrojnë gjendjen reale me të ardhurat mujore në vend kur kemi parasysh se 70 për qind e punëtorëve marrin rrogë më të vogël se 370 euro. Sipas të dhënave statistikore rroga më të larta, mbi 600 euro marrin të punësuarit në sektorët e informacioneve, ko-

munikimeve, në veprimtaritë financiare dhe në furnizimin me energji elektrike, ndërsa pas tyre me të ardhura mesatare më të larta se 400 euro janë të punësuarit në administratën publike, mbrojtje dhe shëndetësi. Në këtë shkallë, sipas lartësisë së rrogës në fund gjenden të punësuarit në bujqësi. Eksperti ekonomik Branimir Jovanoviq konsideron se rroga mesatare në Maqedoni është vetëm matje statistikore që nuk e pasqyron gjendjen reale, duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e të punësuarve marrin rroga më të ulëta se mesatarja, ndërsa vetëm një pjesë e vogël kanë të ardhura të larta mujore, që e rrit mesataren në nivel të gjithë vendit. "Po, rroga mesatare është rreth 22.000-23.000

denarë, që ndoshta nuk duket e vogël, mirëpo shumë më me rëndësi është se si është e shpërndarë ajo. E shpërndarja është e tillë që gjysma e punëtorëve kanë rrogë që është më e ulët se 16.000, e madje 70 për qind e të punësuarve në Maqedoni kanë rrogë që është më e ulët se 22.000 denarë. Prandaj, shuma relativisht e lartë e rrogës mesatare nuk është reprezentative për rrogat e numrit më të madh të punëtorëve. Ajo është e lartë për shkak se ka një numër të vogël të punësuarish që kanë rroga jashtëzakonisht të larta. Nga të dhënat e DHP-së për vitin 2012 që janë të dhënat e fundit, mund të shihet se rroga më e lartë atë vit ka qenë 80.000 euro në muaj. Po ashtu, 14.000 persona me të ardhurat më të larta atë vit kanë pasur të ardhura të përgjithshme prej rreth 500 milionë eurosh, gjegjësisht të ardhura mesatare mujore prej rreth 3.000 eurosh. Këta janë ata që e ngrënë mesataren e rrogës", thotë Jovanoviq. Edhe analiza e fundit e Bankës Popullore të Maqedonisë (BPM) rezultoi se vetëm 1,2 për qind e të punësuarve marrin rroga më të lartë se 40.000 denarë. "Sipas lartësisë së rrogës mesatare neto, rreth

60 për qind e të punësuarve marrin rrogë neto prej 8.000 deri në 20.000 denarë, që është nën rrogën mesatare për vitin 2017. Kundrejt kësaj, vetëm 16,2 për qind e të punësuarve kanë rrogë të barabartë ose më të madhe se sa rroga mesatare neto. Nga ana tjetër, në kategorinë e të ardhurave më të larta mujore mbi 40.000 denarë bëjnë pjesë vetëm 1,2 për qind e numrit të përgjithshëm të të punësuarve", thuhet në analizën e BPM-së. Arsyeja se pse nuk janë të realta statistikatat për rrogën mesatare në Maqedoni sipas Jovanoviq është për shkak se gjithë kohën Qeveria e mëparshme ka zhvilluar politikë ekonomike që shkojnë në favor të pronarëve të kapitalit, e jo të punëtorëve. "Problemi tjetër me rrogat në Maqedoni është se ato janë tepër të ulëta në krahasim me profitet e kompanive. Maqedonia është njëra nga vendet e rralla në Evropë ku profitet e kompanive janë më të larta se sa rrogat e punëtorëve. Profitet në vitin 2016 informata e fundit kanë qenë 190 miliardë denarë, ndërsa mjetet e punëtorëve 176 miliardë denarë", thotë Branimir Jovanoviq, ekspert ekonomik.

## "Dyftytërsia" e politikanëve rrënon vlerat morale

Ndryshimin e këtij mentaliteti, sipas ekspertëve, mund ta ndihmojë edhe përfshirja e sektorit civil, si një nga faktorët që ka luajtur rol të madh në kapërcimin e krizës politike, e që në të kaluarën, jo që nuk ishte konsultuar, por ishte objekt i kritikave dhe burgosjes së aktivistëve të tyre për shkak të kritikave adresuar pushtetit



Shkup, 30 korrik - Zhvillimet e fundit në skenën politike në Maqedoni, në veçanti ato pas zgjedhjeve të dhjetorit të vitit të kaluar dëshmojnë sipas ekspertëve dhe njohësve të çështjeve politike, praninë e theksuar të dyftytërsisë së politikanëve, apo cinizmin e tyre varësisht veprimit të tyre politik, të qenurit të pushtet apo opozitë. Sipas sociologut, Gjorgji Tonovski, kritikant e VMRO-së në opozitë ndaj partive në pushtet për marrjen e borxhit prej disa milionë eurove, në kohën kur borxhi ka arritur në pesë miliardë euro, pikërisht nga qeverisja e VMRO-së, sipas Gjorgji Tonovskit, apo fushata me premtime e zyrtarëve të BDI-së në pushtet për integrimin euroatlantik të vendit kur dihet se pikërisht kjo parti ishte bashkëpjesëmarrëse në dy mandatet e fundit me VMRO-në dhe integrimi ishte larg realizimit, flasin se partitë nuk turpërohen aspak nga veprimet në të kaluarën. Sipas ekspertëve, raste të tilla ka shumë, por që

nuk i shqetësojnë aspak partitë politike të cilat nuk zgjedhin mjetet të mbrojtur pushteti apo për ta marrë atë. "Në luftën politike, shpesh herë e dimë se nuk zgjidhen mjetet për të etiketuar kundërshtarit apo për të dominuar në skenën politike. Këtu paraqiten elementet e dyftytërsisë të vjedhjes së ideve apo të paraqitjes së ideve të cilat janë kundërshtuar pikërisht nga ana e tyre kur kanë qenë në pozitë, të kundërtën në skenën politike. Këtu nuk ka moral, nuk mbahet llogari për fjalën e thënë apo veprimin e bërë. Politikanët nuk mbajnë llogari për veprimet e bëra, interes parësor kanë veten e tyre apo një grup më të vogël të interesit, dhe jo ata që e kanë sjellë në pozitë. Hipokrizia e tyre nuk ka fund dhe kjo është dëshmuar me veprimet e deritanishme të klasës politike", thotë sociologu Gjorgji Tonovski. Ndërkohë, Shpëtim Pollozhani, njohës i çështjeve politike dhe drejtues i shoqatës së ish të përnd-

jekurve politike shqiptar, thotë se gjendja e këtyllë është pasojë e mosfunksionimit të vlerave. Ai thotë se partitë ndryshojnë qëndrimet e tyre varësisht kursit politik, por duke mos mbajtur llogari për veprimet e tyre në të kaluarën. "Me një vend nuk funksionon sistemi i vlerave, atëherë në sipërfaqe dalin antivlerat. Rezultati i atyre antivlerave është se deri sa janë opozitë janë shumë të zëshëm, i gjejnë problemet apo i adresojnë problemet dhe bërtasin ditë e natë, çirren. Por, kur vijnë në pushtet atëherë e ndërrojnë terminologjinë, e ndërrojnë fjalorin dhe gjithmonë gjejnë arsytimin duke thënë se kështu donë faktori ndërkombëtar", thotë Pollozhani, duke shtuar se e gjithë kjo, siç shprehet ai, është pasojë e përzgjedhjes së njerëzve të dëgjueshëm në pozita udhëheqëse, të cilët parësore në punën e tyre kanë urdhrat e padronëve të tyre. "Problemi qëndron tek humbja e kriterëve dhe sistemit të vlerave. Akoma

këtu votohet dhe përgjigjet kuadrot sipas sistemit feudal, njeriu i fisit, njeriu i lagjes, njeriu i partisë. Në pozita udhëheqëse apo në Kuvend, njerëz të cilët janë dëshmuar qoftë në shkencë apo biznes apo si njerëz anonim por që vlejnë si quadro, por në shprehje vijnë militantët partiakë, të cilët janë të lidhur me krimin pasi me ndihmën e krimin vijnë në pushtet. Unë jam i bindur se çdo gjë ka fund. Është një fjalë e urtë popullore që thotë se çdo gjë ka fund, popullin mund ta mashtrosh një herë, dy herë, një mijë herë, por jo gjithmonë", thotë Pollozhani. Edhe Gjorgji Tonovski shprehon në ndryshimin e gjendjes, por mbetet të shihet nëse garnitura aktuale qeverisëse do të ndryshojë kursit e veprimit në përzgjedhjen e kuadrove. "Të shpresojmë se kjo gjendje mund të ndryshojë apo se nuk do të jetë e shprehur në mënyrë drastike pasi kemi një ambient të ri, kemi paralajmërime për vendosje të një procesi të rivendosjes për çështjet shoqërore. Kemi përpjekje për freskimin e skenës politike me ide të reja, praktika të reja apo mënyra të reja në miratimin e vendimeve", thotë Tonovski. Ndryshimin e këtij mentaliteti, sipas ekspertëve, mund ta ndihmojë edhe përfshirja e sektorit civil, si një nga faktorët që ka luajtur rol të madh në kapërcimin e krizës politike, e që në të kaluarën, jo që nuk ishte konsultuar, por ishte objekt i kritikave dhe burgosjes së aktivistëve të tyre për shkak të kritikave adresuar pushtetit. (REL)

## Grujoskit dhe Boshkovskit ende në arrati, kërkohen fajtorët

Shkup, 30 korrik - Reagimet për arratisjen e Goran Grujoskit dhe Nikolla Boshkovskit nuk kanë të ndalur. Lëshimet sipas ekspertëve ligjor janë bërë nga vetë gjykatësit, për të cilët ditë më parë Ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spaskovski, tha se policia në këtë rast nuk mund të akuzohet, pasi që e gjithë përgjegjësia për arrestimin e të akuzuarve në rastin "Target" dhe "Fortesa" bie mbi sistemin gjyqësor. Në këtë rast, ish gjykatësja e Gjykatës Kushtetuese, Milka Ristova, përmes rrjeteve sociale ka theksuar se përgjegjësi në këtë rast doemos të këtë, duke aluduar në gjykatësit dhe sistemin gjyqësor në përgjithësi. "Organet përgjegjëse duhet ta hedhin hapin e radhës për kërkimin e përgjegjësisë të të gjitha personave, të cilët me veprimet e kundërligjshme kontribuuan në arratisjen e personave të akuzuar. Ne disponojmë me dispozita të mira ligjore, procedura të vërtetuar dhe organe përkatëse. Për gjykatësit, përgjegjës është Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli për verifikimin e fakteve, në këto dy këshilla punojnë 24 persona të zgjedhur profesionistë të cilët paguhen nga arka e buxhetit shtetëror", thotë ish gjykatësja. Ndryshe, ish punonjës në Drejtorinë për Siguri dhe Kundërzbulim, në komentimin e zhvillimeve të fundit thonë se nuk dyshojnë se Grujoski dhe Boshkovski të kenë qenë të ndihmuar në arrati nga kolegët e tyre të DSK-së.




Të dhënat e përfshira në raportin e punës të Prokurorisë Publike, thonë se masa e posaçme hetuese të ndjekjes dhe incizimit të bisedave telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike, në procedurë ligjore janë zbatuar në 29 raste kundër 183 personave me identitet të vërtetuar dhe 9 personave tjerë me identitet të pavërtetuar

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 30 korrik - Zbatimi apo përdorimi i Masave të posaçme hetuese (MPH), si instrument ligjor në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në Maqedoni gjatë vitit të kaluar është shtuar për 75 për qind më tepër se vitin paraprak. Ky konstatim së fundmi është përfshirë në raportin e punës së Prokurorisë Publike, e cila thotë se rritja drastike e zbatimit të MPH në krahasim me vitin 2015, është si rezultat i përqendrimit të prokurorisë në luftën kundër grupeve kriminale, të cilët përbëhen nga një numër i madh i personave. Në raportin e Prokurorisë sa i përket zbulimit të kriminelëve përmes MPH, thuhet se rritja e përdorimit të këtyre masave është ndikuar nga kriza e emigrantëve në vendin tonë, ku ende zbatohen masat si dhe shtimi i veprave penale që lidhen me trafikimin e emigrantëve. "Lloji i veprave penale të cilët kanë shërbyer si bazë për zbatimin e Masave të Posaçme Hetuese, tregon qartë se Prokuroria Publike gjatë vitit 2016 me sukses ka arritur të ballafaqohet me sfida në luftën kundër krimit të organizuar i cili kryesisht është i lidhur me shitblerjen e lëndëve narkotike, veprat kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkomëtare ku përfshihen trafikimi i emigrantëve, keqpërdorimi i regjimit pa viza, pastaj janë përfshirë edhe vepra kundër shtetit në të cilët hynë pjesëmarrja në policinë, luftërat e huaja apo formacione paraushtarake, gjegjësisht vepra

Prokuroria Publike thotë se ka rritur efikasitetin

## Masat e posaçme japin rezultate



### LLOJI I ZBATIMIT TË MASAVE TË POSAÇME HETUESE

Të dhënat e përfshira në raportin e punës të Prokurorisë Publike, thonë se masa e posaçme hetuese të ndjekjes dhe incizimit të bisedave telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike, në procedurë ligjore janë zbatuar në 29 raste kundër 183 personave me identitet të vërtetuar dhe 9 personave tjerë me identitet të pavërtetuar. Njëherit ky lloji i MPH, është praktikuar gjatë 74 veprave penale. Në vazhdim të sqarimit të llojit të Masave të Posaçme Hetuese, thuhet se masa e përcjelljes dhe incizimit të shtëpisë së mbyllur dhe hapësirës së rrethuar e cila, ose hapësirë afariste private, gjegjësisht veturës është zbatuar në katër raste, kundër 6 personave me identitet të vërtetuar. "Masa e përcjelljes sekrete dhe incizimit të personave dhe lëndëve me pajisje teknike jashtë shtëpisë dhe hapësirës afariste është zbatuar në 23 raste, kundër 133 personave. Sa i përket masës së qasjes sekrete dhe kërkimeve në sistemin kompjuterik gjatë vitit 2016 nuk është zbatuar në asnjë rast. Ndërkaq, masa e qasjes në realizimin e bisedave telefonik dhe komunikimeve tjera elektronike brenda vitit të kaluar është zbatuar në 37 raste, kundër 40 personave me identitet të vërtetuar dhe 319 lëndëve tjera penale", thuhet raportin e Prokurorisë Publike.

penale që burojnë nga keqpërdorimi pozitës zyrtare në pjesë e korrupsionit", thuhet në raportin e Prokurorisë Publike.

Duke bërë krahasimin me vitin 2015, ku veprat penale

më të shpeshta ndaj të cilëve janë zbatuar MPH, kanë qenë krimi i organizuar dhe vrasjet, sipas raportit të punës të Prokurorisë Publike në vitin 2016 janë paraqitur edhe

vepra të reja penale të cilët janë hetuar përmes MPH, siç janë blerja e votave gjatë procesit zgjedhor, gjegjësisht dëmtimit dhe hyrja ilegale në sistemet kompjuterike. Në nivel republikan duke ju referuar të dhënave në raportin e Prokurorisë, thuhet se gjatë vitit 2016, MPH janë zbatuar në 100 raste kundër 347 personave me identitet të vërtetuar dhe 13 personave me identitet të pavërtetuar edhe atë kundër 454 lëndëve penale. Ndërkohë, sa për ilustrim në vitin 2015, MPH janë shfrytëzuar në 57 raste kundër 328 personave me identitet të vërtetuar dhe 107 personave me identitet të pavërtetuar.

"Numri i procedurave që janë hapur në bazë të dëshmiave të mbledhura nga MPH është 5 akuzat të ngritura, me çka janë arritur 14 marrëveshje mes prokurorit publik dhe të akuzuarve, pastaj janë miratuar 24 urdhëresa për realizimin e hetimeve. Njëkohësisht janë iniciuar katër procedura të shkurta dhe janë miratuar 7 aktgjykime. Të gjitha këto të dhëna e dëshmojnë qasjen serioze të institucionit tonë gjatë zbatimit të Masave të Posaçme Hetuese, me të cilët preken të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe lufta efikase në ndjekjen e krimit të organizuar", theksohen në raportin e Prokurorisë Publike, ku mes tjerash nënvizohet se MPH vazhdojnë të zbatohen ndaj një numri të konsiderueshëm të personave, ndërsa procedurat para hetimore janë në fuqi për një pjesë tjetër të personave.

### Kronikë

## Sulmohen tre policë në Tetovë

Të shtunën në pas mesnate në rr. "Bllagoja Toska" në Tetovë, tre policë nga Stacioni Policor i Tetovës u sulmuan fizikisht nga 26 vjeçari me iniciale M.M. dhe 28 vjeçari me iniciale I.A. të dy nga Tetova, të cilët janë të njohur për shumë vepra kriminale, njofton Ministria e Punëve të Brendshme. Policët pasi i kanë vërejtur personat kanë kërkuar që të bëjnë identifikimin e tyre dhe të nxjerrin gjërat nga xhepi. Pas kësaj personi M.M. filloi të bërtiste dhe fizikisht ka sulmuar njërin nga policët duke e goditur atë me grushte në gjoks. Në këtë rast kanë reaguar edhe dy policët tjerë, kanë arrestuar dhe dërguar personat në Stacionin Policor të Tetovës për veprime të mëtejshme. Po merren masa për zbardhjen e plotë të ngjarjes.

## Kallëzim penal për keqpërdorim të kartelave pagesore

Sektori për krim kompjuterik dhe forenzik digjitale pranë Ministrisë për Punë të Brendshme, ka ngritur kallëzim penal kundër personi U.M (33) nga Shkupi, nën dyshimin se ka kryer veprën penale "përpunim dhe shfrytëzim të kartelave pagesore të falsifikuara". I denoncuar, me qëllim të përftimit materiale të jashtëligjshëm, në mënyrë ilegale përmes internetit ka mbledhur të dhëna nga kartelat e vërteta pagesore, gjegjësisht nga kartela pagesore të shteteve të huaja, me çka ka arritur të realizon më shumë transaksione të suksesshme dhe të pasuksesshme. Transaksionet ilegale të suksesshme të cilat i ka kryer i dyshuari arrin në shumën mbi 66 mijë denarë, ndërsa ato të pasuksesshmet janë 1.5 milion denarë", thonë nga MPB-ja. Mes tjerash nga policia e shteti theksojnë se i dyshuari transaksionet ilegale i ka kryer duke i shfrytëzuar 114 kartela të huaja pagesore, edhe atë brenda muaji shkurt dhe maj ka 117 herë ka tentuar të bëjë transaksione.

## E rrahin para gruas dhe vajzës

Një shkupjan është sulmuar fizikisht nga dy persona të panjohur pasditen e shtunë përdorin një makinë të panjohur në rrugën Radishanska në Shkup, informojnë nga MPB. Bëhet fjalë për V.R (39) nga lagjia Radishan, i cili në polici ka denoncuar se është sulmuar në momentin kur ka qenë duke lëvizur në rrugën Radishanska me makinën e tij "Land Rover" së bashku me bashkëshorten dhe vajzën e tij. Në një moment makina "pasat" me targa të panjohura ka frenuar në vend. I revoltuar nga veprimi, V.R ka ndaluar makinën e tij dhe ka dalë drejt makinës që ka frenuar. Pas një mosmarrëveshje të shkurtër, nga makina kanë dalë dy persona të panjohur dhe fizikisht e kanë sulmuar V.R i cili, i kërcënuar për sigurinë, ka filluar të kthejë goditjet. Pasi dikush nga të pranishmit është paraqitur në polici, njëri person ka ikur, ndërsa tjetri është futur në makinë dhe me makinë ka goditur V.R., i cili është rrëzuar në pjesën e përparme të makinës dhe ka goditur me kokë xhaminë e përparme. Makina ka vazhduar të lëvizë edhe 100 metra dhe ka frenuar përnjëherë pas çka V.R është rrëzuar në tokë. Me makinë të ndihmës së shpejtë ai është dërguar në Qendrën urgjente në Shkup, ku është ndaluar për kurim të mëtejshëm. Po ndërmerren masa për zbardhjen e plotë të rastit.

MPB heton veprimin e policisë gjatë protestës në Shkup

## Do të ketë përgjegjësi për policët që përdorën forcë

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) kumtoi se Sektori për kontroll të brendshëm vepron me urdhrin për hulumtim të detajuar të veprimit policor mbi protestën e disa aktivistëve qytetarë të shtunën gjatë prezantimit të pajisjeve ushtarake të ARMSW dhe ushtrisë amerikane në Shkup

Shkup, 30 korrik - Ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski në profilin e tij të Facebook-ut shkroi se në mënyrë të detajuar do të shqyrtohet rasti me arrestimin e anëtarëve të së majtës, për të cilët konfirmoi se vetëm janë legjitimuar. "Në lidhje me publikimet në mediet sociale për arrestimin e personave që protestuan, dua të informoj se nuk ka pasur rast të arrestimit. Personat kanë qenë të legjitimuar. Njëkohësisht t'ju informoj se do të kontrollohen të gjitha informatat për përdorimin eventual të forcës ndaj qytetarëve të cilët kanë protestuar. Në mënyrë të detajuar do



të testohet rasti dhe të ketë informatë përkatëse për opinionin", shkroi ministri i Punëve të Brendshme Oliver Spasovski në profilin e tij të facebook-ut pas reagimeve në opinion rreth lajmit se katër anëtarë të së majtës janë arrestuar nga policia sepse kanë protestuar kundër ushtrisë amerikane. "Pres përgjegjësi nga shërbimi policor që pabazë aplikoi forcë, si dhe atij që dha urdhër për arrestim. Nëse ajo nuk do jetë rezultat i hetimit të Sek-

torit të kontrollit të brendshëm dhe standardeve profesionale, atëherë mund të kërkojnë përgjegjësi politike. Më parë partia paralajmëroi se e majta njoftoi se policia e ndihmuar nga ARM-ja me forcë i ka mbajtur protestuesit dhe i ka penguar që lirisht të lëvizin gjatë kohës së prezantimit të pajisjes ushtarake të SHBA-së dhe të ARM-së. Protestuesit mbanin panarta ku shkruante "Kundër luftës së përfitimëve!". Edhe Ministria e Punëve të Brendshme

(MPB) kumtoi se Sektori për Kontroll të brendshëm, hetime kriminale dhe standarde profesionale, tashmë vepron me urdhrin për hulumtim të detajuar të veprimit policor mbi protestën e disa aktivistëve qytetarë të shtunën gjatë prezantimit të pajisjeve ushtarake, mjekësore dhe teknike në Shkup. Më pas, siç thuhet në kumtesë, nëse përcaktohet shkelja e veprimeve policore, do të ketë sanksione përkatëse. E drejta për protestë është e pacenueshme edhe me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë - e drejtë e garantuar të cilën, midis tjerash, policia ka të drejtë ta mbrojë, njëjtë sikurse ka detyrë ta mbrojë rendin dhe qetësinë publike dhe sigurinë e të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, theksojnë nga MPB. Ministria gjithashtu në mënyrë kategorike i përgënjeshtroi të gjitha pretendimet për arrestimin e personave lidhur me ngjarjen e theksuar.





Luftë pa kompromis ndaj evazionit fiskal

# Kthimi i TVSH-së edhe për qytetarët

**Qeveria paralajmëron masën e kthimit të TVSH-së edhe për qytetarët, e cila dukshëm do të ndikon në eliminim e konkurrencës jo lokale në treg. Sipas kryeministrit Zoran Zaev, kjo masë ka për qëllim të motivojë qytetarët që të blejnë mallra vetëm në ato vende ku jepen llogari fiskale. Sipas OEMVP-së, kjo do të fut në sistem edhe kompanitë jolegale**



mekanizëm të ri - ministri i Financave më të mos vendosë për kthim të TVSH-së, por vetëm ta ndjek, të jetë mbikëqyrës. Siç arrin TVSH-ja do të shkojnë në llogarinë e kompanive", deklaroi kryeministri i Qeverisë, Zoran Zaev. Ndërkaq, kryetari i OEMVP-së Nebi Hoxha, vlerëson se politikën e propozuar të qeverisë së re janë shumë pozitive dhe se tani është koha e fundit që edhe kompanitë vendore të përkrahen nga shteti dhe të kenë kushte të barabarta në të bërit biznes, me qëllim që tregu të vendos se kush do mbi-jetojë dhe do jetë më i suksesshëm, por sigurisht që ka shumë për t'u bërë në këtë drejtim. "Konkurrenca jo lokale do të mund të zvogëlohet nëpërmjet konsumatorit, sepse në propozimin e tij Kryeministri kumtoi se do të ketë edhe kthim të TVSH-së edhe për qytetarët deri në 15 për qind të vlerës së përgjithshme të kuponëve fiskal. Kjo do të motivonte qytetarët që të blejnë produkte nga kompani të cilat kanë arka fiskale, me ç'rast për të mbijetuar në treg kompanitë duhet të formalizohen dhe të paguajnë tatim dhe rrjedhimisht do të punojnë me fatura dhe gjithçka do të qarkullojë përmes sistemit", thotë Nebi Hoxha, kryetar i OEMVP-së.

**Koha** Zejnulla VESELI

Shkup, 30 korrik - Për të pasur biznes të suksesshëm, përveç se nevojitet infrastrukturë rrugore e zhvilluar dhe zbatim i ligjeve tatimore, zëvendës kryeministri i Qeverisë, Zoran Zaev, në takimin e ditës së enjte që pati me pronarët e kompanive shqiptare pranë Odës Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore, kërkoi dhe ndihmën e qytetarëve që të blejnë mallra vetëm na ato vende ku jepen llogari fiskale, sepse vetëm kështu do të mund të eliminohet konkurrenca jo lokale dhe të luftohet ekonomia e zezë.

"Do të fillojmë me masën e kthimit të TVSH-së edhe për qytetarët e Maqedonisë e jo vetëm për kompanitë. Kjo do të thotë se çdo qytetarë do të fitojë të drejtën që në fund të një viti kalendarik të kthen 15 për qind (TVSH) të vlerës së përgjithshme të mallrave, për të cilat ka marrë llogari fiskale. Nëse çdo qytetarë do të blejë mallra vetëm nëse për këtë do t'i jepet llogari fiskale, qytetari në fund të vitit mund të kthejë një pjesë ta parave të harxhuara që mund të shkojnë prej 300 deri më 500 euro. Kur qytetarët në fund të vitit do fitojnë edhe një rrogë plus, ata asnjëherë më nuk do të shkojnë të blenë mallra në ato vende

ku nuk marrin llogari fiskale. Me këtë duam të motivojmë qytetarët që të blejnë mallra vetëm në ato vende ku jepen llogari fiskale. Me këtë jo vetëm që do të kenë përfitime personale, por kështu do kontribuojnë në eliminimin e konkurrencës jolegale, gjegjësisht do të detyrojnë shumë biznese që punojnë në të zezë dhe nuk paguajnë tatim, të regjistrojnë kompanitë që të mund në të ardhmen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre", deklaroi Zaev.

Që të realizohet kjo masë, Zaevi paralajmëroi se në të ardhmen do të shtohen aksionet e inspektorëve kundër të gjitha atyre firmave që do të bëjnë fshehje të tatimit.

Në këtë kontekst, do të shtojmë kontrollat e inspektorëve, të cilët në fillim vetëm do t'i paralajmërojnë se po bëjnë fshehje tatimi dhe nëse në afat prej 30 ditëve nuk i eliminonjë këto parregullsi, atëherë herën e dytë gjohet do të jenë edhe një herë me të larta se sa janë për momentin. Nëse biznesi shkon përpara, do të zhvillohet shteti, do të ketë më shumë vende pune dhe pagesa më të larta të TVSH në buxhet që do të shkojnë për investime kapitale", deklaroi Zaev.

Njëherit kryetari i Qeverisë, Zaev, paralajmëroi vendosje e një mekanizmi për kthim automatik të TVSH-së, pa kurrfarë ndikimi nga ana e ministrit të Financave, gjegjësisht strategjia e re për tatim personal të fitimit, i cili parashikon digjitalizim të pagesës, ndërsa duhet të përgatitet deri në fund të vitit. Ai i porositi afaristët që të jenë të zëshëm për gjërat të cilat pengojnë funksionimin e kompanive të tyre. Ndërsa sa i përket kthimit të TVSH-së, përfundimisht me muajin qershor, janë shlyer të gjithë borxhet. "Deri më 25 qershor e kthym gjithë TVSH-në ose gjithsej 2,4 miliardë denarë që është 40 milionë euro. Por, pastaj u zbrazen llogaritë në shtet. Qëllimi ynë është që ta stabilizojmë shumë shpejtë Buxhetin dhe deri në vjeshtë të vendosim

Shqetësimi për përplasjet ruso-amerikane

## Sanksionet prekin TAP?

**Sanksionet mund të vënë në pikëpyetje korridorin jugor të gazit, që supozohet të furnizojë Gjeorgjinë, Turqinë, Shqipërinë, Malin e Zi dhe Kroacinë me gaz nga Azerbajxhani. Por duke qenë se në projekt merr pjesë edhe Lukoil-i rus, shkruan "Total Croatia News", sanksionet mund të bllokohen të gjithë iniciativën**



Tiranë, 30 korrik - Ekspertët evropianë paralajmërojnë se sanksionet e reja amerikane ndaj Rusisë mund të rrezikojnë projekte të rëndësishme gazi në kontinentin e vjetër. Ato mund të vënë në pikëpyetje korridorin jugor të gazit, që supozohet të furnizojë Gjeorgjinë, Turqinë, Shqipërinë, Malin e Zi dhe Kroacinë me gaz nga Azerbajxhani. Por duke qenë se në projekt merr pjesë edhe Lukoil-i rus, shkruan "Total Croatia News", sanksionet mund

të bllokohen të gjithë iniciativën. Ekonomia e Kroacisë, vend anëtar i Bashkimit Evropian e ka ndër të tashmë peshën e masave të marra kundër Rusisë dhe të dhënat e viteve të fundit tregojnë se rritja e eksporteve do të ishte ndjeshëm më e shpejtë pa sanksione. Burime në Bruksel thonë se këtë herë, Bashkimi Evropian do të bëhet tërthorazi viktimë e sanksioneve të Uashingtonit dhe po përpiqet ta bindë administratën amerikane të heqë dorë nga shtrirja e tyre. "Ne

shpresojmë në gjetjen e një zgjidhjeje e cila të mos i përkeqësojë marrëdhëniet SHBA-Rusi, që është dhe një prej objektivave të liderit evropian", citon portali të thonë disa diplomatë kroatë. "Të gjithë janë të shqetësuar dhe ne besojmë se nuk do të ketë nevojë për hapa drastike në mbrojtjen e interesave evropiane", shtojnë më tej ata. Në Bruksel duket se po diskutohet dhe mundësia e nisjes së një procesi gjyqësor kundër Shteteve të Bashkuara nëse vlerësohet se ekono-

mia evropiane do të vuajë pasoja të mëtejshme nga sanksionet amerikane kundër Moskës.

Projektet që njihen së bashku si korridor i gazit përbëhen nga gazsjellësi ekzistues i Kaukazit jugor, që do të zgjerohet me një linjë paralele përmes Azerbajxhanit dhe Gjeorgjisë, TANAP, që transporton gaz nga fusha e Shah Denizit përmes Turqisë dhe TAP-i, që do të përkthojë Greqinë e veriut, Shqipërinë, detin Adriatik e më pas do të dalë edhe një herë në tokë në Italinë jugore. (T.CH)

## Debati për ribalancin e Buxhetit do të fillojë më 1 gusht

Shkup, 30 korrik - Më 1 gusht Kuvendi do ta fillojë debatin pesëditor për ribalancin e Buxhetit. Kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi seancën e 11-të me një pikë në rendin e ditës Propozimin e plotësuar për ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2017 e caktoi për më 1 gusht në orën 10. Pritet Qeveria gjatë fundjavës ta kthejë ribalancin e Buxhetit në Kuvend, pasi ai u miratua në seancë të premtën. Me Propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2017 përcaktohen 25 milionë denarë shtesë nëpër zëra të caktuara dhe ridedikohen mjete financiare sipas nevojave të konsumatorëve të buxhetit. Shpenzimet e përgjithshme me ribalancin e Buxhetit janë projektuar në 203.312.000 mijë denarë, të ardhurat në 184.745.000 mijë denarë, ndërsa deficiti në 18.567.000 mijë denarë. Qëllimi, sipas propozuesit, është të zvogëlohen shpenzimet joproduktive dhe sigurimi i hapësirës për realizimin e politikave të Qeverisë së re. Shkurtohet prej zërave për shërbime zyrtare, reklamim, udhëtime zyrtare dhe prezantime ekonomike, me çka sigurohet hapësirë për buxhetimin e masave të reja për mbështetjen e qytetarëve dhe kompanive siç janë paga minimale, zgjidhja e rasteve të falimentuara, mbështetja për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe bujqit, heqja e taksës radiodifuzive etj.





Humaniteti i mërgimtarëve dibranë s'ka të ndalur

# Dy familje u bënë me kulm mbi kokë



Sipas koordinatorëve, si nga SHBA, Edmond Imerit dhe Bekim Paçukut, por edhe të aktivistëve dibranë që veprojnë në Dibër, Skënder Kërçishta dhe Artan Duka, aktivitetet humanitare do të vazhdojnë

Koha Vjollca SADIKU

Dibër, 30 korrik - Përkrashja e mërgimtarëve për dibranët është shumë e madhe. Vite me radhë ata japin një kontribut të madh në ndihmesën për familjet e tyre, por edhe më gjerë. Përveç ndihmave në para, ata kohëve të fundit për familjet e pastrehë sigurojnë edhe shtëpi.

Një grup mërgimtarësh dibranë që jetojnë në SHBA, kanë siguruar shtëpi për dy familje skamnore, të cilët vite me radhë nuk kanë pasur kulm mbi kokë. Bëhet fjalë për familjet e Bedri Upalenit dhe Sabaudin Lela. Pas kontakteve që pati grupi humanitar i mërgimtarëve nga SHBA, i kryesuar nga Edmond Imeri - Mondit dhe Bekim Paçuku, bashkë me aktivistët Skënder Kërçishta dhe Artan Duka, kanë ardhur në përfundim se familjet e Bedri Upalenit dhe Sabaudin Lelës kanë nevojë të veçantë për të siguruar kulm mbi kokë.

Së pari me grumbullimin e mjeteve, u ble një shtëpi për familjen e Bedri Upalenit. Ai jetonte në një varfëri ekstreme dhe në një shtëpi të boshatisur në

fshatin Shullan. Ai na deklaroi se së bashku me bashkëshorten e tij, Artën dhe dy fëmijët jetonin në kushte mizore, pa rrymë, pa asnjë banor në fshat, pa punë, pa asgjë. Gjatë vizitës që ia bënë aktivistët humanitar, Skënder Kërçishta dhe Artan Duka, erdhën në përfundim se duhet t'ju ndihmohet, me çka informuan grupin humanitar nga Amerika. Mjetet për sigurimin e një shtëpie për këtë familje u siguruan shumë shpejtë, na deklaroi Skënderi dhe menjëherë u ble një shtëpi në Dibër, e cila ishte e mobiluar komplet me inventar familjar. Në gëzimin që pati familja e Bedri Upalenit ishëm të pranishëm edhe ne si gazetarë. "Kam lindur për së dyti dhe jam shumë i gëzuar.



Kurrë s'do ta harroj këtë të mirë që ma bën vëllezërit dibran nga Amerika", tha Bedriu, i cili përveç problemeve të shumta sociale, ka edhe probleme shëndetësore. Gëzim të madh ka edhe bashkëshortja dhe fëmijët e tij. "As në ëndërr nuk pritja që të tejkalojmë atë jetë mizore më keq se kafshët, por ja humanizmi i vëllezërve dibranë na solli këtë të mirë", thotë Arta.

Një gëzim i madh ishte edhe për familjen e Sabaudin Lelës. Sabaudini, së bashku me familjen asnjëherë s'ka pasur shtëpinë e vet. Ai është ende nëpër shtëpi me qira. Pos pa shtëpi, ai vuan edhe nga sëmundja e epilepsisë së shkallës së lartë, por edhe nga disa sëmundje të tjera që pamundësojnë ai edhe të

punoj. Humanistët nga SHBA, edhe për këtë familje siguruan mjete. Ai tani është bërë me shtëpi të kompletuar me orënditë shtëpiake. Gëzimi i kësaj familje është i madh. Bashkëshortja e Sabaudinit, Vjollca, thote „ky humanizëm kurrë nuk do të harrohet. Definitivisht edhe ne me tre vajzat tani më kemi shtëpinë tonë. Kjo ndihmë për ne do të jetë e paharruar, nga që na e ndryshoi jetesën tonë, thotë ajo.

Këto aktivitete humanitare në Dibër bënë një bujë pozitive të madhe. Çdo familje dibrane përshëndesin këtë iniciativë nga grupi humanitar, duke i uruar me fjalë miradije dhe duke thënë se Zoti ju jep më shumë atyre që ndihmojnë.

Sipas koordinatorëve,

si nga SHBA, Edmond Imerit dhe Bekim Paçukut, por edhe të aktivistëve dibranë që veprojnë në Dibër, Skënder Kërçishta dhe Artan Duka, aktivitetet humanitare do të vazhdojnë. Te mërgata dibrane interesi është i madh për të ndihmuar vëllezërit dhe motrat e tyre që jetojnë në kushte mizore, thonë ata. Andaj, ata gjithmonë janë në teren dhe mbikëqyrin situatën e problemeve ekstreme sociale, me qëllim që t'ju ndihmohet edhe të tjerëve.

Duhet theksuar se përveç këtyre dy shtëpive që siguroi ky grup humanitar, edhe gjatë vitit të kaluar ky grup siguroi dy shtëpi të tjera për familjet pa strehë në Dibër. Ata tani jetojnë jetën normale si gjithë të tjerët.

## Busti i Skënderbeut në oborrin e struganit

Skënderbeu është mbreti ynë më i madhi, thotë krejt natyrshëm Mensur Ismaili, një shqiptar patriot, nga fshati Belicë në rrethinat e Strugës. Mensuri që i ruan me fanatizëm të rrallë rrënjët e veta, i ka ngritë bust Skënderbeut në oborr të vilës së tij

Strugë, 30 korrik - Shqiptarët vazhdojnë ta nderojnë Skënderbeun si zotin e tyre. Jo për inat të ndokujt. Në të gjitha kohërat, edhe në diktaturë, bustet e vogla të Skënderbeut gjendeshin gjithkund me krenari merreshin jepeshin si dhurata dhe ishte në prag të çdo oxhaku busti i Skënderbeut. Shqiptarët që janë shqiptarë rrace reagojnë ndryshe kur vjen puna për heroin e tyre kombëtar. Ata i ngrenë Skënderbeut bust në përmasa reale në oborrin e shtëpisë së tyre



dhe kjo gjë u duket krejt, krejt e zakonshme. Rastësisht, dy vjet pasi ka ndodhë ngritja e një busti, rastësisht e mësova dhe po e rrëfej sot, kur i zoti i shtëpisë as e ka ndër-

mend. Skënderbeu është mbreti ynë më i madhi, thotë krejt natyrshëm Mensur Ismaili, një shqiptar patriot, nga fshati Belicë në rrethinat e Strugës.

Mensuri që i ruan me fanatizëm të rrallë rrënjët e veta, i ka ngritë bust Skënderbeut në oborr të vilës së tij. Skënderbeu është burri ynë i kombit, heroi ynë i vetëm rreth të cilit mblidhemi të gjithë shqiptarët kudo ku jetojmë e punojmë. Skënderbeu është babai ynë, babai i kombit tonë, vijon Mensuri i Belicës, i cili jeton prej 30 vitesh në Zvicër pa i ikë asnjëherë Belices.

Në vitin 2015 Mensuri me familjen e tij, kanë ndërtuar në Belicë një bust të Skënderbeut. E kanë vu bustin në oborr të vilës. Që nga aty në 1900 metra lartësi mbidetare, Skënderbeu derdh vështrimin mbi Strugë e tej e tej Pollogut. Busti prej 1 metër i lartë, është i gdhendur në gur, në gur të shkullur prej aty. Është i vendosur në një fron guri mbi 1.5 metër të lartë, gur i nxjerrë aty në themelet e kullës apo vilës së tij në Belicë.

Kam plotësuar një ëndërr timen të hershme, thotë Mensur Ismaili dhe

kam plotësuar amanetin e babës për të mos e lëshuar kurrë Belicen. Tani kemi edhe Skënderbeun këtu në Belicë dhe jemi lidhë më shumë me rrënjët tona. Në mënyrën më të thjeshtë, të pabesueshme, Mensur Ismaili, emigrant prej 30 vitesh në Zvicër, që nuk e lëshon dot Belicën e as ajo atë, më thotë se Skënderbeu na ka mbrojtur, ai na ka ruajtur dhe prandaj jemi shqiptarë.

Belica është një fshat shqiptar, me nam e famë në rrethinat e Strugës, 1900 metër mbi nivelin e detit, rreth 20 kilometër larg Strugës, në prehër të Maliit të Jabllanicës, në kufi me Qartishten e Malin e Kuq në kufirin administrativ mes Shqipërisë e Maqedonisë, por fshat i njohur, me histori të pazbuluar, të pashkruar, të paregjistruar, por me banorë si Mensuri me të tijtë e bashkëfshatarët që janë zgjuar si kurrë më parë për ta mbrojtë dhe për ta nxjerrë në dritë historinë e dikurshme të

bujshme vendlindjes dhe historinë e banorëve të saj që janë derdhë gjithandë Europës.

Belica, tashmë fshat vilash hijerënda prej guri, fshat me histori të bujshme njerëzish punëtorë e atdhetarë, ka tri kisha një xhami dhe një teqe. Kishat flasin shqip në themele e çati, në rrënjë e degë në derë e në prag, në votër e oxhak.

Teksa shoh bustin e Skënderbeut në oborrin e vilës së Mensur Ismailit në Belicë të Strugës, tekta shoh të zotët e vilës dhe fëmijët që rrinë me Skënderbeun, harroj e nuk dëgjoj daullet e atyre që shesin baballarët, nënat e motrat e tyre për pak famë, emër e lavdi dhe janë gati të bëjnë gjithçka, ta shesin edhe Skënderbeun, ta bëjnë serb kur s'kishte ende serbë, vetëm e vetëm që të përziejnë ndonjë herë pazarin e të dalin në ndonjë kronikë të blerë televizive apo të sponsorizuar nga anti-shqiptarët që janë gjithmonë mes nesh. (strugalajm)

Në bazë të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit për shfrytëzim dhe posedim me mjetet në pronësi të shtetit dhe me mjetet në pronësi të komunës ("Gazeta Zyrtare e Republikës" nr. 78/2015, 106/2015 dhe 153/2015), nenit 1, nenit 2 dhe nenit 3 të Vendimit për shitje të hapësirës me qëllim komercial – hapësira afariste në kuadër të Garazhit në kate "Makedonska Fallanga" nr. 07-5443/1 të datës 20.07.2017, Qyteti i Shkupit publikon:

## SHPALLJE PUBLIKE nr. 01/2017 Për shitje të mjeteve të patundshme për herë të parë përmes ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

### I. LËNDË E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

1. Lëndë e ankandit publik elektronik është shitja e mjeteve të patundshme me qëllim komercial – hapësira afariste në kuadër të objektit Garazh në kate "Makedonska Fallanga" edhe atë:

1.1. **Hapësira afariste nr. 3**, në sipërfaqe prej 453 m<sup>2</sup>, në PK nr. 114/12 në KK Qendër 2, i ndërtesës 1, qëllimi i ndërtesës – garazh në kate (E5), numri i hyrjes 1, kati K6, numri i pjesës së posaçme të ndërtesës 3, i shënuar në Listën pronësore me nr. 57173, KK Qendër 2, në pajtim me Certifikatën nga PDU nr. 27-1471/2 të datës 11.03.2016 të dhënë nga Komuna Qendër;

### 2. ÇMIMI FILLESTAR

Çmimi fillestar për ankandin publik elektronik për pronën e patundshme nga pika 1 është përcaktuar në bazë të Shumës së vlerësuar të patundshmërisë nga Ministria e drejtësisë – Byroja për ekspertiza gjyqësore me nr. CB V 73/2015 e datës 10.07.2017 dhe Vendimit për shitje të hapësirës me qëllim komercial – hapësira afariste në kuadër të Garazhit në kat "Makedonska fallanga" nr. 07-5443/1 e datës 20.07.2017 dhe e njëjta është **28.264.539,00 denarë**;

### 3. DATA E ANKANDIT PUBLIK

Ankandi publik për shitjen e mjetit të patundshëm nga pika 1 do të mbahet më datë **14.08.2017** në ora **11:00** dhe do të zgjasë deri më **11:30**.

### 4. TË DREJTË PËR Pjesëmarrje

Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik kanë të gjitha subjektet e vendit dhe të huaj fizik dhe juridik të cilat mund të fitojnë pronësinë e pronave të patundshme në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me ligjin.

### II. DOKUMENTACIONI TË CILIN Pjesëmarrësit NË ANKANDIN PUBLIK JANË TË OBLIGUAR TË DORËZOJNË PËR Pjesëmarrje NË SHPALLJE

1. Pjesëmarrësit në shpallje për ankand publik janë të obliguar të dorëzojnë:

- fletëparaqitje për pjesëmarrje;  
- garancia bankare për seriozitet të ofertës në shumë prej 2% të shumës së vlerësuar të pronës së patundshme për të cilën merret pjesë ose Vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për pjesëmarrje në procedurën për shitje kur për pjesëmarrje paraqitet organ shtetëror;

2. **Fletëparaqitja për pjesëmarrje** e ankandit publik parashtrohet në mënyrë elektronike përmes sistemit për shitje në ueb faqen **e-stvari.mk**.

3. Së bashku me fletëparaqitjen e plotësuar, parashtruesit duhet të dorëzojnë edhe:

#### a) për subjektet fizike

- kopje të letërnjoftimit ose dokumentit të udhëtimit (pasaportë);  
- garanci bankare për seriozitetin e ofertës në shumë prej 2% të shumës së vlerësuar të pronës së patundshme për të cilën merret pjesë;  
- e-mail adresë.

#### b) për subjektet juridike

- gjendja aktuale nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht dokument përkatës të dhënë nga organi kompetent i vendit ku është i regjistruar subjekti juridik;  
- garanci bankare për seriozitet të ofertës në vlerë prej 2% të shumës së vlerësuar të pronës së patundshme për të cilën merret pjesë;  
- e-mail adresë

#### c) për organet shtetërore

- gjendja aktuale nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë;  
- Vendim nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë për pjesëmarrje në procedurë për shitje të pronës së patundshme për të cilën merret pjesë;  
- e-mail adresë.

### III. AFATI PËR DORËZIMIN E DOKUMENTEVE

Dokumentacionin e plotësuar (fletëparaqitje, garanci bankare ose vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë), pjesëmarrësit janë të obliguar që në mënyrë elektronike ta dorëzojnë më së voni deri më **10.08.2017 deri në ora 16:30** deri në Qytetin e Shkupit përmes sistemit për shitje në ueb faqen **e-stvari.mk**.

Komisioni parashtruesve të cilët kanë dorëzuar fletëparaqitje të kompletuara për pjesëmarrje në ankand në pajtim me shpalljen, në afat prej tre ditëve të afatit përfundimtar për parashtrimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje u dorëzohet lajmërim për pjesëmarrje dhe emër përdorues dhe fjalëkalim për pjesëmarrje në ankandin publik.

### IV. MËNYRA DHE PROCEDURA PËR REALIZIM TË ANKANDIT

1. Që të mbahet ankandi publik, duhet të ketë së paku një pjesëmarrës.

2. Për ofertues më të volitshëm i ankandit publik konsiderohet pjesëmarrësi i cili ka ofruar çmimin e fundit.

3. Ofertuesi më i volitshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e përfundimit të ankandit publik është i obliguar që të paguajë mjetet në shumë të çmimit më të lartë të arritur për shitje të pronës së patundshme.

4. Nëse ofertuesi më i volitshëm nuk ka paguar mjetet në afatin e caktuar, nuk do të ketë iniciativë për lidhje të marrëveshjes, garancia bankare do të aktivizohet, ndërsa ofertuesi në periudhë prej një viti nuk do të mund të marrë pjesë në çdo ankand të ardhshëm publik për mjetet në fjalë.

5. Pas përfundimit të procedurës për ankand publik, me ofertuesin më të volitshëm në afat prej 5 ditëve të punës pas pagesës së realizuar të çmimit të pronave të patundshme do të lidhet Marrëveshje për shitblerje të pronës së patundshme.

Tatimi i qarkullimit dhe shpenzimet për solemnizim të marrëveshjes për shitblerje të pronës së patundshme do ti bartë ofertuesi më i volitshëm.

6. Pjesëmarrësit në ankandin publik kanë të drejtë për ankesë vetëm në lidhje me procedurën për ankand publik. Ankesa parashtrohet deri tek Komisioni në afat prej 3 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik. Komisioni vendosë në lidhje me ankesën me vendim në afat prej 5 ditëve nga dita e pranimit të ankesës.

### V. INTERNET FAQJA NË TË CILËN DO TË MBAHET ANKANDI PUBLIK

Ankandi publik do të realizohet në mënyrë elektronike në internet adresën në vijim:

**www.e-stvari.mk**

**Komisioni për mjete të tundshme dhe të patundshme të Qytetit të Shkupit**





Ku fshihet thesari i madh i Pashait të Janinës?!

# Aliu dhe misteri i 40 tonëve ar

Si fillim në histori thuhet se Kalaja që tani ka marrë emrin e Porto Palermos është ndërtuar nga Ali Pashai si dhuratë për gruan e tij, Vasiliqinë, por a është e vërtetë kjo, apo është ndërtuar si fortesë për të mbrojtur diçka më të madhe, një thesar ndoshta?

Anisa DEMIRAJ

Kur flasim për misterin më të mëdha shqiptare të bien në mendje shumë histori dhe legjenda, shumë prej tyre të trilluara, por ka dhe nga ato që qëndrojnë më të forta se vetë koha. Një ndër të është edhe e fshehta e thesarit të Ali Tepelenës, Pashait të Janinës.

Si mund të mos interesohesh për të kur bëhet fjalë për 40 tonë ar të pastër dhe një shumësi diamantësh? Epo me një pasuri të tillë gjithë hallet tona do të zgjidheshin dhe do të jetonim të lumtur në jetë të jetëve, por nuk është e thënë për ne... Deri më sot na vijnë disa të dhëna për vendodhjen e tij dhe pikat më të forta qëndrojnë në Vlorë, përkatësisht në kalanë e Porto Palermos ose e Vasiliqisë dhe në Shpellën e Haxhi Alisë në Karaburun. Po çfarë na bën që të mendojmë diçka të tillë?

Si fillim në histori thuhet se Kalaja që tani ka marrë emrin e Porto Palermos është ndërtuar nga Ali Pashai si dhuratë për gruan e tij, Vasiliqinë, por a është e vërtetë kjo, apo është ndërtuar si fortesë për të mbrojtur diçka më të madhe, një thesar ndoshta? Epo kjo mbetet për t'u parë. Le t'i hedhim një sy më nga afër kësaj kalaje sa legjendare aq e misterioze. Të gjithë e vlerësojmë relievin si një nga bukuritë më të mrekullueshme në Mesdhe, ku të ofrohen jo vetëm pamje të mrekullueshme, por edhe plazhe shumë të bukura. Borshi, Himara, Dhërmiu janë disa nga vendet jo vetëm më të bukurat, por edhe me histori. Tani do të flasim për një fshat shumë të veçantë, Qeparon po aq i kërkuar dhe i dashur sa gjithë të tjerët, por që diçka ndryshon me të dhe është, pikërisht ajo, kalaja e famshme e Ali Pashës.

Kalaja e vogël është e vendosur në një pozicion mjaft të bukur në një gadishull në gjirin e vogël tektonik të Porto Palermos, e cila në antikitet është njohur si në antikitet e njohur si gjiri i Panoramës. Kalaja ndodhet jo larg fshatit të Qeparosë dhe ka formë



trekëndore. Kalaja ndodhet mbi një ishull rreth 30 m larg bregut ku rripi i ngushtë ujon midis bregut dhe ishullit është mbushur me dhe e gurë për të realizuar një lidhje tokësore me të. Kalaja ka formë planimetrike trekëndore me tre bastione të fuqishme nëpër qoshe. Hyrja ndodhet në mesin e murit jugor. Nga ana e detit, midis dy bastioneve një sipërfaqe në formë trapezi është rrethuar me mure të pajisura me frëngji. Pjesa tjetër e kështjellës përbëhet nga një numër i madh ambientesh të mbuluara me qemerë të cilat përfundojnë në pjesën e sipërme me një tarracë të përbashkët.

Bukuria dhe madhështia e kësaj kështjelle ka zënë vend në shumë libra kushtuar Ali Pashës. Për të, ashtu si dhe shumë

të tjerë, ka shkruar dhe Aleksandër Dyma, autori i Konti Monte Kristos. Kështjella u ndërtua nën kujdesin e arkitektit Petro Përmetari dhe të një arkitekti Italian. Sapo kalon Qeparoin ose Himarën, përballesh me një panoramë të mrekullueshme të detit dhe në mes si një ishull i vogël duket vendi ku është ndërtuar kështjella e Porto Palermos. Ky emër i ka mbetur këtij gjiri nga koha e pushtimit të italianëve, të cilëve u kujtonin vendin e tyre, qytetin e Palermos në jug të Italisë. Ajo ndodhet në një gadishull që lidhet nga një rrip i ngushtë shkëmbinjsh e dhe me tokën. Kështjella ngrihet madhështore në ishullin e mbushur me një bimësi të ulët. Një rrugicë e ngushtë, ndërmjet kësaj bimësie të ulët nëpër gurë gëlqerorë, që të shpien në

derën e dhuratës së Pashait të Madh për të shoqen.

Dikur aty ka qenë një pllakë guri ku shkruhej: "Unë Pashai i Madh, Aliu e ndërtova këtë kështjellë". Forma e dhomave, kolonave mbajtëse me harqe dhe disa kthina të vogla të bëjnë të kuptosh se dikur ajo ka qenë e banueshme. Tashmë aty asgjë nuk të kujton kohën e Ali Pashë Tepelenës. Pamja që shfaqet nga bedenat e kështjellës është e rrallë. Prej aty duket i gjithë bregdeti si dhe Gjiri i nuseve, në të cilin, sipas legjendës, lahej nusja e Ali Pashës, Vasiliqia. Forma e tarracës tregon se në atë kohë ajo ishte një vend shumë i mirë për tu mbrojtur nga armiqët. Aty ndodheshin topat luftarakë të Ali Pashë Tepelenës si dhe vendet ku qëndronin ushtarët. Bedenat bien menjëherë mbi det, si thikë, dhe legjenda thotë se aty përfundonin armiqët e Pashait të Madh. Dhjetëra burra trimë që kishin guxuar të sfidonin Ali Pashë Tepelenën kanë përfunduar në det ose janë përplasur në shkëmbinj të ndodhen poshtë bedenave. Forma e tyre tregon se ka qenë shumë e vështirë për t'i pushtuar nga ana e detit.

Rreth 300 metra larg kështjellës, në anë të rrugës ndodhet dhe kisha e famshme, të cilën Ali Pashë Tepelena e ndërtoi personalisht për Vasiliqinë. Kjo dhuratë

simbolike ishte tepër e çmuar për Ali Pashën. Kisha ndodhej jashtë bedenave dhe ajo mund të sulmohej nga armiqët e tij. Ndaj ndërtimin e saj Pashai i Janinës ia besoi arkitektit italian, i cili e mbaroi brenda një kohe të shkurtër. Kur arkitekti italian i dorëzoi kishën Pashait të Madh dhe i kërkoi paratë për punën e kryer, ky i fundit i propozoi një provë. Ai i tha arkitektit që do t'i jepte paratë për punën e kryer vetëm nëse kisha do të ishte e fortë dhe do të duronte goditjet e topave. Pasi mbylli arkitektin italian në kishë, Ali Pashë Tepelena urdhëroi topçinjtë e tij të qëllonin mbi kishën e vogël. Disa gjyle topi ranë mbi kishë, por asaj nuk i lëvizoi as edhe një nga gurët që përbënin konstruksionin e saj.

Kjo e siguroi Aliun se gruas së tij nuk do t'i ndodhte gjë kur të ishte në kishë. Pas kësaj ai i dha paratë arkitektit italian. Edhe pas kaq vitesh kisha nuk ka pësuar ndonjë ndryshim të madh. Pra në tërësi Aliu kishte nevojë që aty të ishte një vend i sigurt, por vend i sigurt për gruan e tij të dashur apo për arin e tij? Ende deri sot nuk është zbuluar asgjë edhe pse të thënat janë të shumta. Një vend tjetër ku mendohet se mund të jetë fshehur thesari në vendin tonë është gadishulli i Karaburunit, e posaçërisht në shpellën e famshme të piratëve ose të Haxhi Alisë. Kjo shpellë fsheh misterin e saj sepse është e përbërë nga disa zgavra të vogla të cilat thuhet se lidhin dhoma me njëra-tjetrën, por kjo sigurisht që nuk është e konfirmuar sepse nuk ka dalë asnjë i gjallë që të tregojë për to, madje as trupi nuk iu është gjetur. Dysohet për këtë shpellë pasi që thuhet se Ali Pashai me të tijtë shkante shpesh aty dhe nuk ka vend më të mirë për të fshehur një thesar të të tilla përmasave.

Por le t'i hedhim një sy legjendës së kësaj shpelle legjenda e së cilës daton që në vitet 1500.

Kjo mendohet se ka qenë banesa më e sigurt e ulqinakasit Haxhi Ali Ulqinakaku, i cili bashkë me tartanët e tij kishte qenë kryekomandant i flotës turke të Mesdheut e në fund të shekullit XIX, kapedani i detit erdhi u vendos në Karaburun dhe mbronte brigjet shqiptare nga sulmet që bënin venecianët, saraçenët nga Malta dhe Egjipti, spanjollët, anglezët dhe francezët. Për plotë 22 vjet u bë mbrojtësi i këtyre brigjeve. Në luftë me venedikasit ai u vra dhe varri i tij thuhet se është në det.

Anijet kur kalonin i binin sirenavë dhe hidhnin bukë e vaj për shpirtin e tij në det. Këtë zakon e vijnë dhe disa nga banorët e Dukatit, në zonën e Ravenës, ku kanë bagëtitë që jetojnë atje. Çdo mëngjes gushti hedhin bukë e vaj në det për shpirt të Haxhi Alisë.

Kjo është shpella më e madhe e bregdetit shqiptarë cila ka një lartësi me hyrje mbi 60 metra mbi nivelin e detit dhe sipas historianëve kjo është edhe shpella që emrin e vjetër e ka dhe Shpella Iliriane. Shpella Iliriane e përdorur nga Haxhi Aliu është një dëshmitare interesante e historisë.

Duke u futur në brendësi të shfaqet një liqen në forme eliptike me aksin e madh të drejtuar nga hyrja. Salla ka një shtirje në gjatësi prej 60 m e orientuar sipas Veriperëndimi-Juglindja dhe një gjerësi nga baza (mbi nivelin e detit) rreth 40 m në pikën më të gjerë. Në tërësi shpella është e gjatë rreth 100 m.

Thellësia e liqenit të brendshëm arrin 10,4 m drejt anës verilindore të fundit të shpellës. Në paretet shkëmbore të sallës përballë hyrjes paraqiten stalaktite të pjerrta me origjinë të mundshme organogjene ose të përzier. Në hyrjen e saj janë gjetur fragmente amforash antike të shekujve të parë të epokës sonë.

Kjo shpellë vazhdimisht ka tërhequr vëmendjen e detarëve të huaj e shqiptarë. Detari i guximshëm shqiptar Haxhi Aliu e ka përdorur atë si strehë mbrojtëse duke u përlëshur me anijet e huaja grabitqare, të cilat tentonin të hynin në Gjirin e Vlorës apo të grabisnin piratisht bagëtitë e vendasve në Karaburun.

Rreth viteve 1540-1545, është përdorur nga piratët francez për t'u mbrojtur siç thuhet edhe në toponimet afër shpellës. Misteri rrethon jo vetëm thesarin në tërësi, por edhe vendet në të cilat mendohet se ai mund të jetë fshehur... Kërkimet vazhdojnë, deri më tani nuk ka asnjë gjë të re për të...



# Thyerja e miteve për planet ruse në Ballkan

Marcus TANNER

Diskutimi se Rusia “është rikthyer” në Ballkan është shndërruar në diçka të zakonshme në diplomaci dhe gazetari – sado i diskutueshëm është fakti nëse Rusia është larguar ndonjëherë që aty. Por edhe nëse ringjallja e Ruses në rajon është një fakt, pyetja kryesore është: Çfarë forme po merr kjo dhe me çfarë qëllimi? A “është kthyer” Rusia si sunduese perandorake dhe si një “vend që i prish punë” Perëndit – ose si aleate miqësore dhe kundërpeshë e nevojshme për një BE imponuese? Dallimi është shumë i rëndësishëm. Nëse është e para, Ballkani mund të presë telashe ndërsa fuqitë e mëdha do të lëkundën dhe do të përballen me njëra-tjetrën në rajon. Nëse është e dyta, vendet e Ballkanit përfitojnë duke i shitur favorët e tyre atij që ofron më shumë

Dallimi është shumë i rëndësishëm. Nëse është e para, Ballkani mund të presë telashe ndërsa fuqitë e mëdha do të lëkundën dhe do të përballen me njëra-tjetrën në rajon. Nëse është e dyta, vendet e Ballkanit përfitojnë duke i shitur favorët e tyre atij që ofron më shumë

Bechev veçon mite të mëdha nga faktet e thjeshta për të realizuar një portret të ekuilibruar të një ish-superfuqie që është tepër e zënë duke kuptuar disa – por jo të gjitha – qëllime të saj strategjike në pjesën juglindore e Evropës. Siç vëren Bechev, Rusia ka karta serioze për të luajtur në Ballkan. Ku tjetër mund të fitojë ajo duartrokitje kaq të ngrohta me kaq pak përpjekje – vetëm se është e pranishme atje?

“Është e vështirë të mohosh se Rusia dhe Putini komandojnë një mbështetje jashtëzakonisht të madhe në vendet me shumicë ortodokse lindore (Serbi, Bullgari, Greqi, Republika Srpska në Bosnjë dhe pjesa greke e Qipros),” shkruan ai.

“Nga Banja Luka në Nikosia, liderë partish dhe opinionistë shprehen për bashkëpunim ose edhe bashkim të plotë me Krem-



linin.” Megjithatë, duke pranuar se ndjenja pan-ortodokse dhe/ose pansllave është një aset i pranueshëm për Kremlinin, Bechev këmbëngul se është më pak e rëndësishme dhe më e thellë nga sa mendojnë shumë njerëz. Lëvdata e madhe e Ruses për “vëllezërit” e saj serbë rrallë përkthehet në favore ekonomike, vëren ai, duke cituar fatin e kampionit të gazit dhe naftës të Serbisë, NIS, si një paralajmërim. E shitur më lirë nga Serbia Ruses, në këmbim të përfshirjes së Serbisë në projektin e gazsjellësit “Rrjedha Jugore”, Rusia e ndaloi projektin e gazsjellësit praktikisht pa asnjë paralajmërim në 2014, duke e lënë Serbinë në anën e gabuar të marrëveshjes. Ai shton se Greqia mori të njëjtin trajtim. Shoqëria greke është një tjetër shoqëri instinktivisht pro-ruse, vë në dukje ai,

dhe partia e majtë e Syrizes ishte tepër pro-Kremlin në opozitë, duke e kritikuar ashpër Ukrainën “fashiste” dhe madje duke përsëritur detur marrjen e Krimesë nga Rusia. Por kur lideri i ri i Greqisë, Alex Tsipras, u shfaq në mënyrë dramatike në Moskë me tasin e tij të lypjes, duke shprehur se Rusia do të mbledhte para për të bërë të mundur që Greqia të sfidonte kushtet e ashpra të shpëtimit të Perëndimit, Putini ktheu krahët pa u treguar i gatshëm ta mbështeste. Tsipras u detyrua të tërhiqej i poshtëruar, duke u kthyer në duart e evropianëve të frikësuar dhe Greqia ka mbetur nën tutelën e tyre ekonomike që atëherë. Rusia nuk është partneri i vetëm që po luan një lojë komplekse në Ballkan, vëren ai. Serbia paralajmëron përkushtimin filial ndaj Ruses, kujton ai, por

kjo nuk e ka ndaluar Serbinë të ndjekë në mënyrë pragmatike anëtarësimin në BE, apo t’i afrohet në heshtje NATO-s. Ndërkohë që proteston vazhdimisht vendosmërinë e saj për të mos iu bashkuar kurrë aleancës, ajo bashkëpunon në mënyrë diskrete me NATO-n në shumë mënyra të ndryshme.

Ballkani Lindor, Rumania dhe Bullgaria, janë një tjetër zonë ku pamjet e jashtme të mashtrojnë, shkruan Bechev. Në legjendën gazetareske, shkruan ai, Rumania ka qenë gjithmonë “motra latine” e Perëndimit, duke sfiduar Rusinë edhe kur ajo ishte pjesë e bllokut sovjetik. Përkundrazi, Bullgaria përshkruhet gjithmonë si një portë ruse – “republika e 16-të sovjetike” në kohën e komunizmit – dhe jo shumë ndryshe tani. Bechev shkruan se rusët me siguri shpresonin që të ishte kështu edhe me Bullgarinë, duke kujtuar se sa i lumtur ishte Kremli kur Bullgaria u fut në BE, duke e parë Sofjen si “Kalin e Trojës” të Ruses në Bruksel. Por Rumania shpesh ka qenë shumë më e interesuar për tregtinë ruse sesa e shpreh, shton ai, ndërsa Bullgaria, po aq shpesh, ka qenë një aleate më e vështirë sesa priste Moskë.

Në të vërtetë, Bullgaria

rezulton se pëlqen një nga ata miq që të bëjnë gjithmonë lëvdata dhe janë servilë kur i takon në rrugë – por që shkojnë zhduken në mënyrë misterioze kur u kërkon një nder. Bechev e përfundon librin e tij tërheqës, i cili përfshin edhe Greqinë, Qipron dhe Turqinë, duke këmbëngulur se ajo që ne nuk po shikojmë në Ballkan është një rikthim drejt një perandorie të stilit të vjetër rus. Rusia, thotë ai, është e vendosur të ndërhyjë në planet e Perëndimit me rajonin, sesa të rikrijojë shtete satelitore atje si një mënyrë hakmarrjeje për humbjen e bllokut të vjetër sovjetik. Për të gjithë mekanizmin e saj mbi energjinë, asaj i mungon muskuli ekonomik për të nxjerrë plotësisht ndonjë nga këto shtete nga orbita e saj dhe as nuk ka ndonjë lloj “modeli” shtetëror për të eksportuar përtej thirrjeve të zbehta ndaj konservatorizmit kombëtar. Autori e mbyll librin duke hedhur poshtë nocionin se Moskë është disi përgjegjëse për problemet e padysimita të rajonit. “Nga Beograd në Ankara,” shkruan ai “demokracitë jofunksionale, kapja e shtetit dhe kthimi i shpinës ndaj politikës autoritare janë në tërësi sëmundjet e brendshme, jo një rezultat i një komploti të keq moskovit

# Polonia i largohet demokracisë dhe fajin e ka Donald Trump!



Slawomir SIERAKOWSKI

Demokracia polake arriti një fitore të pjesshme momentale të hënën, kur Presidenti Andrzej Duda vuri veton për dy ligje kontraktore që do t’i jepnin partisë në pushtet, Law e Drejtësi, kontroll direkt mbi gjykatat e Polonisë. Fitorja është momentale sepse Duda bëri të ditur se shpejt do të paraqiste versionin e tij të legjislacionit. Nuk është sekret që partia Ligj e Drejtësi dhe lideri i saj, Jaroslaw Kaczynski, i kanë sytë mbi pavarësinë e gjyqësorit, një nga pengesat për të marrë kontrollin e shtetit polak. Më pak i mirëpritur por jo më pak i qartë është roli që ka luajtur SHBA në inkurajimin për të marrë një hap të tillë. Kaczynski dhe partia e tij janë përp-

**Dhe kështu Trump erdhi në Varshavë, konfirmoi përkushtimin karshi Nenit 5 të NATO-s për mbrojtjen kolektive dhe premtoi kontrata për shitjen e raketave Patriot dhe gazit natyror Polonisë**

jekur për të kapur pushtetin që kur fituan zgjedhjet parlamentare më 2015, por sivjet kanë qenë veçanërisht të pacipë. Gjatë një takimi të Bashkimit Evropian në mars, ata u përpoqën të ndalonin zgjedhjen e Donald Tusk, ish-kryeministër i Polonisë dhe kundërshtar i Kaczynskit, për një mandat të dytë si kreu i Këshillit të Evropës.

Humbën 27 vota me 1, një turpërim që kontribuoi për një rënie të lirë në sondazhe, çka si pasojë i ka bërë të synojnë për më lart e më shumë. Prej këtu vijon edhe projektligjet e drejtësisë, të cilat i kanë

mbështjellë me retorikën për nevojën e reformës së gjyqësorit. Në këtë rrëmujë hyn në skenë Donald Trump, edhe ai vetë mes kontraktave dhe në kërkim të lëvdatave. Shtëpia e Bardhë njoftoi se rrugës për takimin e G20 në Hamburg të Gjermanisë, ai do të vizitonte Poloninë, një vend i cilësuar prej kohësh si më pro-amerikani në Evropë. Shtëpia e Bardhë përcaktoi edhe detajet: Zoti Trump do të pritej nga turma entuziaste, duke i dhënë botës përshtypjen e një lideri të fortë amerikane të adhuruar nga masat e huaja dhe liderët e tyre. Volitshëm, meqenëse mbledhja e Nismës së Tre Deteve do të mbahej në Varshavë, Trump mund të takohej me liderët e 11 vendeve të tjera të rajonit brenda një kohe të shkurtër. Vizita i volitej edhe Kaczynskit. E luftuar në Evropë, qeveria e tij kishte nevojë të tregonte se Polonia gëzonte respektin e njërit prej politikanëve më të fuqishëm të botës.

Dhe kështu Trump erdhi në Varshavë, konfirmoi përkushtimin karshi Nenit 5 të NATO-s për mbrojtjen kolektive dhe premtoi kontrata për shitjen e raketave Patriot dhe gazit natyror Polonisë. Partia e Kaczynskit solli autobusët me turmë entuziaste dhe të dyja palët arritën në konkluzionin – dhe me të drejtë – se vizita ishte e suksesshme. Pozicioni i Ligj e Drejtësi (LED) në sondazhe u përmirësua; më i freskëti, zhvilluar para votimit për reformën në drejtësi, tregoi 38% përkrahje për partinë dhe vetëm 19% për Platformën Civile, partia më e madhe e opozitës. Vizita e z. Trump rastisi me legjislacionin për drejtësinë, i cili ishte në pritje të votës në Sejm, dhoma e ulët e parlamentit polak. Por pak para mbërritjes së tij, projektligjet u tërhoqën në mënyrë të papritur. Megjithatë, sapo pikët në sondazhe dhe lëvdatat në shtyp nisën të rriten, partia i nxori përsëri projektligjet, duke shtuar një të tretë, për zgjedhjen e anë-

tarëve të Gjykatës së Lartë nga Sejmi. Meqenëse Gjykata e Lartë konfirmon rezultatit e zgjedhjeve parlamentare dhe atyre presidenciale, projektligji do t’i jepte LED-it kontroll jo vetëm mbi gjykatat, por edhe mbi rezultatet elektorale (ky ishte një nga projektligjet mbi të cilët Duda vuri veton).

Me pak fjalë, në shkëmbim të disa duartrokitjeve, z. Trump i dha Kaczynskit përkrahjen për të kryer një puç. Dhe çfarë kanë bërë Shtetet e Bashkuara që atëherë? Departamenti i Shtetit nxori një deklaratë të thatë të formuluar për të mos ofenduar autoritetet polake (“Ne u bëjmë thirrje palëve të sigurohen që çdo reformë në drejtësi nuk shkel Kushtetutën e Polonisë”). Nuk mendohet që Trump pajtohet me kapjen e pushtetit nga Kaczynski. Por, duke mos e përdorur vitizën për t’i bërë presion liderit të LED për të respektuar demokracinë, Trump i dha miratimin e nënkuptuar reformës së re për kthimin

e projektligjit në ligj. Dhe ndërsa Duda tregoi pavarësi politike me veton ndaj dy drafteve, në rastet e tjera ai ka qenë gjithmonë aleat besnik i Kaczynskit. Mbetet të shohim nëse draftet e rinj do të jenë vërtet kundër atyre të Kaczynskit apo vetëm sa do të shtojnë ndikimin e vetë Presidentit Duda mbi gjyqësorin, në dëm të Ligj e Drejtësi. Përgjegjësia finale bie mbi polakët dhe janë atë që duhet të përgjigjen, siç kanë bërë në mënyrë të admirueshme gjatë javëve të fundit, me protestat masive, të cilat, me shumë gjasa, ishin ato që sollën veton e Dudës. Por deri vetëm pak kohë më parë nuk do të kishin qenë vetëm. Kjo ishte pikërisht nga ato situata kur presidentët amerikanë do të kishin përdorur prestigjin e vendit të tyre për të ushtruar presion për liri e demokraci. Tani, përtej entuziazmit të turmave të orkestruara, gjithçka që populli polak dëgjon nga Shtëpia e Bardhë është heshtja. (*New York Times*)





## Ajeti të hënën konfirmohet te klubi i ri

Largimi i Arlind Ajeti nga Torino siç duket është vetëm çështje kohe, por raportohet se ai do të vazhdojë aventurën e tij në Serie A. Sipas "Sky Sport Italia" shërbimet e tij i ka siguruar Krotone, dhe që nga hëna ai do të jetë lojtar i klubit kalabrez. Krotone siguroi hyrjen në Serie A në ndeshjen e fundit të sezonit të kaluar, dhe dëshiron ta mbajë këtë status për një kohë të gjatë. Dhe për këtë Krotone po kërkon edhe dy lojtarët e Milanit, Xhovanni Krokiata dhe Patrik Kutrone.

## Tani edhe Lacio kërkon Zenelin

Arbër Zeneli mund të transferohet në kampionatin italian Serie A. Sulmuesi kosovar, ka shkëlqyer edicionin që lamë pas në kampionatin holandez. Xhenoa dhe Torino janë dy skuadrat italiane që kanë shprehur dëshirë për transferimin e Arbit në Serie A. Por së fundmi në garë është futur edhe skuadra e madhe italiane Lacio, që po kërkon një zëvendësim të Balde Keitas. Sipas mediave italiane dhe atyre holandeze, vlera e Zenelit sillet rreth pesë milionë euro. Kujtojmë që Zeneli u largua nga Përfaqësuesja e Suedisë për të pranuar të luajë me Kosovën.



Lajmi konfirmohet edhe në faqen zyrtare të skuadrës nga Çairi. Ndeshja FC Shkupi – FC Prishtina luhet me 6 gusht (e diel), me fillim në orën 17:00 në stadiumin e Çairit dhe prite të jetë një festë e vërtet për dashamirët e futbollit

Shkup, 30 korrik - Skuadra e Shkupit po vazhdon përgatitjet intensive në qendrën sportive në Mavrovë, ku tani më nëntë ditë me radhë është duke qëndruar në këtë kompleks stërvitur, ku mbretërojnë kushte të mrekullueshme për punë dhe akumulim të forcës për sezonin e ri. Gjatë qëndrimit në Mavrovë skuadra deri më tani ka organizuar dy ndeshje kontrolluese, fillimisht kishte luajtur me KF Renovën (0:1), ndërsa në ndeshjen e radhës e zhvilloi dje përballë skuadrës së Flamurtarit nga Prishtina. Ndryshe, Shkupi me 31 korrik (e hënë) përfundon fazën e përgatitjeve në Mavrovë, për tu kthyer në Shkup ku do të fillojë dhe faza e tretë, ndërsa ndeshjen e fundit të kontrollueseve Shkupi ka vendosur të luajë para publikut në Çair, e për kundërshtarë do të jetë skuadra

## Ndeshje vëllazërore dhe spektakël më 6 gusht



# Shkupi pret në Çair FC Prishtinën



nënkampione e Kosovës, FC Prishtina. Marrëdhëniet e mira në mes dy klubeve shqiptarë nga kryeqendrat Shkupit dhe Prishtinës njëherit do ta

bëjnë që kjo ndeshje të jetë vëllazërore. Lajmi konfirmohet edhe në faqen zyrtare të skuadrës nga Çairi. Ndeshja FC Shkupi – FC Prishtina

luhet me 6 gusht (e diel), me fillim në orën 17:00 në stadiumin e Çairit dhe prite të jetë një festë e vërtet për dashamirët e futbollit.



## Ndaj Trakait pa Cuculin, Zhuniorin e Vujçiçin

Ardian Cuculi dhe Stenio Zhunior, të ndëshkuar me kartonë të kuq në takimin me Trakain në Vilnius do të humbin ndeshjen e kthimit me ekipin nga Lituania. Vendimi për Cuculin është përfundimtar, ndërsa rasti Zhunior do të diskutohet më 4 gusht kur do të vendoset nëse do të ketë pezullim shtesë. Derisa, për Vujçiçin ndeshjet e LE por edhe pjesa e parë e sezonit futbollistik ka përfunduar



mbledhjen e Trupit të UEFA-së për Etikë dhe Disiplinë që do të mbahet më 4 gusht. Ndërkohë, Shkëndija ka humbur edhe Stefan Vujçiçin, pasi mesfushori gjerman ka rezultuar me lëndim serioz. I dëmtuar në ndeshjen e kthimit me HJK Helsinkin në Finlandë në turin e dytë eliminator të UEFA Liga Evropë, Vujçiç la ndeshjen nën dhimbje të gjurit të këmbës së djathtë. Për shkak se kishte këmbën e ënjtur u desh të pritët disa ditë për ekzaminimet e detajuara, të cilat fatkeqësisht konfirmuan se mesfushori ka të këputura ligamentin e përparmë të kryqëzuar të këmbës së djathtë. Lëndimet e këtitilla kërkojnë periudhë më të gjatë rikuperimi dhe Vujçiç së shpejti do të nënshtrohet ndërhyrjes kirurgjike. Nga kjo del se garat për ndeshjet e Liga Evropës, por edhe pjesa e parë e sezonit vjeshtor, për mesfushorin e Shkëndijës kanë përfunduar dhe kjo do të jetë një hendikep i madh për trajnerin Qatip Osmani duke marr parasysh se Vujçiç ishte njëri prej organizatorëve kryesor të lojës.

Shkup, 30 korrik - Trupi i UEFA-së për Etikë dhe Disiplinë në adresë të klubit ka lëshuar njoftimin për vendimet në lidhje me pezullimet e lojtarëve që u ndëshkuan me kartonë të kuq në takimin e parë të raundit të tretë të UEFA "Europa League" kundër Trakait në Vilnius të Lituanisë. Kujtojmë, Stenio Zhunior direkt me të kuq në minutën e 57-të pas një dueli me lojtarin kundërshtar, ndërsa në minutën e 62-të Ardian Cuculi pas kartonit e dytë të verdhë, u ndëshkua me të kuq duke lënë ekipin me 9 lojtarë në terren. Kështu mbrojtësi do të humbë ndeshjen e kthimit me Trakain të enjten, ndërsa do të kthehet në skuadër nëse ekipi siguron kualifikim në plej of. Ndeshjen me Trakain do ta humbasë edhe Zhunior, mirëpo në vendimin e UEFA-së thuhet se rasti i brazilianit do të shqyrtohet edhe një herë në

## "AS" gëzon dashamirët e futbollit në Maqedoni

# Ronaldo dëshiron të luajë në Super Kupën në Shkup

Shkup, 30 korrik - Një lajm i mirë për dashamirët e futbollit në Maqedoni, të cilët patën fat të pajisen me bileta për ndeshjen e Super Kupës, ndërmjet Realit të Madridit dhe Mançester Junajtedit, e cila më 8-gusht do të zhvillohet në "Telekom Arena" në Shkup. Në fakt, ylli i Realit të Madridit Kristiano Ronaldo dëshiron të jetë pjesë e skuadrës për ndeshjen e Super Kupës, edhe pse paraprakisht u tha se ai do të mungojë.



Sipas gazetës "AS", Ronaldo dëshiron të luajë kundër ish-skuadrës së tij Mançester Junajted, edhe pse mediat spanjolle raportuan se ai do të mungo-

jë në këtë ndeshje, për shkak të pushimit të madh që e mori nga trajneri i Realit, Zinedin Zidane. Kujtojmë, Ronaldo ishte pjesë e përfaqësue-

ses së Portugalisë në Kupën e Konfederatave. Ndërkohë, sipas mediave spanjolle, Ronaldo të martën do të fillojë me stërvitjet te Reali dhe ka ndërmend që në mënyrë ekspres të përgatitet për këtë përballje. Gjithsesi për këtë do të vendos trajneri Zidane, por nëse portugezi kërkon që të jetë pjesë e ekipit, atëherë ai nuk do të bëjë probleme duke marr parasysh autoritetin që ai e ka te skuadra madrilene.

## Reagon edhe Ministria e Drejtësisë e Shqipërisë

# Ekstradimi i Morinës, i parregullt

Ministria e Drejtësisë nëpërmjet një njoftimi ka ofruar mbështetjen për Ismail Morinën, si shtetas shqiptar pas vendimit të Gjykatës së Dubrovnikut për ekstradimin e "Ballist" Morinës në Serbi. Ministri Gazment Bardhi i ka bërë një kërkesë ministrit të Drejtësisë së Republikës së Kroacisë ku e cilëson si të parregullt kërkesën e Serbisë për ekstradimin e Morinës, pasi ajo nuk përmbush kriteret e pranimit sipas Konventës Evropiane për Ekstradim dhe "Paktin Ndërkombë-

tar" për të drejtat civile dhe politike. Sipas njoftimit të Ministrisë së Drejtësisë duke vlerësuar se kërkesa për ekstradim bie ndesh me Konventën e Këshillit të Evropës "Për ekstradimin" dhe Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Në këtë shkresë, Ministria e Drejtësisë ka marrë angazhimin që në një kohë sa më të shpejtë të përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kroacisë të gjitha faktet dhe provat që dëshmojnë se jemi përpara një

shkelje politike, për të cilën bazuar në nenin 3 të Konventës së Këshillit të Evropës. "Për ekstradimin", nuk mund të akordohet ekstradimi. Ministri i Drejtësisë në kërkesën drejtuar autoriteteve kroate ka argumentuar se në rast ekstradimi në Serbi, shtetasi shqiptar Ismail Morina rrezikon t'i nënshtrohet përndjekjes, persekutimeve apo diskriminimeve të motivuara politikisht për shkak të shtetësisë së tij dhe gjendjes personale apo

shoqërore, çka përbën shkelje të një të drejtat themelore të njeriut, që duhet të pengojë miratimin e kërkesës për ekstradim. Për këtë qëllim, ditën e djeshme Ministria e Drejtësisë ka kërkuar bashkëpunimin e Federatës Shqiptare të Futbollit për t'i vënë në dispozicion të gjitha faktet dhe provat që dëshmojnë përdorimin politik nga autoritetet serbe të ngjarjes së ndodhur në stadiumin e Beogradit në tetor të vitit 2014, si dhe sjelljes çnjerëzore të tifozëve dhe



personelit serb të stadiumit ndaj ekipit kombëtar shqiptar, me qëllim provueshmërinë e rrezikut real që i kanoset shtetasit Ismail Morina për shkak të shtetësisë së tij shqiptare në rast ekstradimi në Serbi. Gjithashtu dhe FSHF nëpërmjet një lajmërimi në faqen e saj në internet ka bërë të ditur se

Presidenti i Federatës, Armand Duka ka pasur një komunikim intensive me kryeministrin e vendit Edi Rama për këtë problem. Kreu i Ekzekutivit së bashku me Presidentin e FSHF kanë marrë kontakt të vazhdueshëm edhe me autoritetet kroate për zgjidhjen përfundimtare të procesit.



**MIA ISLAMI, ARSIMITARE E EDUKATËS FIZIKE DHE ISH-SPORTISTE**



# SPORTISTJA SHQIPTARE VAZHDON TË DISKRIMINOHET

“Kemi qenë vetëm dy femra, unë dhe Nixhar Nagavci ‘Xhixhi’ profesoresha e edukatës fizike në gjimnazin ‘Zef Lush Marku’. Duke marr parasysh se edhe në shkollë fillore kam mësuar në gjuhën maqedonase, nuk e kam pasur vështirë të kryej edhe fakultetin. Problem ka qenë të kyçemi në ndonjë sport”, thotë Islami

**Koha** | Bujar KURTAJ

Shkup 30 korrik – Përparimtare, luftarake dhe këmbëngulëse, kështu është Semia Islami “Mia”, arsimtarja e edukatës fizike dhe themeluesja e KH ‘Çair’ për femra. Që nga fëmijëria ka shprehur dashurinë e madhe për sportin, duke u marrë me atletikë e më pas edhe me hendboll, mirëpo rrethanat e asaj kohe kanë bërë që ajo të ndërpresë karrierën, por jo edhe tërheqjen nga sporti. Ka kaluar nëpër shumë sfida, por asnjëherë nuk është dorëzuar dhe sot e kësaj dite vazhdon punën si arsimtare, por edhe te klubi hendbollistik i vajzave. Gjitha këto, por edhe sfidat tjera nëpër të cilat ka kaluar “Mia”, i tregojnë intervistën për gazetën KOHA.

**KOHA: Kush është Semia Islami dhe si lindi ideja që të merreni me sportin e atletikës?**

**ISLAMI:** Jam Semia Islami, ndërsa të gjithë më njohin si ‘Mia’. Jam e lindur në Shkup në lagjen Serovë, ku edhe rininë time e kam kaluar këtu. Inspirimi për t’u marr me sport ka qenë nga vëllai im. Ekrem Islami. Si e re në lojërat

fëmijërore sfidoja djemtë e lagjes në gara, ndërsa në shkollën fillore ‘Cvetan Dimov’ më ndihmoi shumë edhe arsimtari i edukatës fizike, i cili më inkuadroi në garat shkollore nëpër krose të ndryshme dhe garat e atletikës. Ai, në fakt ka qenë i pari që ka zbuluar talentin që kisha për këtë sport dhe më

pas, siç thash, vëllai im Ekrem Islami më dha mbështetje të pazezervë. Kur jemi të vëllai, më duhet të them se edhe ai është marrë me gjimnastikë dhe ka qenë ish-mundës, por që lëndimi e detyroi atë para kohe të ndërpret karrierën sportive. Pas kësaj, ai vëmendjen e ktheu tek unë duke më

udhëzuar fillimisht të kryej shkolim e mesme të Edukatës Fizike në Shkup dhe paralelisht më regjistroi edhe në Klubin e Atletikës ‘Vardar’, ku trajneri im i parë ka qenë Buçkovi.

**KOHA: Përmende se ke qenë anëtare e KA ‘Vardar’. A mund të**

**na tregosh sukseset që i ke arritur në këtë klub?**

**ISLAMI:** Te klubi i atletikës ‘Vardar’ qëndrova vetëm një vit e gjysmë. Gjatë kësaj periudhe të shkurtër, kam marr pjesë nëpër gara të ndryshme shtetërore, duke arritur rezultate mesatare. Shembull, në 800 metra isha ndër atletet më të mira, ku aso kohe



“Në shtator do ti paraqes dy liga por jam me rezervë ta bëj apo jo pasi nuk financa dhe palestra. Nevojitet dikush që të organizojë se cila palestër është për hendboll e cil për basket, pastaj mundje, futsall. Kemi klube por kushte nuk kemi. Jemi i vetëm klub i femrave dhe hasim në probleme të njëjta



garoni tetë vajza, me një fjalë rezultati më i mirë ka qenë pozita e tretë.

**KOHA: Pas një viti e gjysmë u largove jo vetëm nga KA 'Vardar', por edhe nga sporti në përgjithësi. A mund të na i tregosh arsyet për tërheqjen tënde nga sporti?**

**ISLAMI:** Largimi nga atletika dhe sporti nuk ka qenë me dëshirën time, por rrethi ku jetoja më 'dënoi' të merrem profesionalisht me sport. Kur them rrethi, kjo nënkupton fqinjët që i kisha në lagjen ku jetoja, pasi nga familja kam pasur përkrahje të madhe. Shembull, paradite duhej të shkoj në shkollë, ndërsa stërvitjet ishin pas orës 17, dhe ata nuk mund ta kuptonin se si është e mundur që një femër shqiptare të merret me sport dhe gjitha ato gjëra nuk munda t'i duroj as unë, por edhe as familja, kështu që vendosa të tërhiqem.

**KOHA: Pasi u tërhoqe nga sporti, iu përkushtove studimeve?**

**ISLAMI:** Siç thash edhe më herët, kam kryer shkollën e mesme të edukatës fizike në 'Metodija Micevski Brico' në Shkup, edhe atë në gjuhën maqedonase, pasi atëherë nuk kishte paralele në gjuhën shqipe dhe pas shkollës se mesme në vitin 1979/80 gjithashtu në Shkup u regjistrova në fakultetin e Edukatës fizike. Kemi qenë vetëm dy femra, unë dhe Nixhar Nagavci 'Xhixhi', profesoresha e edukatës fizike në gjimnazin 'Zef Lush Marku'. Duke marrë parasysh se edhe në shkollë fillore kam mësuar në gjuhën maqedonase, nuk e kam pasur vështirë të kryej edhe fakultetin. Problem ka qenë të kyçemi në ndonjë sport.

**KOHA: Pasi përfundove studimet, ndodhi e papritura dhe iu riktheve sportit, por jo sportit të atletikës, po atij të hendbollit. A mund të na tregosh se çfarë ndodhi?**

**ISLAMI:** Siç e dini, atletika është sport individual, ndërsa hendbolli ekipor. Më duhet të tregoj se derisa isha në shkollën e mesme, kam marrë pjesë në sportin e hendbollit, mirëpo nuk pata rastin të regjistrohem edhe për ndonjë klub. Nga përvoja që kisha dhe pasojave nga e kaluara kur merresha me atletik, nuk guxova të filloj prapë të jem aktive. E gjithë që doja atëherë ishte t'i përfundoj studimet dhe të punësohem diku. Por, prapë po përsëris se si femër shqiptare kam vuajtur shumë duke marrë parasysh pretendimet që i kam pasur si e re.

**KOHA: Bashkë me trajnerin e mirënjohur dhe seleksionuesin aktual të Kombëtares së Shqipërisë, Muhamed Ismaili dhe Ajdin Ramadanin, hapët edhe shkollën e hendbollit për femra dhe meshkuj të cilin më pas e shndërruat në klub duka ia vënë emrin KH 'Rinia'. A mund të na tregosh rrugëtimin e gjithë kësaj?**

**ISLAMI:** Me Muhamedin nuk jemi njohur, por ai personalisht është njohur me vëllain tim, Ekremin, pasi harrova të përmend se vëllai ka qenë profesor i fizikës dhe matematikës, ndërsa pikërisht Muhamedi ka qenë nxënës i tij. Nëpërmjet tij u njohëm dhe ai më shpallosi një ide që të fillojmë të hapim një shkollë. Pa menduar shumë e pranova ofertën e tij, ndërsa bashkë me mua ishte edhe arsimtari i matematikës dhe ish hendbollist i 'Rinia' Ajdin Ramadan dhe në vitin 1996/97 formuam KH 'Rinia'. Filluam, siç ishim marr vesh, me vajza dhe djemte. Meqenëse unë isha në arsim, i selektoja vajzat nga shkollat



**“ Nga viti 1998 u punësova në arsim dhe në rrethinën time ku kam jetuar, më njohin shumica dhe asnjëherë nuk kam pasur problem dhe kam qenë e pranuar shumë mirë. Duke marr parasysh se për nga natyra jam një përparimtare i kushtoj shumë rinisë, sidomos femrave dhe gjithmonë kam 'luftuar' më shumë për ata. Sportistët meshkuj nuk e kanë pasur problem të arrijnë suksese, pasi ata nuk kanë pasur pengesa nga rrethi dhe as prej prindërve. Unë them që jo vetëm atëherë, por edhe sot kësaj dite femra shqiptare diskriminohet.**

fillore, ndërsa pasi formuam ekipin, merrnim pjesë në garat shkollore në nivel shtetëror. Kështu në vitin 1998 me vajzat morra pjesë për herë të parë në gara, pra garonin për sh.f '7 Marsi' në të kaluarën 'Dame Gruev'. Në fakt, kjo ishte hera e parë vajzat shqiptare të merrnin pjesë në gara, që për mua ishte një moment shumë domethënës. Arritëm pozitën e pestë, nga 12 shkollat sa morrin pjesë që për mua ishte një sukses i madh, duke marr parasysh se vajzat për herë të parë dilnin jashtë Shkupit. Ndeshjen e parë e fituam ndërsa në të dytën pësua disfatë. Por, më pas për shkak të mungesës së kushteve, sallës sportive, vendosa të ndërpres aktivitetin tim tek vajzat, ndërsa aktivitetet i vazhdoi KH 'Rinia'.

**KOHA: U largove nga KH 'Rinia' dhe vendose të hapësh KH 'Çair'. Si erdhi deri te themelimi i këtij klubi të vetëm shqiptar për femra në Maqedoni?**

**ISLAMI:** Jam e vetmja femër që ka regjistruar klub të hendbollit për vajza. Çairi si komunë u for-

mua në vitin 2007. Më ofruan palestrën 'Partizani' që gjendet në Çair në muajin tetor të vitit 2008 regjistrova edhe KH 'Çair'. Vitin e ardhshëm do të bëhen 10-vite që ekziston ky klub. Në fillim masiviteti ishte i madh, ku numri u arrit në mbi 100-vajza edhe atë në kategorinë pionier, kadetë dhe junior. Mirëpo, për fat të keq palestra 'Partizani' u djeg dhe nuk kishim ku t'i zhvillojmë stërvitjet. Në fakt, ne stërviteshim, por ndryshonim shkollat dhe bëhej më e vështirë. Ndryshe, gjatë gjithë kësaj kohe merrnim pjesë në gara, dhe jemi anëtare të Ligës së parë. Derisa ishim në Ligën e parë, u plasuam në pozitën e tretë, por për shkak të financave nuk dëshironim që të hymë në Superligë, edhe pse realisht mundeshim ta bëjmë atë. Pas kësaj dolëm nga Liga dhe tani me vendim të Federatës u tërhoq nga kalendari Liga e parë dhe tani garojmë në kategoritë e pionierëve, kadetëve dhe për juniore.

**KOHA: A mund të na tregosh se a ka pasur hendbolliste të talentuara te KH "Çair"?**



**ISLAMI:** Arritja më e madhe e imja ka qenë që nga KH 'Çair' të nxjerrë edhe reprezentuese. Arlinda Dinarica është anëtare e përfaqësueses së Maqedonisë për kadet dhe Leonora Rahmani për përfaqësuesen e Kosovës. Kuptohet, në arritjen e kësaj kanë kontribuar edhe bordi im me të cilin kam punuar. Sigurisht se ka pasur edhe hendbolliste tjera të talentuara si Melisa Ajdini, e cila ka qenë një hendbolliste jashtëzakonisht e talentuar, por për shkak që klubi nuk luajti në Superligë ajo u tërhoq dhe merret me studime, pastaj motrat binjake Arlinda dhe Mirlinda Dinarica, Bajra Bakiq dhe Leonora Rahmani, të cilat janë pjesë e Superligës së Kosovës.

**KOHA: A mund të na tregosh cili është momenti më i mirë në aspektin sportiv që të ka ndodhur deri më tani?**

**ISLAMI:** Ka shumë momente, por momenti më i mirë që më ka ndodhur gjatë aktivitetëve të mia sportive ka qenë, një mijë vajzat që kanë kaluar nëpër duart e mia. Kisha pasur dëshirë që kur të

tërhiqem te ketë kush të më zëvendësojë.

**KOHA: Po momenti më i keq?**

**ISLAMI:** Momenti më i keq ka qenë kur klubi dy apo tre herë ka qenë pranë shuarjes e gjithë kjo për shkak të mungesës së financave, sallave dhe terminëve për stërvitje. Por, fatmirësisht bashkë me lojtaret mbijetua dhe përkrahjes së prindërve dhe Komunës mbijetua dhe vazhduam me gara.

**KOHA: Nga kush e keni mbështetjen më të madhe?**

**ISLAMI:** Nëntë vite sa ekzistojmë sigurisht se më ka ndihmuar dikush, por ajo është simbolike. Komuna është përkrahësi që nuk shuhet dhe Bajram Imeri nga 'Ef-tinia Impeks' që na ndihmon shumë duke na dhuruar veshjet sportive si dhe familja ime. Unë e kam thënë edhe në të kaluarën, e them edhe tani, kushdo që do, le të urdhërojë e ta menaxhojë kubin. Jo që nuk kemi talente, ato janë shumë, por ata kanë nevojë për kushte dhe të paguhen siç paguhen klubet e hendbollit tjera në Maqedoni.

**Koha: Duke marr parasysh se mbi një mijë vajza i ke udhëhequr, a i mban kontaktet me to?**

**ISLAMI:** Sigurisht se po, shpesh takohemi dhe bisedojmë për ndodhitë që i kemi përjetuar. Sidomos për festën e Bajramit, kur vijnë më vizitojnë. Me një fjalë nuk më harrojnë dhe kjo më bën krenare.

**KOHA: Kush është në jetën private Semia Islami?**

**ISLAMI:** Jam nënë dhe arsimtare e edukatës fizike si dhe kam një djalë. Djali Emiri nuk merret me sport dhe asnjëherë nuk ia kam imponuar faktin që ai të ndjek hapat e nënës së tij. Si i vogël ka qenë aktiv në not, më pas ka ushtruar te KH 'Rinia', por nuk zgjati shumë dhe ai tash punon në një firmë.



Për atë, që i ka shpëtuar aksidentit të tmerrshëm ajror të nëntorit të 2016-ës, tani ka ardhur momenti të kthehet në fushën e lojës. Gjithçka është gati. Më 7 gusht, kundër Barcelona-s (ndeshje e vlefshme për Trofeun Gamper) së fenomeneve, shumë shikime do të jenë të drejtuar nga ai. Sepse Rushel është kthyer në një simbol, i jetës që mposht vdekjen, i vazhdimësisë, si një stafetë që i duhet kaluar atyre që kanë ardhur pas tragjedisë, për të rindërtuar një ekip që u zhduk në pak sekonda

Kushedi si do të ndihet Alan Rushel në momentin kur do të kalojë në tunelin që çon te fusha e lojës. Kushedi sa mendime do t'i kalojnë në kokë, sa kujtime me shokët e skuadrës së Çapekoense, të cilët nuk janë më. Për atë, që i ka shpëtuar aksidentit të tmerrshëm ajror të nëntorit të 2016-ës, tani ka ardhur momenti të kthehet në fushën e lojës. Gjithçka është gati. Më 7 gusht,

## Mrekullia e Alan Rushel

# Sfidon Barcelonën tetë muaj pasi fitoi ndaj vdekjes



kundër Barcelona-s (ndeshje e vlefshme për Trofeun Gamper) së fenomeneve, shumë shikime do të jenë të drejtuar nga ai. Sepse Rushel është kthyer në një simbol, i jetës që mposht vdekjen, i vazhdimësisë, si një stafetë që i duhet kaluar atyre që kanë ardhur pas tragjedisë, për të rindërtuar një ekip që u zhduk në pak sekonda. Do të zbresë në fushë për herën e parë pas

një periudhe të gjatë po aq sa një shtazani. Duket sikur fati ka ruajtur një jetë të re për atë dhe tani ka ardhur momentin për të rilindur. Çapekoense ka shprehur, nëpërmjet një komunikate zyrtare, gëzimin për kthimin në ekip të mbrojtësit. "Është një hap i rëndësishëm për rikuperimin e tij dhe për rindërtimin e klubit. Duke marrë parasysh më pas rëndësinë

e ndeshjes, është një rast ideal për kthimin e tij", thuhet në komunikatën e Çapekoense.

kujtojmë, Ka qenë 28 nëntori i 2016-ës kur një avion ka rënë në jug të Medelin, në Kolumbi, duke shkaktuar vdekjen e 71 personave (nga 77 që ishin në avion mes pasagjerëve dhe ekuipazhit). Mes tyre, kanë humbur jetën pothuajse të gjithë pjesëtarët e Çapekoense. Skuadra braziliane po udhëtonte për të zhvilluar finalen e Kupës së Amerikës së Jugut kundër Atletico Nacional. Vetëm tre lojtarë shpëtuan, Rushel, Neto (mbrojtës, ka pësuar disa fraktura dhe një tronditje të fortë në kokë) dhe Follmann (portier, të cilit i është amputuar një këmbë për shkak të plagëve të mëdha).

## Kutinjo dëshiron me çdo kusht transferimin te Barcelona

Raportet e fundit nga mediat britanike thonë se Filipe Kutinjo me çdo kusht dëshiron të largohet dhe për këtë do të vetë-deklarohet, dhe do i kërkojë trajnerit Jurgen Klop që ta lejojë transferimin e tij te Barcelona. "Braziliani e dëshiron transferimin në 'Camp Nou' për të luajtur përkrah Messit dhe lojtarëve të tjerë, dhe do të ulët për të biseduar me Klop-in për t'i treguar arsyet pse e dëshiron këtë transferim", shkruan 'Mirror'. Dhe si zëvendësues të tij Klop-i synon të sjellë yllin e Dortmundit, Kristian Pulisic. Klubi katalunas pritet të rrisë ofertën në 100 milionë euro për Kutinjo, pasi e para prej 90 milionë euro është refuzuar nga "Të Kuqtë".

## Perishiç qëndron te Interi

Manchester Junajtedi duket se duhet të dorëzohet për blerjen e Ivan Perishiçit nga Interi. Pavarësisht interesimit të vazhdueshëm të djajve të kuq për futbollistin kroat, trajneri zikaltërve Luciano Spalati ka vendosur veton lidhur me shitjen e tij duke theksuar se lojtarin nuk do të largohet nga "San Siro" dhe duhet të mësohet me këtë fakt.

## Klop nuk dorëzohet për Naby Keita

Jurgen Klop duket se është dorëzuar për blerjen e Naby Keita. Trajneri i Liverpoolit ka pranuar se Leipzig ka refuzuar vazhdimisht ofertat e "The Reds" për futbollistin nga Guineja, përfshi dhe një prej 70 milion sterlina dhe me shumë gjasa transferimi i Keitas në "Anfield Road" është i pamundur pavarësisht se vetë futbollisti e dëshiron diçka të tillë.

## Guardiola kërkon Martinezin

Pep Guardiola nuk ndalet në merkato. Trajneri i Manchester Sittit ka bërë me dije se dëshiron të blejë një tjetër qendërmbrojtës pavarësisht se ka shpenzuar jo pak për këtë repart. Sipas mediave angleze, Pep dëshiron të afrojë te blutë nga Manchesteri, Inigo Martinez te Real Sociedadit ose gjermanin Holger Badstuber. I vetmi problem i tij është që ka tejkulluar shpenzimet e klubit sa i përket repartit të mbrojtjes dhe ndoshta klubi mund të vendosë kufizime për blerjen e një tjetër futbollisti në prapavijë.

## Juventus rivalizon Arsenalin për Karvalon

Juventus është gati të sfidojë Arsenalin për nënshkrimin e Uilliam Karvalos, i cili ka një klauzolë prej 40 milionë eurove në kontratën e tij me Sporting CP. Sipas gazetës italiane "Tuttosport", "Zonja e Vjetër" ka kthyer vëmendjen e tyre kah mesfushori portugez, Krvalo, i cili është edhe objektivi i Arsenalit. Mesfushori 25-vjeçar gjithashtu mund të luajë në qendër të mbrojtjes kur është e nevojshme, duke i bërë atë një shtesë të vlefshme për skuadrën e bardhezinjve. Karvalo erdhi përmes Akademisë së Sportingut dhe tashmë ka 37 paraqitje për ekipin e parë të kombëtares së Portugalisë. Ndërsa, Juve vazhdon negociatat me Paris Sent-Zhermen për Blaise Matuidi, ata po ashtu synojnë Karvalon si një mundësi më të re për mesfushën e tyre. Portugezi ka një klauzolë lirimi prej 40 milionë eurosh në kontratën e tij dhe Juventus përballë me konkurrencë nga Arsenal.

## Van Persi rikthehet në "shtëpi" pas 13 vitesh

Pas dy vitesh në Turqi dhe plot 13 vjet larg "shtëpisë", Robin Van Persi është shumë pranë rikthimit në Holandë, dhe pikërisht te klubi i tij i parë si profesionist, Fejenord. Janë mediat holandeze ato që kanë dhënë lajmin e madh të rikthimit në shtëpi të 34-vjeçarit, ish-lider i sulmit të "Tulipanëve". Sipas medias holandeze, futbollisti i cili tashmë është te Fenerbahçe, me të cilën mbylli sezonin e dytë, është shumë pranë transferimit në Holandë, pas plot 13 vitesh larg, që nga koha kur u largua nga Fejenord, për tu transferuar në Premier Ligë te Arsenal. Të njëjtat burime konfirmojnë edhe kushtet e marrëveshjes së re të Robin Van Persi: kontratë për një sezon, me opsion shtyrjen me një tjetër vit në bardhekuq. Ky është propozimi i klubit të Fejenord.

## Gallata konfirmon bisedimet me pesë lojtarë të mëdhenj

Klubi i madh turk, Gallatasaraj dëshiron të lë shenj në këtë afat kalimtar. Skuadra nga Stambolli tashmë i është bashkangjitur një afati kalimtar produktiv, duke transferuar sulmuesin Befetimi Gomis, mesfushorin Jounes Belhanda dhe mbrojtësin Mariano. Megjithatë, klubi i madh turk nuk dëshiron të ndalet me kaq, pasi duan edhe përf forcime tjera të



mëdha, me synim të fitojnë Ligën e Turqisë ose të kualifikohen në Ligën e Kampioneve. Drejtori sportiv i klubit, Xhenk Ergun ka treguar se janë duke monitoruar pesë futbollistë të kalibrit botëror dhe janë në bisedime me ta për t'i

transferuar. Anëtori i Uest Hemit, Sofiane Feghouli dhe mesfushori i Manchester Sittit, Fernando janë në bisedime të avancuara dhe mund të përfundojnë në Stamboll shumë shpejt. Ndërsa, tre yjet tjerë më vështirë të arritshëm për Gallatasarajin janë Marouane Fellaini i Manchester Junajtedit, Arda Turan i Barcelonës dhe Hatem Ben Arfa i PSZH.

## Interi këtë javë zyrtarizon Dalbertin

Interi vazhdon negociatat e tyre për Dalbert Henrikue dhe shpreson të sigurojë një marrëveshje me Nican për 20 milionë euro plus bonuset javën e ardhshme. Sipas "Sky Sport Italia", përfaqësuesit e skuadrës nga Ligue 1 do të jenë në Itali të martën për të ndihmuar në përfundimin e detajeve të fundit Mbrotjtësi i majtë ka shpre-



hur në mënyrë të përsëritur dëshirën e tij për t'u bashkuar me Interin këtë verë. Ai ishte gjithashtu i bezdisur nga tifozët e Nice

kur bëri një paraqitje të dobët në raundin para-eliminativ të Ligës së Kampioneve kundër Ajaksit. Oferta e fundit në tryezë është me vlerë 20 milionë euro plus bonuse në bazë të paraqitjeve. Dalbert i mbush 24 vjet në shtator dhe në sezonin e kaluar kontribuoi me katër asistime në 33 paraqitje të Ligue 1.

## Venger: Sançez nuk largohet

Pas suksesit 5-2 kundër Benfikas, bos i Arsenalit, Arsen Venger, ishte pjesë e një konference për shtyp. Fillimisht francezi u ndal te ndeshja, më pas gazetarët e pranishëm e "bombarduan" me pyetjet rreth të ardhmes së sulmuesit kilian Aleksis Sançez - me Venger që edhe një herë tjetër siguroi tifozët e "Topçinjve" se kiliani nuk largohet në këtë merkato vere. "Ai do të qëndrojë, sigurisht që Aleksis është pjesë e ekipit për sezonin e ardhshëm!". Më pas

biseda shkoi në dëmtimin e tij të supozuar që e ka penguar atë që të kthehet në Londër, rreth kësaj çështjeje Venger tha: "Unë kam biseduar me të dhe kemi shkëmbyer edhe mesazhe me tekst. Ai do të kthehet në Angli dhe do të kthehet në stërvitje me ne brenda pesë ditëve të ardhshme". Gazetarët vazhduan ta ngacmonin trajnerin francez me pyetje të ndryshme rreth mesazheve që ai ka shkëmbyer me sulmuesin kilian, por 67-vjeçari



refuzoi të jepte më tepër informacion dhe u largua duke thënë: "Nuk mund të flas më për këtë, ai po qëndron, por sot nuk mund ta diskutoj më këtë çështje". Klubit më prestigjioze të Evropës si Bajern Munihi, Manchester Siti dhe Paris SZH kanë shfaqur interese për të nënshkruar me 28-vjeçarin që ka edhe një vit të mbetur në kontratën e tij me "Topçinjtë".



## Roma mendon për Suson pas refuzimit për Mahrezin

Nëse Roma nuk mund të bëjë Leicester Sittin që ta ulë çmimin e kërkuar për Rijad Mahrezin, ata do të kthehen për të provuar për anëtorin e Milanin, Suso. Drejtori sportive i Romës, Monçi ka konfirmuar se ai do të fillojë të shikojë drejt objektivave tjera pasi Leicesteri refuzoi dy oferta për Mahrezin. Sipas "Corriere dello Sport", opsioni tjetër në listën e dëshirave të Romës është Suso, i cili po e gjen veten gjithnjë e më shumë të shtyrë në marginat e Milanit. Ai nuk ka nënshkruar një kontratë të re, me marrëveshjen e tij të tanishme që operon deri në qershor të vitit 2019, dhe do të ishte një zëvendësim ideal për Mohamed Salahin në anën e djathtë të sulmit. Rossonerët kishin një zbatim të shpenzimeve këtë verë me 10 lojtarë të rinj dhe ende kanë nevojë për të marrë të paktën një sulmues, kështu që Suso mund të kërkojë më shumë kohë të rregullt të lojës në skuadra tjera. Monçi dhe Roma kishin synuar tashmë 23-vjeçarin para se të hynin me të gjitha forcat për shërbimet e Mahrezit.





# BE nis duelin juridik me Poloninë

Polonia nuk po i prapëson planet për reformën në gjyqësor, prandaj Komisioni Evropian nisi përdorimin e "armëve" ligjore. BE-ja hapi kundër Polonisë procesin për shkelje të marrëveshjeve të BE-së për shkak të reformës së diskutueshme në organet e gjyqësorit të këtij vendi. Kjo ndodhi pas publikimit të njërit prej ligjeve në Gazetën Zyrtare të Polonisë, njoftoi Komisioni Evropian



## "BREXITI MUND TË NDALET"

Kryetari i Londrës, Sadiq Khan, thotë se Brexit mund të ndalet nëse Partia Laburiste kërkon – në zgjedhjet e ardhshme – të mos të largohet nga BE-ja ose të mbajë referendum për marrëveshjen e daljes së Britanisë së Madhe. "Unë jam një optimist. Që të kemi kredibilitet në publik, duhet të kemi një ofertë manifesti nga ana laburistëve, që publiku të mos thotë: 'Ngadalë, votuam për të dalë e tash po i drejtoni gishtat te ne'", ka thënë ai për Guardian, transmeton Telegrafi. "Duhet ta themi bardhezi se çka do të bëjmë nëse fitojmë zgjedhjet parlamentare. Ne mund të trumbetojmë me rezultatet e referendumit duke pasqyruar ofertë që thotë se si do të dalim nga BE apo se do të kemi referendum të dytë". Propozimi i tij mund të krijojë ndarje mes laburistëve. Kreu i partisë, Jeremy Corbyn, ka thënë se do të respektojë referendumin e vitit të kaluar për të lënë BE.

Procedura e shkeljes së marrëveshjeve të BE-së mund të çojë në padë pranë Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe në dënime me gjoba. Polonia ka njoftuar se do të reformojë organet e drejtësisë. Kjo ka shkaktuar reagime të forta në Bruksel. Zëvendës-presidenti i Komisionit të BE-së, Frans Timmermans, ka kërcënuar madje me "bombën atomike politike", me të cilën në zhargonin e Brukselit nënkuptohen sanksionet më të rënda ndaj një vendi anëtar. Fjala është për heqjen e së drejtës së votës në Këshillin Evropian. Kjo parashikohet në nenin 7 të Marrëveshjes së Amsterdimit. Kjo masë ndaj vendeve që devijojnë nga rruga demokratike u përfshi në këtë marrëveshje në vitin 1999, me rastin e zgjerimit të BE-së drejt lindjes. Deri tani kjo masë nuk

është zbatuar ndaj asnjë vendi. Protesta kundër reformës së organeve të drejtësisë në Poloni. Gjatë kësaj jave Presidenti i Polonisë, Andrzej Duda, arriti të ndalte me veton e tij dy nga katër

ligjet për reformën gjyqësore në Poloni për të cilat ka mosmarrëveshje të forta. Njëri nga ligjet e bllokuar është ai për riformimin e Gjykatës së Lartë. Komisioneri holandez Frans

Timmermans e kishte sidomos këtë ligj halë në sy, dhe kishte deklaruar se nëse ky ligj do të hyjë në fuqi dhe do të çojë në shkarkimin e shefit të drejtësisë, ai nuk do të ngurrojë të përdorë në "çdo kohë" nenin 7 dhe të ndezë "bombën atomike". Çështja nëse sanksionet me të cilat kërcënohet Polonia do të zbatohen, është ende krejt e hapur dhe procesi për heqjen e së drejtës së votës në Këshillin Evropian një vendi anëtar kalon në dy faza. Së pari këtë duhet ta miratojë Parlamenti Evropian, më pas Këshilli Evropian. Në parlament duhet që një e pesta e shteteve anëtare të konstatojnë në marrëveshje me Parlamentin Evropian nëse Polonia është vërtet në rrezik që të dalë nga rruga e sundimit të ligjit dhe të demokracisë. Kurse në këshill nevojitet vendim unanim dhe presidenti i Hungarisë Viktor Orban ka deklaruar se do të votojë kundër, sepse e konsideron qeverinë polake si mike politike. Përveç heqjes së të drejtës së votës në Këshillin Evropian një mundësi tjetër është që Varshavës t'i shkurohen paratë që merr nga Brukseli. Meqenëse nenin 7 i Marrëveshjes së Amsterdimit, pra heqja e së drejtës së votës në Këshillin Evropian, nuk është zbatuar asnjëherë deri tani, në Bruksel - sikurse edhe në rastin e Brexitit (neni 50) nuk e di askush se si do të zhvillohet një procedurë e tillë dhe se sa kohë mund të zgjasë ajo.

## Të shtëna në një lokal nate në Gjermani, ka edhe viktima

Gjermania u zgjua e tronditur sërisht nga një ngjarje e rëndë e ndodhur këtë herë në qytetin Konstanz. Një person i armatosur ka hapur zjarr në një lokal nate rreth orës 04:30 minuta, duke vrarë një pjesëtar të sigurimit të lokalit, që u përpoq ta ndalonte. Paniku ka zgjatur për disa minuta, deri kur agresori u qëllua nga policia pas një shkëmbimi zjarri. Ai u plagos rëndë gjatë të shtënave dhe më pas u shoqërua menjëherë drejt spitalit, ku edhe ndërroi jetë si pasojë e plagëve të marra. Nga të shtënat ka mbetur i plagosur edhe një oficer policie. Policia thotë se janë plagosur lehtë edhe dy persona të tjerë, ndërkohe që në zonë kanë mbërritur forcat speciale që po krehin zonën pasi ende është e paqartë nëse agresori ka vepruar i vetëm, apo ka patur bashkëpunëtorë. Motivet e ngjarjes janë ende të paqarta, por ajo riktheu panikun në vend, pas ngjarjes së të premtës në Hamburg, ku një person sulmoi me hanxhar qytetarët në një supermarket të qytetit duke vrarë një person.

Publicitet

## OFERTË E NXEHTË OPEL

- Pajisje të pasur
- Çmim atraktiv
- Risi të klasës së parë
- Opel FlexCare – garanci dhe ndihmë në rrugë

Astra K Enjoy 1.4 100KF  
**14.840€**



## Për përjetime të reja verore.

Lidhje Intellilink me telefon celular, ekran shumëfunksional 7", drita të ditës LED dhe dritat të përparme për mjegull, rrota aliozhi, timon lekure, tempomat ...

opel.mk



Modeli i shfaqur i veturës është vetëm për ilustrim dhe nuk ka të bëjë me këtë promovim. Opel Southeast Europe LLC dhe shitësit e autorizuar mbajnë të drejtën për të ndryshuar ose tërhequr ofertën në çdo kohë dhe pa njoftim paraprak. Për më shumë informacion kontaktoni shitësit e autorizuar Opel. Oferta vlen deri më 30.09.2017.

Automakedonija 02 310 31 30

Auto CEM 044 353 330





Xharra ka ofruar dëshmi sesi edhe drejtori i Shpend Ahmetit, Hysen Durmishi, për gjashtë muaj ia kishte dhënë mbi 1.2 milion euro ish-kompanisë ku vetë kishte punuar

Partia Demokratike e Kosovës, Dega në Prishtinë, ka vazhduar me denoncimin publik të asaj që kjo parti e quan "klientelizëm familjar dhe partiak" në Komunën e Prishtinës, e cila qeveriset nga Shpend Ahmeti, "ku miliona euro u janë dhënë përmes tenderëve kompanive të afërta me Vetëvendosjen"

Anëtar i kryesisë së PDK-së, Blerand Stavileci, ka falënderuar qytetarët e Prishtinës për furnizimin e vazhdueshëm me dëshmi për, siç thotë ai, "rrjetin e krimit dhe korrupsionit në administratën e Prishtinës". "Qytetarët tashmë janë të vetëdijshëm se qeverisja e Shpend Ahmetit dhe bandat kriminale të Vetëvendosjes i kanë zhvatur gjatë këtyre 4 vjetëve. Janë të vetëdijshëm se partia Vetëvendosje e ka kthyer Komunën e Prishtinës në servis partiak, ku shpërblehen në mënyrë të kundërligjshme grupet vandalizuese dhe frymëzuesit e militantëve të tyre për sulme ndaj institucioneve", ka thënë Stavileci. Ndërsa, Arbana Xharra, ka prezantuar edhe faktet që, sipas PDK-së, argumentojnë skemat klienteliste mes zyrtarëve të Vetëvendosjes dhe grupeve të interesit jashtë saj. Ajo ka thënë se në këtë rrjet klientelist janë të përfshirë madje edhe familjarë të zyrtarëve që marrin vendime në Komunën e Prishtinës. "Përmes dokumenteve ne kemi demaskuar këtë rrjet klientelist, që merret me tenderë, me leje ndërtimi dhe me forma të tjera të klientelizmit familjar dhe partiak në Komunën e Prishtinës", ka thënë Xharra. Xharra së pari ka përmendur lidhjet klienteliste familjare dhe bashkëpunimin e kundërligjshëm të Shpend Ah-

# PDK prezanton dokumente për Komunën e Prishtinës Vetëvendosje po i vjelë tenderët milionësh në Komunën e Prishtinës

**Ilir Gjinolli**  
Gjinolli ishte projektues privatisht edhe i dy banesave për "Deshishku Construction" në Kalabri, për të cilat u mor leja nga Shpend Ahmeti.

**Miku i Shpend Ahmetit**  
Është hartues i Planit Rregullues për Kalabri dhe për Arbëri përmes kompanisë "Urban Plus", me pronar Ilir Gjinolli. Përmes këtij plani e ka legjitimuar legalizimin e objekteve pa leje. Planet rregulluese nuk njihen me ligj. Ndërsa, në vend se t'i ndërprite kontratat për të bërë planifikime për shkak të konfliktit të interesit, Komuna e Prishtinës ia kanë vazhduar kontratat për të hartuar plane rregulluese.

**Shpend Ahmeti**  
Kryetar i Komunës Prishtinë

**Dhëndri I Ylli Hoxhës**  
Ia lëshoi pozicionin e Anëtarit në Komitetin për Planifikim Urban dhëndrit të tij, Nol Binakaj, Binakaj i Nol Binakaj, Hamit Binakaj, dhe pronar i kompanisë "D-Plan" dhe e ka përgatitur projektin në Zonën Mirënjohje dhe Gërbëzime. Isha i shpallur, magji për në Mirënjohje, shpërndarje Prokurimit, bashkëpunim, e kishte anuluar projektin e firmës "Kosovë" në këtë zonë. Komuna e Prishtinës bashkëpunon me organizatën qeveritare "Fondacioni Kosovë për Arkitekturë", gjendë e të cilët edhe dhëndri Ylli Hoxhës, Nol Binakaj, Hamit Binakaj, bashkëpunuar edhe për regjistrimin urban dhe planifikim impozues, pa debat të hapur me qytetarët. Kjo QDO kishte të punësuar edhe dhëndërin të Vetëvendosjes, që me pa kurrë kaluar me kontrata për shërbime të veçanta në administratën e Komunës së Prishtinës.

**Shpend Ahmeti dhe Nol Binakaj**

**Hamit Binakaj dhe Milet Sejdiu**

**Milet Sejdiu ka punësuar gruan e tij në Ndërmarrjen Banesore**

**Ylli Hoxha**

**Shpend Ahmeti dhe Nol Binakaj**

**Legji e shpallur në 1 korrik 2013, kompania "Radoni" mori të ndërtojë**

**Legji e shpallur në 1 korrik 2013, kompania "Radoni" mori të ndërtojë**

**Legji e shpallur në 1 korrik 2013, kompania "Radoni" mori të ndërtojë**

**Legji e shpallur në 1 korrik 2013, kompania "Radoni" mori të ndërtojë**

metit përmes mikut të tij, Ilir Gjinolli, të Dardan Sejdiut përmes djalit të axhës së tij, Milet Sejdiut, si dhe të Ylli Hoxhës përmes dhëndrit të tij, Nol Binakaj, i cili është edhe anëtar i Komitetit për Planifikim Urban. Gjithashtu, anëtarja e PDK-së, Arbana Xharra, ka thënë se kryeqyteti po shtrohet me kubëzat e kompanisë së neuropsikiatrit të Vetëvendosjes, Jusuf Ulaj, i cili është edhe kryesues i Komitetit për Shëndetësi në Vetëvendosje dhe ishte edhe kandidat për deputet i tyre. "Bulevardi mbi Kurriz në Dardani, sheshi Luan Haradinaj dhe bulevardi Perandori Justinian te Katedralja, te Tre Sheshirat, janë shtuar me kubëzat e kompanisë së Jusuf Ulaj. Gjithashtu, Zyra për Regjenerim Urban ka bërë projekte për Jusuf Ulaj. Prishtina po shtrohet me

pllakat e tij. Në kompaninë RUB, Jusuf Ulaj është bashkëpronar edhe me Samir Rexhën, mikun e tij, i cili është edhe njëri prej përfutuesve më të mëdhenj në Komunën e Prishtinës", ka thënë Xharra. Miku i kandidatit të Vetëvendosjes, Samir Rexha, me kompaninë "Rexha", Xharra ka thënë se po i vjelë tenderët e Prishtinës. "Kompania 'Rexha' që katër vjet nuk ka qenë në gjendje ta finalizojë projektin e Bulevardit mbi Kurriz në Dardani. Pra, këta jo vetëm se kanë fituar miliona me tenderë, por as punët nuk i kanë kryer", ka thënë Xharra, e cila ka ofruar dëshmi sesi edhe drejtori i Shpend Ahmetit, Hysen Durmishi, për gjashtë muaj ia kishte dhënë mbi 1.2 milion euro ish-kompanisë ku vetë kishte punuar. Xharra ka përmendur edhe afërsinë e Ah-

metit me pronarët e kompanive "Green Door", ku pronar është Driton Tefiku, si dhe kompaninë "Rraci Ark", me pronar Kreshnik Rracin, si projektues të shumë projekteve ndërtimore, "që i shfrytëzojnë lidhjet e tyre për të siguruar pastaj edhe leje ndërtimore në administratën e Prishtinës". Ndërsa, nënkryetari i Degës së PDK-së në Prishtinë, Shems Veseli, ka folur edhe për atë që PDK e quan "skandalin e Shpend Ahmetit, i cili i kishte dhënë tender edhe ish-studentes së tij". Veseli ka kërkuar nga Prokuroria e Shtetit, që "përkundër frikësimeve, përkundër linçimeve publike dhe terrorit digital që po ua bëjnë militantët e Vetëvendosjes prokurorëve dhe gjykatësve të Kosovës, t'i kthejnë sytë nga krimi sistematik, që po ndodhë në Komunën e Prishtinës".



## Shqipëria "pushtohet" nga turistët

Policia e Shqipërisë ka njoftuar se gjatë paradites së sotme ka pasur një fluks të madh në hyrje të turistëve, vizitorëve dhe pushuesve që kanë zgjedhur plazhet e Shqipërisë për të pushuar apo kaluar fundjavën. Sipas një njoftimi të Policisë, deri tani kanë hyrë nëpërmjet pikave të kalimit kufitar 21.890 shtetas, si dhe 4975 automjete. "Policia Kufitare po punon me shërbime të shtuara për të përballuar fluksin, duke eliminuar radhët e gjata në këto pika. Fluksi i lëvizjes në të gjitha akset rrugore në këto momente është normalizuar, pasi ka pasur shumë ngarkesë nga ora 07.00 deri në orën 09.00. Përveç aksit Shkodër -Lezhë, që vijon të ketë shumë ngarkesë, që vjen si rezultat i fluksit të madh në hyrje dhe dalje nga pikat e kalimit kufitar të Muriqanit dhe Hanit të Hotit. Shërbimet e Policisë Rrugore janë të shtrira në të gjitha akset kryesore dhe në akset që të çojnë në plazhet e vendit", thuhet në njoftimin e Policisë, transmeton kp. Në këto akse rrugore, Policia Rrugore po kryen kontrolle me Radar në versionin "autmatik", për të evidentuar dhe ndëshkuar drejtuesit e mjeteve që tejkalojnë shpejtësinë tej limitit të lejur duke u kthyer në burim aksidenti dhe rreziku për përdoruesit e tjerë të rrugës. Policia e Shtetit fton qytetarët, pushuesit, turistët e vizitorët të telefonojnë në numrat 112 e 129 për çdo problem që mund të kenë, duke siguruar se shërbimi policor do t'ju vijë në kohën e duhur dhe cilësor. Gjithashtu të denoncojnë çdo paligjshmëri, çdo abuzim me detyrën të punonjësve të policisë, me qëllim që të gjithë së bashku të kontribuojnë për një ambient social sa më të sigurt.

## Rama: Sfidë, njeriu i duhur në zyrën e shtetit



Kryeministri Edi Rama u ndal në Fier në dëgjesën e radhës me qytetarët, ku foli për reformimin e administratës dhe reduktimin e zyrave të shtetit. "Kemi një sfidë shumë të madhe përpara, që t'i gjejmë zyrës së shtetit njeriun e duhur, dhe jo njerëzve një punë shteti", tha Rama. Synimi është, sipas Kryeministrit, që të shmanget

ajo që e quan sorollatje të qytetarëve nëpër zyrat e shtetit. "Nëse qytetari ka një dokument për të marrë në një zyrë, dokumentin shtet më shtet ta marrë shtetit dhe të mos shkojë njeriu nëpër shtatë zyra, por të shkojë shteti dhe kjo është plotësisht e realizueshme", u shpreh ai. Një rol të madh në këtë, vijoi Rama, do të luajë

edhe teknologjia dhe ofrimi i shërbimit online për kryerjen e pagesave dhe tërheqjes së dokumentave të ndryshme. Teknologjia do të shërbejë edhe për atë që Rama e quan "bashkëqeverisje me njerëzit". "Me ndërtimin e një platforme bashkëqeverisjeje online me njerëzit, kjo është plotësisht e mundur", u shpreh ai.

# Çështja me Kosovën më mirë të zgjidhet tani, se pas 100 vitesh

Bashkëjetesa dhe raportet e mira të Shqiptarëve me Serbet që jetojnë në Zvicër duhet të shërbejnë si model për Kosovën dhe Serbinë ka thënë Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në një intervistë për të përditshmen zvicerane "Blick"



Në këtë intervistë, Vuçiq ka thënë se ai do të hap një kapitull të re për Serbinë, që do të thotë të gjejë një zgjidhje për problemin me Kosovën. I pyetur për domethënien e fjalës së tij në Inaugurimin si President, ku Vucic kishte thënë se Serbia duhet të shkëputet nga

mitet e saj, Vuçiq tha se dëshiron një Serbi të re dhe të reformuar. "Është lehtë të thuhet, shkoni e luftoni në Kosovë! Mirëpo kjo mënyrë e të menduarit na ka dërguar gjithmonë në luftë. Unë dua një rrugë të re për Serbinë. Dua që të hap diskutime të drejta dhe korrekte për zgjidhjen e konfliktit të

Kosovës. Edhe nëse serbët nuk janë ende gati unë nuk do të dorëzohem. Ky debat do të ketë efekte shëruese për të gjithë ne edhe nëse arrijmë apo jo rezultat të mirë", ka thënë Vuçiq për Blick. Më tutje, ai ka thënë se ky dialog nuk do të kishte rezultat të mirë nëse të dy palët nuk janë të gatshme që të

humbasin diçka. "Nëse të dy palët nuk janë të gatshme të humbasin diçka, atëherë nuk do të ketë rezultat të mirë dhe konflikti do të zgjas përgjithmonë. Kjo do të dëmtonte të dy palët. Unë besoj se jam personi i duhur për këtë dialog. A e dini pse? Kam qenë deputeti më i ri, ministri dhe kryeministri më i ri, dhe tani jam presidenti më i ri. Nuk kam më ambicie personale", ka thënë ai. I pyetur se nga cka janë në gjendje që të heqin dorë serbët për ta zgjidhur problemin e Kosovës, ai nuk ka pranuar që të flas publikisht. "Jemi të gatshëm që të gjejmë një kompromis të mirë dhe të bëjmë progres. Eventualisht kjo çështje duhet të zgjidhet dhe më

mirë të bëhet tani sesa pas 100 vitesh", ka thënë ai. Ministri serb i Mbrojtjes, Aleksandar Vulin, ka thënë se plani i presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, për Kosovën përfshijet njohjen e pavarësisë së saj, dhe këto qëndrime duhet t'i shpërfaqin të edhe të gjitha institucionet në të cilat Serbia beson fuqishëm. "Njohja e Kosovës dhe Metohisë është e përjashtuar. Nuk ka bisedime për të. Nga marrëveshjet e Brukselit, sipas informatave të mia, ia kemi dalë që të ruajmë shtetin serb në Kosovë e Metohi", ka thënë Vulin për "Politikën" serbe, transmeton Koha.net. Vulin ka shtuar se Vuçiq nuk është njeri që hyn në diçka pa e menduar mirë.

"Ky nuk është sulm, nuk është hyrje në barrikadë. Është çështje shtetërore. Natyrisht se ai e ka planin e vetë", ka thënë Vulin. Sipas Vulinit, shteti serb e ka ruajtur popullin serb dhe ndikimin e tij në jetën e përditshme në Kosovë, "ndërsa tani është koha që të shkojmë tutje". Ministri serb i Brendshëm, Aleksandar Vulin, ka thënë se edhe Ushtria e Serbisë duhet ta thotë mendimin e saj. "Ushtria nuk ka dhe nuk duhet të ketë qëndrim kur kemi të bëjmë me politike ditore, por duhet të tregojë se çfarë mendon për Kosovën e Metohinë. Të gjitha institucionet në të cilat serbët besojnë fuqishëm duhet ta paraqesin qëndrimin e tyre", shtoi Vulin.





Shkolla e Vashave më 1891 do të ishte një tjetër arritje e madhe dhe një domosdoshmëri e kohës. Ajo u ideua si një projekt i Gjerasim Qiriazit, por u realizua dhe u bë kuptimi i gjithë ëndrrave e sakrificave të jetës së motrave të tij, Sevasti edhe Parashqevi Qiriazit. Arsimit shqiptar lindi e mori tiparet e tij kombëtare në mëngjesin e përpjekjeve shtetformuese

Zhulieta GRABOCKA

Në historinë e arsimit shqiptar pas hapjes së shkollës së parë shqip më 1887 në Korçë, Shkolla e Vashave më 1891 do të ishte një tjetër arritje e madhe dhe një domosdoshmëri e kohës. Ajo u ideua si një projekt i Gjerasim Qiriazit, por u realizua dhe u bë kuptimi i gjithë ëndrrave e sakrificave të jetës së motrave të tij, Sevasti edhe Parashqevi Qiriazit. Arsimit shqiptar lindi e mori tiparet e tij kombëtare në mëngjesin e përpjekjeve shtetformuese. Platforma e tij si një diell iluminizues i siguroi që në hapat e para një të ardhme qytetare civilizuese të aftë për të ecur përkrah vendeve të moderuara. Shkollat e para shqipe u bënë vatrat e kristalizimit të platformës së Rilindjes sonë Kombëtare. Zgjidhja e çështjes së alfabetit, shënon fillimin e përpjekjeve për standardizimin e gjuhës së shkruar shqipe. Hartimi i teksteve e vizioni perëndimor i orientimit të arsimit së bashku me eksperiencat e metodikës amerikane të edukimit të befasojnë me prioritet e treguara. Rruga e përhapjes së dijeve ka heronjtë e saj. Sakrificat e tyre i ngjajnë misionit Prometian të vetësakrificimit. Në fluturimin vizionar ata i ngjajnë nositit fjalëzjarr të Lasgushit. Në fund të jetës Sevastia edhe familja e saj u kryqëzua si një Krisht. Por në rrugën e ndërjegjësimit shpirtëror e kulturor të brezave figura atdhetare e mësuesit mbetet nga më të respektuarat. Për çdo shqiptar të thjeshtë mësuesi mishëron edukatorin e së ardhmes së vendit. "Mësueset e popullit" Sevasti dhe Parashqevi janë konceptuar të pandara në këtë mision pavarësisht kontributeve të tyre të veçanta. Shembulli i tyre është aktual edhe sot, se "Ne mundemi" të ngremë arsimin në lartësinë e de-tyrave të epokës digjitale dhe nxënësin të aftë të zgjedhë informacionin në një botë të re e përherë në ndryshim. Çdo hap individual duhet të vlejë si fara e një bime të mbarë, frytet e së cilës do të vilen në të ardhmen.

#### Jetëshkrimi

Në vitin 2016 u botua jetëshkrimi i pabotuar i "Mësueses së Popullit" Sevasti Qiriazit – Dako "Jeta ime" nën përkush-

Mësuesja e popullit

# Sevasti Qiriazit, krenaria dhe ëndrra e një vajze



timin e kërkimeve hulumtuese prej dy dekadash nëpër arkiva e dokumente të studiueses Dana Stucky. Ky libër u botua së bashku me koleksionin e botimeve me rastin e përvjetorit të 500-të të Reformacionit Protestant në Europë, të 200 vjetorit të projektit për përkthimin e Biblës në gjuhën shqipe e tjera ngjarje që lidhen me botimin e Ungjijve dhe themelimit të Vëllezërishë Ungjillore në Shqipëri. Vepra "Jeta ime" përshkruan përjetimet vetiake "të romancës heroike" të "Mësueses së Popullit" siç vlerësohet vetë jeta e saj e prej studiuesve ky libër. Nëpër faqet e librit vetërrëfimi i Sevasti Qiriazit rrjedh i natyrshëm e modest, me vetëpërmbajtjen e një protagonisteje në vorbullat e historisë kur duheshin marrë veprime të guximshme e të mençura. Hapja e Shkollës së Vashave, në qytetin e Korçës ishte një akt historik, jo vetëm i domosdoshmërisë së edukimit të vajzave për të thyer konceptet që i mbanin mbërthyer brenda 2 të shtëpisë, por synimi i tyre ishte më i madh, përgatitja e vajzave e grave si misionare e veprimtare të së ardhshmes emancipuese të shoqërisë. Në këtë mision prijtar shikuesit shqiptarë të ekranit të

madh e kishin përjetuar figurën e Sevastisë në filmin kushtuar Mësonjtores. Skenari i Natasha Lakos i jepte mundësi aktorese së madhe Roza Anagnosti të mishëronte shpirtin idealist deri në therrori të Sevasti Qiriazit. Të gjitha elementet regjisoriale të filmit e sjellin epokën e udhës së shkronjave të plotë në detaje: si një aspiratë, si një luftë midis së mirës e së keqes, si rruga e vetme e davaritjes së errësirës shpirtërore drejt dritës së diturisë, drejt prosperitetit të vendit. Askush nuk e përmendte në kohën e diktaturës, se vepra i kushtohej jetës së Sevastisë e Gjerasimit Qiriazit, as nuk thuhej se ekzistonte një jetëshkrim i pabotuar i saj. Autorët e filmit ia kanë dalë të përjetësojnë "monumentin" e ngritur në kujtesën e gjallë, që njerëzit e thjeshtë e ruanin nëpër zemrat e tyre për anëtarët e familjes Qiriazit. Korça do të ishte



amfiteatri, që priste krahëhapur bijtë e bijat e tij të realizonin ëndrrat më të guximshme e të sfidonin kohërat. Prej veprës së tyre buron qytetaria e krenaria e ligjshme që ndjen sot i madh e i vogël për veprën e tyre atdhetare e humaniste. Bibli i gjuhës shqipe do të bekonte nismën e shenjtëruar të Sevastisë në shtëpinë të tij. Libri i Sevastisë është njëherazi edhe një sprovë historike. Ajo sjell një analizë të detajuar të fakteteve dhe protagonistëve të drejtpërdrejtë të ngjarjeve para edhe pas vitit 1912, si stadi të historisë së Ballkanit... "Nëse faktet e mia, – shkruan ajo, shkaktajnë dhimbje nuk është faji im. Është faji i atyre që i bënë të këqijat dhe shpuan zemrat e të pafajshmëve". Drama e kufijve e luajtur në kurriz të copëzimit të trojeve shqiptare prej fuqive të mëdha nga kancelaritë e Europës, janë faqet ku

dhimbja e Sevastisë për humbjet e gjymtyrëve të trupit të tretur prej robërisë i nënshtrohet objektive të qarta të njohjes dhe të mbrojtjes së të drejtave universale të popujve të vegjël! Ajo nuk rresht së përmendur lashtësinë, indentitetin kulturor dhe origjinalitetin e gjuhës shqipe, si një degë e veçantë në trugun e pemës së gjuhëve indovropiane. Ajo udhëton prej Manastirit në drejtim Turqisë kontinentale në një moshë shumë të re, por e rritur në shpirt prej ëndrrës së saj të madhe. Çdo udhëtim i saj nëpër Europë e deri në Amerikën e largët ishte në funksion të "idealit të hershëm" siç shprehet ajo, – të ngrija popullin tim drejt shkollimit dhe pavarësisë!

#### Koto Hoxhi

Largpamësia e Sevastisë është rrjedhë e natyrshme e formimit të saj, e aktit të parik-

thyeshem të "aventurës së parë". Kur në burgun e famshëm Jedikule të Bosforit do të takonte një ndër shqiptarët me të shquar të kohës Koto Hoxhin. Historia herioke e jetës së tij e bëri Sevastinë të mos lerë gur pa lëvizur e ta takojë atë atdhetar, që kishte dhënë gjithë forcën e mendjes dhe energjitë e tij në ndihmë të vendit! E veshur si djalë pa marrë parasysh rreziqet arrin të futet në labirintet e burgut ku nga të gjitha anët dëgjoreshin rënkime, psherëtimat e mallkime; një ferr i vërtetë, do të shprehet Sevastia, më real se ai i Dantes! Pas një dere të vogël, në një vrimë të qelbur, nën një vazhdë drite që binte nga një frëngji, ajo mundi të shihte një figurë të mjerueshme pa mundur të dallonte në ishte një genie njerëzore. Mbi një rrasë guri, mbi një grumbull leckash rrinte kruspull Koto Hoxhi! Në sytë e saj nuk fshihej dilema, se si në atë trup të mjerë e të frikshëm mund të jetojë shpirti i Kotos udhëheqësit të madh shqiptar! Asnjë penë nuk mund të përshkruante gjendjen e mjerë në të cilën jetonte shpirti këtij martiri!

"Kam ardhur atë, – kumboi perëndishëm zëri i vashës, në atë birucë të thellë, të të them se fara që ti ke mbjellë po jep frytet e veta, se shpirti yt jeton në zemrën e popullit tënd". Vasha e ndjente thellë në shpirt se historia e tij do të ishte një frymëzim për të. Ajo kishte vendosur t'i kushtonte jetën ndriçimit e mëkëmbjes së motrave shqiptare. Do të ndiqte mësimet e Lidhjes Shqiptare, për të cilën Porta e Lartë kishte arritur ta përçante por jo ta mposhte. Sulltani i kishte premtuar Kotos faljen e jetës me kusht, që ai t'i jepte emrat e njerëzve që organizuan Lidhjen Shqiptare.

Koto, – i pat thënë Sulltani, a nuk e di se koka jote është në dorën time? Po, Madhëri ia kthen Kotoja, koka ime është në duart e Madhërisë suaj, shpirti i takon Perëndisë, mirëpo nderi është imi!

Politika "përça e sundo" e Sulltanit e kishte bërë punën e vet. I lumtur për sa kishte dëgjuar nga vasha, edhe Kotoja i jep bekimin. Arsimit është arma që vret tiraninë. Si një Zhan d'Arkë, Sevastia do të hidhej nga krahët e ëndrrës në frontin e realizimit të idealeve të larta që ushqenin shpirtin e saj. Duke menduar rreth veprës e fatit të këtij martiri, nën shembullin e Kotos, Sevastia do të marrë vendime të patundura. Ajo i kishte shembuj frymëzimi, simbolet e qëndresës historike, gjithçka tani ishte çështje nderi dhe e mbajtjes së fjalës së dhënë. Sevastia e njëjtte shpirtin e popullit të saj, dhe si bijë e tij nuk e zhgënjeu. Në faqet e librit të saj gjën copëza të mrekullueshme siç janë tregimet legjendat e babait të saj rreth zjarrit të vatrës familjare.





Republika e Maqedonisë Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Në bazë të nenit 19 të Ligjit për avokati të shtetit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/2007 dhe 104/2015), ndërsa në lidhje me Vendimin për përcaktimin e numrit të avokatëve shtetërorë në Avokatinë shtetërore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 3/2008), Qeveria e Republikës së Maqedonisë në mbledhjen e mbajtur më datë 25 korrik 2016, ka sjellë

VENDIM

Për publikim të Shpalljes për emërim të një avokatit të shtetit në Avokatinë e shtetit të Republikës së Maqedonisë për rajonet e Shkupit dhe Kumanovës

- 1. Shpallet emërimi i një avokatit të shtetit në Avokatinë e shtetit të Republikës së Maqedonisë për rajonet e Shkupit dhe Kumanovës.
2. Për avokat të shtetit në Avokatinë e shtetit të Republikës së Maqedonisë për rajonet e Shkupit dhe Kumanovës, mund të emërohet personi i cili ka plotësuar kushtet në vijim: të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, të jetë jurist i diplomuar me përvojë pune të çështje juridike së paku pesë vjet pas dhënies së provimit të jurispruencës dhe të gëzojë respekt gjatë kryerjes së funksionit
3. Kandidatët e interesuar, të cilët përmbushin kushtet e parapara në nenin 20 të Ligjit për avokati shtetërore, fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme në original ose kopje të vërtetuara në noter, ti dorëzojnë deri në arkivin e Qeverisë e Republikës së Maqedonisë ose përmes postës në adresën: Qeveria e Republikës së Maqedonisë, bul. "Ilinden" nr. 2, 1000 Shkup me shenjë: "Për shpallje për emërim të avokatit të shtetit në Avokatinë e shtetit të Republikës së Maqedonisë për rajonet e Shkupit dhe Kumanovës", në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit në "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" dhe në gazetën "Sloboden Peçat" dhe "Koha".
4. Ky vendim do të publikohet në "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" dhe në gazetën "Sloboden Peçat" dhe "Koha".

Numër 24 – 4139/125 korrik 2017 Shkup

KRYEMINISTËR I QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË Zoran Zaev

KOMUNA E ÇAIRIT ОПШТИНА ЧАИР KRYETARI I KOMUNËS Nr./... prej/

Kryetari i Komunës së Çairit, Shkup, gjatë shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga, Snezhana Taneva rr. "Brigada Maqedonase Kosovare 20" nr. 49, nga Shkupi, e dorëzuar me numër 08-2840 të datës 24.06.2011, në bazë të nenit 21, paragrafi (2), paragrafi (11) dhe paragrafi (12) të Ligjit për trajtimin e objekteve të ndërtaura në mënyrë të paligjshme ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 23/11, nr. 54/11, nr. 155/12, nr. 53/13, nr. 72/13, 44/14, 115/14, nr. 199/14, nr. 124/15, 129/15, 271/15 dhe 31/16) e në bazë të nenit 205, paragrafi 1 dhe neni 209, të Ligjit për procedurë të përgjithshme juridike ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 38/2005 110/08 dhe nr. 51/2011), e miraton këtë:

AKT VENDIM për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm

- 1. Përcaktohet statusi juridik i objektit të paligjshëm; shtëpi banimi, që gjendet, rr. "Brigada Maqedonase Kosovare 20" nr. 49, Shkup, PK 1575/3; KK Çair; e regjistruar në fletë pronësinë nr. 93976; objekt i cili është shënuar si: numri i objektit 1, Përdhese, hyrja 1, banesa 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: hapësirë banimi, sipërfaqja e brendshme 64 m². numri i objektit 1, Përdhese, hyrja 1, banesa 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: sipërfaqe ndihmëse, sipërfaqja e brendshme 15 m².
2. Si bartës i të drejtës të pronësisë së objektit nga pika 1 e dispozitivit të këtij aktvendimi, caktohet Snezhana Taneva rr. "Brigada Maqedonase Kosovare 20" nr. 49 nga Shkupi, me numër të letërnjoftimit A0615113.
3. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Elaborasi gjeodezik për përcaktimin e gjendjes faktike të objektit të paligjshëm nr. 10-749/1 të datës 23.05.2011 i përpiluar nga "DELA SISTEMI" SHPK - Shkup.
4. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi i njëjti paraqet bazë juridike për regjistrimin e të drejtës të pronësisë së objektit në librin publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive ndërsa gjatë regjistrimit shënohet se objekti ka fituar status juridik në pajtueshmëri me Ligjin për trajtimin e objekteve të ndërtaura në mënyrë të paligjshme.

Arsyetim

Kërkuesi Snezhana Taneva rr. "Brigada Maqedonase Kosovare 20" nr. 49, nga Shkupi, e dorëzuar me numër 08-2840 të datës 24.06.2011, për përcaktimin e statusit juridik të objektit paligjshëm: shtëpi banimi, që gjendet, rr. "Brigada Maqedonase Kosovare 20" nr. 49, Shkup, PK 1575/3; KK Çair; e regjistruar në fletë pronësinë nr. 93976; me gjithsej sipërfaqe të brendshme për legalizim 79m2.

Kërkuesi me kërkesën parashtroi:

- Fotokopje e letërnjoftimit
- Faturë nga shërbimet publike.
- Fletë pronësinë nr. 93976 të datës 02.05.2014.
- Akt noteri - Deklaratë- nr. PLA 9506/11 në Shkup me datë 21.09.2011.
- Akt noteri - Deklaratë- nr. PLA 51/2017 në Shkup me datë 09.01.2017.
- Vërtetim të pasqyrës historike të regjistrimeve të kryera për PK 1575/3; KK Çair me nr. 1107-1868/2016 të datës 08.02.2016.
- Elaborasi gjeodezik për përcaktimin e gjendjes faktike të objektit të paligjshëm nr. 10-749/1 të datës 23.05.2011 i përpiluar nga "DELA SISTEMI" SHPK-Shkup.

Toka në të cilën është ndërtuar objektit është në pronësi të Republikës së Maqedonisë dhe Çallakoviç Shehrije.

Gjatë procedurës janë sjellë këto:

- Procesverbal nga këqyrja në vend me nr. 08-2840/2 të datës 26.02.2013;
- Pëlqim urbanistik me nr. 08-2840 të datës 11.01.2017;
- Konkluzion për pagim të kompensimit nr. 08-2840 të datës 16.01.2017.
Në pajtim me dokumentacionin e planit urbanistik në fuqi sipas PGJU-së së qytetit të Shkupit 2012-2022, të në trullin e të lartpërmendurës PK 1575/3;KK Çair, është me dedikim A (banim).

Kryetari i Komunës së Çairit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të parashtruar, realizimin e këqyrjes në vend, këqyrjen në pajtueshmërinë urbanistike, konstaton se janë përmbushur kushtet për miratimin e aktvendimit për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm.

Në bazë të asaj që u theksua më lart, u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

UDHËZIM PËR KËSHILLË JURIDIKE: Kundër Aktvendimit të Kryetarit të Komunës së Çairit për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm dhe për refuzimin e kërkesës për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm, mund të dorëzohet ankesë në afat prej 15 dite nga dita e pranimit ë aktvendimit, deri te organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga lëmi i rregullimit të hapësirës.

Ankesa taksohet në vlerë prej 250,00 denarë taksë administrative.

- Dorëzuar deri te: - Kërkuesi - Arkivi

Përploli / - A.S. Miralot / - R.Q. Përkleth / - L.R.

Kyetar Izet Mexhiti

KOMUNA E ÇAIRIT ОПШТИНА ЧАИР KRYETARI I KOMUNËS Nr./... prej/

Kryetari i Komunës së Çairit, Shkup, gjatë shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga, Muzafer Metallari rr. "Brigada Maqedonase Kosovare " nr. 1/1B, nga Shkupi, e dorëzuar me numër 08-4902 të datës 09.08.2011, në bazë të nenit 21, paragrafi (2), paragrafi (11) dhe paragrafi (12) të Ligjit për trajtimin e objekteve të ndërtaura në mënyrë të paligjshme ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 23/11, nr. 54/11, nr. 155/12, nr. 53/13, nr. 72/13, 44/14, 115/14, nr. 199/14, nr. 124/15, 129/15, 271/15 dhe 31/16) e në bazë të nenit 205, paragrafi 1 dhe neni 209, të Ligjit për procedurë të përgjithshme juridike ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 38/2005 110/08 dhe nr.51/2011), e miraton këtë:

AKT VENDIM për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm

- 1.Përcaktohet statusi juridik i objektit të paligjshëm; shtëpi banimi, që gjendet, rr. "Brigada Maqedonase Kosovare" nr. 1/1B, Shkup, PK 2044; KK Çair; e regjistruar në fletë pronësinë nr. 15102; objekt i cili është shënuar si: numri i objektit 1, Përdhese, hyrja 1, banesa 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: banim, sipërfaqja e brendshme 86 m². numri i objektit 1, Përdhese, hyrja 1, banesa 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: sipërfaqe ndihmëse, sipërfaqja e brendshme 9 m². numri i objektit 1, Përdhese, hyrja 2, banesa 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: korridore dhe shkallë, sipërfaqja e brendshme 4 m². numri i objektit 1, Kati 1, hyrja 2, banesa 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: banim, sipërfaqja e brendshme 110 m². numri i objektit 1, Nënkulim, hyrja 2, banesa 2, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: banim, sipërfaqja e brendshme 66 m². numri i objektit 1, Nënkulim, hyrja 2, banesa 2, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: sipërfaqe ndihmëse, sipërfaqja e brendshme 48 m². numri i objektit 1, Bodrum, hyrja 3, banesa 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: garazhë, sipërfaqja e brendshme 94 m².
2. Si bartës i të drejtës të pronësisë së objektit nga pika 1 e dispozitivit të këtij aktvendimi, caktohet: Muzafer Metallari rr. "Brigada Maqedonase Kosovare " nr. 1/1B, nga Shkupi, me numër të pasaportës H0026335.
3. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Elaborasi gjeodezik për përcaktimin e gjendjes faktike të objektit të paligjshëm nr. 327/110-12 të datës 02.04.2012 i përpiluar nga "GEO PROFIL" SHPKNPJ - Shkup, me fletë pronësinë nr. 15102 nga data 23.03.2012.
4. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi i njëjti paraqet bazë juridike për regjistrimin e të drejtës të pronësisë së objektit në librin publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive ndërsa gjatë regjistrimit shënohet se objekti ka fituar status juridik në pajtueshmëri me Ligjin për trajtimin e objekteve të ndërtaura në mënyrë të paligjshme.

Arsyetim

Kërkuesi Muzafer Metallari rr. "Brigada Maqedonase Kosovare " nr. 1/1B, nga Shkupi, dorëzoi kërkesë me numër 08-4902 të datës 09.08.2011, për përcaktimin e statusit juridik të objektit paligjshëm:

shtëpi banimi,

që gjendet, rr. "Brigada Maqedonase Kosovare " nr. 1/1B, nga Shkupi, PK 2044; KK Çair; e regjistruar në fletë pronësinë nr. 15102, me gjithsej sipërfaqe të brendshme për legalizim 417 m2.

Kërkuesi me kërkesën parashtroi:

- Fotokopje e letërnjoftimit
- Faturë nga shërbimet publike.
- Akt noteri - Deklaratë- nr. PLA 8543/11 në Shkup me datë 19.07.2011.
- Akt noteri - Deklaratë- nr. RPA 91/17 në Shkup me datë 28.02.2017.
- Vërtetim të pasqyrës historike të regjistrimeve të kryera për PK 2044; KK Çair me nr. 1107-13612/2016 të datës 17.01.2017.
- Elaborasi gjeodezik për përcaktimin e gjendjes faktike të objektit të paligjshëm nr. 327/110-12 të datës 02.04.2012 i përpiluar nga "GEO PROFIL" SHPKNPJ-Shkup, me fletë pronësinë nr. 15102 nga data 23.03.2012.

Toka në të cilën është ndërtuar objektit është në pronësi të Nada Arsovska, Aleksandar Stojanovski ,Andrea Stojanovski dhe Republikës së Maqedonisë.

Gjatë procedurës janë sjellë këto:

- Procesverbal nga këqyrja në vend me nr. 08-4902 të datës 09.08.2011;
- Pëlqim urbanistik me nr. 08-4902 të datës 29.06.2017;
- Konkluzion për pagim të kompensimit nr. 08-4902 të datës 06.07.2017.

Dedikimi i objektit të paligjshëm është shtëpi banimi ndërsa sipas dokumentacionit të planit urbanistik në fuqi, PK 2044; KK Çair, në të cilën është ndërtuar objekti është paraparë për infrastrukturë rrugore.

VËREJTJE: Në pajtim me nenin 7 nga ndryshim plotësimi i Ligjit për trajtimin e objekteve të ndërtaura në mënyrë të paligjshme ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 129/15) dispozita nga neni 23 paragrafi (1) nga Ligji për trajtimin e objekteve të ndërtaura në mënyrë të paligjshme ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 23/11, nr. 54/11, nr. 155/12, nr. 53/13, nr. 72/13, 44/14, 115/14, nr.199/14, nr. 124/15, 129/15 dhe 271/15), NUK zbatohet për objektet e paligjshme të ndërtaura në trull në të cilin në pajtim me dokumentacionin e planit urbanistik në fuqi është paraparë ndërtim i infrastrukturës rrugore.

Kryetari i Komunës së Çairit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të parashtruar, realizimin e këqyrjes në vend, këqyrjen në pajtueshmërinë urbanistike, konstaton se janë përmbushur kushtet për miratimin e aktvendimit për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm.

Në bazë të asaj që u theksua më lart, u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

UDHËZIM PËR KËSHILLË JURIDIKE: Kundër Aktvendimit të Kryetarit të Komunës së Çairit për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm dhe për refuzimin e kërkesës për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm, mund të dorëzohet ankesë në afat prej 15 dite nga dita e pranimit ë aktvendimit, deri te organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga lëmi i rregullimit të hapësirës.

Ankesa taksohet me taksë administrative në shumë prej 250,00 denarë .

- Dorëzuar deri te: - Kërkuesi - Arkivi

Përploli / - A.S. Miralot / - R.Q. Përkleth / - L.R.

Kyetar Izet Mexhiti

KOMUNA E ÇAIRIT ОПШТИНА ЧАИР KRYETARI I KOMUNËS Nr./... prej/

Kryetari i Komunës së Çairit, Shkup, gjatë shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga, Ademi Qamuran rr. "Rifat Burxheviç" nr. 105, nga Shkupi, e dorëzuar me numër 08-8031 të datës 10.03.2017, kurse në lidhje me kërkesën nr.8031 nga data 29.08.2011, në bazë të nenit 21 paragrafi (2), paragrafi (11) dhe paragrafi (12), të Ligjit për trajtimin e objekteve të ndërtaura në mënyrë të paligjshme ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 23/11, nr. 54/11, nr. 155/12, nr. 53/13, nr. 72/13, 44/14, 115/14, nr.199/14, nr. 124/15, 129/15, 271/15 dhe 31/16) e në bazë të nenit 205, paragrafi 1 dhe neni 209, të Ligjit për procedurë të përgjithshme juridike ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 38/2015,110/08 dhe nr.51/2011), e miraton këtë:

AKT VENDIM për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm

- 1.Përcaktohet statusi juridik i objektit të paligjshëm; shtëpi banimi, që gjendet, rr. "Sllavej Pllanina" nr. 107, Shkup, PK 3988/1, KK Qendër 1; e regjistruar në fletë pronësinë nr. 98918 dhe PK 3988/2, KK Qendër 1, e regjistruar në fletë pronësinë nr. 48558, objekt i cili është shënuar si: numri i objektit 1, Përdhese, hyrja 1, banesa 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: hapësirë banimi sipërfaqja e brendshme 36 m².
1.b Përcaktohet statusi juridik i objektit të paligjshëm; shtëpi banimi, që gjendet, rr. "Sllavej Pllanina" nr. 107, Shkup, PK 3988/2, KK Qendër 1; e regjistruar në fletë pronësinë nr. 48558, objekt i cili është shënuar si: numri i objektit 2, Përdhese, hyrja 1, banesa 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: hapësirë banimi, sipërfaqja e brendshme 14 m².
2. Si bartës i të drejtës të pronësisë së objekti nga pika 1 e dispozitivit të këtij aktvendimi, caktohet, Ademi Qamuran rr. "Rifat Burxheviç" nr. 105, nga Shkupi, me numër të letër njoftimi A0218485.
3. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Elaborasi gjeodezik për përcaktimin e gjendjes faktike të objektit të paligjshëm nr. 7-299-3/17 të datës 09.03.2017 i përpiluar nga "GEO URBAN" -Shkup.
4. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi i njëjti paraqet bazë juridike për regjistrimin e të drejtës të pronësisë së objektit në librin publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive ndërsa gjatë regjistrimit shënohet se objekti ka fituar status juridik në pajtueshmëri me Ligjin për trajtimin e objekteve të ndërtaura në mënyrë të paligjshme.

Arsyetim

Kërkuesi Ademi Qamuran rr. "Sllavej Pllanina" nr. 107, nga Shkupi, e dorëzuar me numër 08-8031 të datës 10.03.2017, kurse në lidhje me kërkesën nr. 8031 nga data 29.08.2011, për përcaktimin e statusit juridik të objektit paligjshëm: 1.a shtëpi banimi, që gjendet, rr. "Sllavej Pllanina" nr. 107, Shkup, PK 3988/1, KK Qendër 1 dhe PK 3988/2 KK Qendër 1. 1.b shtëpi banimi, që gjendet, rr. "Sllavej Pllanina" nr. 107, Shkup, PK 3988/2, KK Qendër 1.

Kërkuesi me kërkesën parashtroi:

- Fotokopje e letërnjoftimit
- Akt noteri - Deklaratë- nr. PLA 1060/2017 në Shkup me datë 25.04.2017.
- Vërtetim për pasqyrën historike të regjistrimeve të bëra për PK 3988/2 KK Qendër 1.
- Elaborasi gjeodezik për përcaktimin e gjendjes faktike të objektit të paligjshëm nr. 7-299-3/17 të datës 09.03.2017 i përpiluar nga "GEO URBAN" -Shkup.

Toka në të cilën është ndërtuar objektit është në pronësi të RM-së, Bitiqi Gafur, Memedi Fatmir, Boshkovski Aleksandar, Boshkovski Bogolub, Duraki Ali dhe Fazliu Lavdim.

Në pajtim me dokumentacionin e planit urbanistik në fuqi sipas PDU-së Kuarti i Qytetit SSI 05, bloku SSI 05.04, në trullin e të lartpërmendurës PK 3988/1 dhe PK 3988/2, KK Qendër 1, është parashikuar ndërtim i infrastrukturës rrugore.

VËREJTJE: Në pajtueshmëri me nenin 7 nga ndryshim plotësimi i Ligjit për trajtim me objektet e ndërtaura në mënyrë të paligjshme ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 129/15) dispozita nga neni 23 paragrafi (1) të Ligjit për trajtim me objektet e ndërtaura në mënyrë të paligjshme ("Gazeta zyrtare e RM" nr.23/11, nr.54/11, nr. 155/12, nr. 53/13, nr. 72/13, nr. 44/14, nr. 115/14, nr. 199/14, nr.124/15, 129/15 dhe 271/15), NUK zbatohet për objekte të ndërtaura në mënyrë të paligjshme në trullin në të cilin në pajtueshmëri me dokumentacionin e planit urbanistik në fuqi është paraparë ndërtim i infrastrukturës rrugore.

Gjatë procedurës janë sjellë këto: - Procesverbal nga këqyrja në vend me nr. 08-8031 të datës 26.04.2017; - Pëlqim urbanistik me nr. 08-8031 të datës 04.05.2017; - Konkluzion për pagim të kompensimit nr. 08-8031 të datës 08.05.2017.

Kryetari i Komunës së Çairit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të parashtruar, realizimin e këqyrjes në vend, këqyrjen në pajtueshmërinë urbanistike, konstaton se janë përmbushur kushtet për miratimin e aktvendimit për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm.

Në bazë të asaj që u theksua më lart, u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

UDHËZIM PËR KËSHILLË JURIDIKE: Kundër Aktvendimit të Kryetarit të Komunës së Çairit për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm dhe për refuzimin e kërkesës për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm, mund të dorëzohet ankesë në afat prej 15 dite nga dita e pranimit ë aktvendimit, deri te organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga lëmi i rregullimit të hapësirës.

Ankesa taksohet me taksë administrative në shumë prej 250,00 denarëve.

- Dorëzuar deri te: - Kërkuesi - Arkivi

Përploli / - A.S. Miralot / - R.Q. Përkleth / - L.R.

Kyetar Izet Mexhiti





Histori qytetesh

# Vlora dhe vlonjatët e shekullit XVII

Në limanin e Vlorës e deri në Sazan gjuhet peshk i çdo lloji. Ka me shumicë qefull e levrek. Përdoret gjithashtu vaji i peshkut. Pija e rehanisë, limoni, portokalli, ulliri, fiku e rusi bëhen me shumicë. Në krahinën e Dukatit ka mjaft rrënjë të bojës së kuqe dhe ravend, që mblidhet e përdoret nga mjekësia në Francë. Zifti i kulluar i Vlorës është i pakrahasueshëm

Arlinda CANAJ

Në librin e tij "Shqipëria para tre shekujsh" udhë-tari i njohur turk, Evlija Çelebi, përshkruan përshypjetet e tij nga udhëtimet nëpër Shqipëri. Ai studioi historinë e vendit, gjeografinë, ekonominë, bujqësinë, tregtinë, industrinë, kulturën, arkitekturën, racën, gjuhën, legjendat e përrallat shqiptare. Vepra e tij ka një rëndësi të veçantë për Shqipërinë dhe mbi shënimet e tij janë bazuar shumë historianë të njohur shqiptarë që kanë vlerësuar shumë shënimet e tij.

Kjo vepër ka hasur në kundërshtimin e shumë historianëve të komunizmit, të cilët nuk donin që kjo vepër e përkthyer në shqip në vitin 1930 të ribotohej në vitet e komunizmit. Përkthyesi i këtij libri, patrioti Sali Vuçiterni është quajtur armik i popullit. Çfarë të dhënash të rëndësishme jep ai për qytetin e bukur të Vlorës.

Qyteti i Vlorës ndodhet mbi një fushë të lulëzuar me vreshta, trëndafilë, limonë, portokalle, ullinj, shëgë e fiq. Qyteti ka një mijë shtëpi në dy kate, qargjir e të mbuluara me tjegulla. Qyteti i Vlorës ka disa lagje, ndër të cilat janë lagja e xhamisë së Hynqarit, ajo e Tabakëve, e Hysen Agajt, e Mehmeqes, lagja e Tregut etj. Gjithsej ka 50 faltore, ku më me emër janë xhamia e Sulltan Sulejmanit, një xhami që bie në sy, me një kube guri të mbuluar me plumb me një minare të shembur.

Mbi portën e saj nga kibleja ka këtë mbishkrim



(Ndërtoi xhaminë në udhë të Zotit në vend të shtëpisë

Më pas Sulltan Sulejmani me famë

Zoti ia bëftë kabull, fali xhumanë.

Edhe tha këtë tempull me e datue

Drita e Zotit kësaj xhamie I ka mjaftue)

Nga deshifrimi i mbishkrimit, sipas metodës Ebxhed, xhamia është ndërtuar në vitin 949 të Hixhrit.

Qyteti i Vlorës ka tri medrese, pesë shkolla fillore e tri teqe:teqeja halvetike e Jakup Efendiut me qindra dervish avdallë, ajo e Kuzgun Babait brenda në ullishtë, etj.

Institutet e tjera të Vlorës janë një banjë e vogël, një ndërtesë e gjyqit të Sheriatit, e ngritur nga Muhamed Efendi Persiani, kur ishte Kadi, 117 dyqane me anën e të cilave sigurohet tregtia dhe artizanati i vendit, Bezisten nuk ka, pasi bën tregti me Venedikun.

Qyteti ka katër hane e tetë kroje, ndër të cilët më me emër është kroi i Iljaz Pashës afër teqesë së Jakup Efendiut...Krojet e tjera nuk kanë ujë, pasi kanalet e tyre janë prishur. Populli vuan nga mungesa e ujit dhe është i detyruar të shkojë e të mbushë ujë deri në ullishtë. Me pak shpenzime, një bamirës

mund të kënaqë shpirtrat e dëshmorëve të Qerbelasë. Çdo gjë tjetër, përveç ujit, është me bollëk, mbi të gjitha pemët, që kanë mbuluar gjithçka.

Në limanin e Vlorës e deri në Sazan gjuhet peshk i çdo lloji. Ka me shumicë qefull e levrek. Përdoret gjithashtu vaji i peshkut. Pija e rehanisë, limoni, portokalli, ulliri, fiku e rusi bëhen me shumicë. Në krahinën e Dukatit ka mjaft rrënjë të bojës së kuqe dhe ravend, që mblidhet e përdoret nga mjekësia në Francë. Zifti i kulluar i Vlorës është i pakrahasueshëm. Nëse në një gotë hidhet pak zift i ndaluar, tundet e trazohet

dhe pihet uji pasi të hiqet shtresa e ziftit, me të mund të shërohen shumë sëmundje.

Në shkëmbin e Kaninës dalin gurë mulliri shumë të mirë, me pore si sfungjeri të cilat eksportohen deri në Francë. Ndërsa në ullishtet e Vlorës ka allçi, hekur e shumë metale të tjera. Vlora është qendër e këtyre metaleve.

Në bregdet ka shumë dajlane. Vlora është aq e begatë, sa mund të thuhet se ajo është një Egjipt i dytë. Mjalti i Vlorës, i cili ka një erë shumë të këndshme, nuk gjendet as në Gjirit. Mjafton vetëm një filxhan mjaltë që të përzihet me njëzet filxhan ujë

dhe bëhet një shërbet i shijshëm ose një paluze. Ndërmjet fortesës së Vlorës dhe asaj të Jengjecit, ndodhet limani i Vlorës, i cili është i madh sa mund të mbajë 1 mijë anije.

Thuhet se Sulltan Sulejmani e ndërtoi fortesën e Vlorës për të mbrojtur flotën e Vlorës që qëndronte në këtë liman. Anijet e mëdha nuk mund të afrohen në breg, por hedhin spirancat gjysëm milje larg. Ndërmjet Vlorës dhe detit ndodhet katundi i Zvërnecit.

Të dhënat më të bukura që jep Çelepiu i përkasin Sazanit

Ja ç'thotë ai:

Çdo vit, në limanin e këtij ishulli struket e dimëron flota veneciane. Ajo ka qendrën në ishull dhe çdo udhëtim e fillon prej këndej. Në jug të Sazanit e në perëndim të Vlorës ndodhet gadishulli i Karaburunit.

Ndërmjet perëndimit e jugut ndodhet krahina shqiptare e Dukatit, me 100 katunde të pashtuar e të pabindur. Banorët e kësaj krahine janë kokëzinj e me shapka, por të vrasin nëse i quan të krishterë, megjithëse kanë ndihmuar të krishterët e Gjirit. Janë ndër burrat më trima të kombit shqiptar. Por dhe populli vlonjat nuk mbetet pas tyre për trimëri. Vlonjatët kanë dhjetë anije lufte të vetat, me të cilat i dalin zot Vlorës dhe e mbrojnë nga frëngjit. Gjysma e forcave të fortesës u nis për në luftën e Manies me këto anije.

Vlora ka ajër të mirë, por ujë të keq, ujë pusi. Banorët si meshkuj dhe femra janë të pashëm. Trimat e rinj janë rebelë e foddullë, vishen me rroba të shkurtra e të ngushta si të Algerisë. Në shpinë veshin ihram të bardhë. Për hir të zotit duhet të thuhet se janë luftëtarë të rreptë. Shumica e tyre i lidhin kryet me çallmë dhe rrinë me kraharorin zbuluar, që u piqet e rregjet prej rrezeve të diellit. Shkurt, vlonjati është një gazi kalender dhe mik i Ehli Bejtit të Resultit, flet e këndon persisht, dhe herë ulet e ngrihet, thërrret : "Ja Muhamet, ja Ali". Vlonjatët kanë shëndet të plotë e u shkëlqen lëkura nga ngjyra e kuqe. Perëndia qoftë razi nga të gjithë.







Deri më sot, Rusia ka nisur 21 raketa në Mars, duke përfshirë edhe "landers" pa pilot, por vetëm dy që vinin në orbitë, i përfunduan misionet e tyre

**Na ka magjepsur për shekuj, duke frymëzuar astronomë, shkrimtarë të fantashkencës dhe më shumë se disa sipërmarrës me sytë nga yjet, të cilët kanë plane për të nisur misione në Mars. Por a do të vëmë me të vërtetë ndonjëherë këmbë, në planetin e kuq?**

Marsi na thërret. Bota më e afërt, e ngjashme me Tokën, shndërrin me një shkëlqim të kuqërremtë të dritës së diellit që reflektohet në qiellin e natës, duke i bërë thirrje kuriozitetit dhe shpirtit tonë të aventurës. Ai ka një atmosferë dhe, në mesditë në një ditë vere, temperatura mund të arrijë në 25 C. Një ditë zgjat rreth 24 orë, si në Tokë. Por aty përfundon ngjashmëria. Ajo atmosferë është 95 për qind dioksid karboni i pathithshëm, në më pak se një për qind të presionit atmosferik të Tokës, kështu që ka pak izolim dhe netët e dimrit mund të jenë deri -140 C. Marsi është një e dhjeta e masës së Tokës, kështu që graviteti ka vetëm një të tretën e tërheqjes që përjetojmë ne. Dhe një vit zgjat 687 ditë.

#### Kufiri i ardhshëm

Pas misioneve Apollo në Hënë në vitet 1970, dërgimi i astronautëve në Mars dukej hapi i ardhshëm logjik, por do të ishte një "kërcim gjigant", politikisht dhe financiarisht. Hapësira është e madhe: ndërkohë që astronautëve të misioneve Apollo iu deshën vetëm katër ditë për të arritur në Hënë, me teknologjinë e sotme, do të duheshin rreth nëntë muaj për të arritur në Mars. Dhe deri në kohën kur planetët do të renditeshin në mënyrë të favorshme për rikthimin, një mision i plotë mund të zgjasë dy ose tre vjet. Përgjatë kësaj kohe, astronautët do të kishin nevojë për ushqime, ujë dhe oksigjen, plus mbrojtje nga rrezatimi.

Në këtë pikë, shkalla e suksesit për misione me robotë nuk frymëzon besim. Deri më sot, Rusia ka nisur 21 raketa në Mars, duke përfshirë edhe "landers" pa pilot, por vetëm dy që vinin në orbitë, i përfunduan misionet e tyre. SHBA ka qenë më e suksesshme, duke humbur vetëm pesë nga 23 misione. Por ende nuk ka një mision me kthim. Është e qartë se nevojitet më shumë punë, para se të mund të mendojmë për dërgimin e njerëzve në Mars. Por, herët a vonë, do të shkojmë. Me vullnet politik, mund të ndodhë brenda 20 viteve. Dhe një gjë që mund të bëhet në ndërkohë, është testimi i elasticitetit psikologjik njerëzor, për një mision të tillë. Mbjatësi i tanishëm i rekordit për qëndrimin më të gjatë në hapësirë, është



# JETË NË MARS



Planet e NASA-s janë më të matura. Ato përfshijnë lëvizjen e misioneve njerëzore me kohë të gjatë nga ISS për të ardhur në orbitë përreth Hënës gjatë 13 viteve të ardhshme, duke vazhduar eksplorimin shkencor të Marsit; pasuar me dërgimin e ngarkesave dhe një mision pa pilot me kthim, në fund të viteve 2020. Por, thonë ata, nuk do të jetë para fillimit të viteve 2030, që njerëzit vijnë në orbitë përreth Marsit, e jo më të zbrisin në planet. Ndërkohë, Elon Musk, ish sipërmarrës i PayPal dhe themelues i SpaceX, ka planet e tij.

astronauti rus Valeri Polyakov, i cili u kthye në Tokë nga stacioni Mir, në mars 1995, pas 437 ditësh në hapësirë. Një gjë e tillë teston aftësinë e trupit të njeriut për t'i bërë ballë humbjes së muskujve dhe kockave, që shkaktohen nga graviteti zero, dhe është një provë psikologjike vullneti dhe durimi. Dhe ndërsa kontakti me astronautët në Stacionin Ndërkombëtar të Hapësirës (ISS) është i thjeshtë, pasi duhet vetëm një pjesë e sekondës për të transmetuar mesazhe nga Toka, sinjalet e radios kërkojnë 20 minuta për të mbërritur në Mars, kështu që astronautët do të ndjehen shumë më të izoluar, gjë që i shtohet stresit psikologjik të të qenit të kufizuar me vetëm një ekip të vogël.

Këto kushte testimi janë simuluar në Tokë në mënyrë që të vlerësohet efekti i tyre tek njerëzit. Mars 500 ishte një projekt rus / evropian / kinez midis viteve 2007 dhe 2011, në një objekt të izoluar në një park makinash në Moskë. Ai arriti kulmin me një qëndrim prej 520 ditësh, nga gjashtë vullnetarë meshkuj. Ata pretendonin se ishin mirë me shëndet gjatë gjithë testimit, por

disa i shmangeshin ushtrimit dhe fshiheshin nga kolegët e tyre, ndërsa katër kishin vështirësi me gjumin.

Simulimi i fundit - Hawaii Space Exploration Analog dhe Simulation, i kryer për NASA-n nga Universiteti i Hawaiiit - ndodhi në peizazhin e ngjashëm me Marsin në Hauai, 2.500 lart, në anën e vullkanit Mauna Loa. Një ekip prej gjashtë vetësh, doli nga një vit në izolim atje më 28 gusht 2016. Ata ishte lejuar të dilnin në shëtitje të simuluar si në Mars, por vetëm të veshur me një kostum të plotë hapësire. Pjesën tjetër të kohës, ata jetonin në kushte të ngjeshura në një kupolë gjeodezike 100 metra katrorë. Agjencia Evropiane e Hapësirës gjithashtu bën vlerësime të rregullta të ekuipazhit në stacionin e largët Concordia në Antarktidë, për të vlerësuar efektet e izolimit gjatë dimrit të gjatë dhe të errët polar. Dhe ka simulime të

tjera të realizuara nga Mars Association në shkretëtirën e Utah dhe në Arktikun kanadez.

Presidenti i Mars Association, Robert Zubrin, ka një plan për misionin që, ai beson se do të jetë më i sigurt dhe më i lirë se çdo mision tjetër. Ai përfshin lëshimin fillimisht të një "Mjeti me Rikthim në Tokë" (ERV), që do të zbriste në Mars dhe do të përdorte energjinë diellore ose bërthamore, si dhe hidrogjenin e importuar, për të prodhuar metan dhe oksigjen nga CO2 Marsian. Me fjalë të tjera, karburant raketash. Kjo do të thotë që njerëzit do të vendosnin të niseshin, vetëm nëse do të dinin se do të kishte një automjet për t'u kthyer, i mbushur me karburant, në sipërfaqen e Marsit. Mjeti me të cilin do të niseshin, thotë ai, do të qëndronte në Mars për të siguruar udhëtimin e ardhshëm. Një ERV e dytë do të nisej në të njëjtën kohë për të siguruar mbështetje dhe,

nëse gjithçka shkon mirë, do të ishte gati për të sjellë ekipin e ardhshëm në shtëpi, dy vjet më vonë. Në këtë mënyrë, një seri udhëtimesh me kthim do të ndërtonin një numër hapësirash jetese në Mars, për qëndrime më të gjata në të ardhmen. Dhe për shkak se shumica e karburantit për udhëtimin e kthimit do të krijohej në Mars, Zubrin beson se mund të prodhohet energji e madhe dhe të ketë kurtime të mëdha të kostove.

Planet e NASA-s janë më të matura. Ato përfshijnë lëvizjen e misioneve njerëzore me kohë të gjatë nga ISS për të ardhur në orbitë përreth Hënës gjatë 13 viteve të ardhshme, duke vazhduar eksplorimin shkencor të Marsit; pasuar me dërgimin e ngarkesave dhe një mision pa pilot me kthim, në fund të viteve 2020. Por, thonë ata, nuk do të jetë para fillimit të viteve 2030, që njerëzit vijnë në orbitë përreth Marsit, e jo më të zbrisin në planet. Ndërkohë, Elon Musk, ish sipërmarrës i PayPal dhe themelues i SpaceX, ka planet e tij. Ai tashmë ka një kontratë me NASA-n për furnizimin e ISS dhe shpreson të jetë në gjendje të dërgojë mallra në Mars në vitin 2018, në

përgatitje për një mision njerëzor në vitet 2020. "Marsi është diçka që mund ta arrijmë në jetën tonë", thotë ai.

#### Jashtëtokësorë

Koncepti SpaceX është zhvilluar në disa detaje. Raketa aktuale Falcon 9 dhe kapsula e Dragonit tashmë janë duke fluturuar që tani, pasi dërgojnë mjete në stacionin hapësiror, dhe të dy pjesët kthehen në Tokë për ripërdorim. Por Sistemi i Transportit Ndërplanetar (ITS) është shumë më ambicioz. Ndërsa Falcon 9 përdor nëntë motorë me raketa Merlin, ITS do të përdorë 42 motorë Raptor - të njëjtën madhësi, por pothuajse tre herë më shumë. Motorët e shumëfishtë do të bëjnë që, edhe nëse disa prej tyre dështojnë, misioni mund të vazhdojë. Prova e parë e një motori Raptor shkoi mirë në shtator 2016.

Raketa e nisjes do të ishte më e fuqishme e ndërtuar ndonjëherë - më e gjatë se Saturn V i misioneve Apollo dhe shumë më e aftë. Mund të nisë 300 ton ngarkesë në orbitë dhe të kthehet në tokë vertikalisht në bllokun e nisjes, e gatshme për ripërdorim me mirëmbajtje minimale. Ashtu si me planin e Mars Association, është ekonomik sepse dërgon pjesën e jashtme në orbitë dhe prodhon vetë karburant për udhëtimin e kthimit nga Marsi. Por Musk dëshiron të shkojë përtej dërgimit të ngarkesave; ai ka vizionet e një kolonie të Marsit dhe një flotë prej qindra raketash të tilla në shekullin e ardhshëm. Ai thotë se dëshiron të "krijojë një qytetërim të pavarur, jo një avanpost, me qëllim që njerëzit mund të bëhen një specie shumë-planetare". Orbitat e Marsit dhe Tokës reshtohen për një mision efektiv çdo 26 muaj dhe Musk shpreson t'i përdorë ato që tani, duke filluar me testet pa pilot në vitin 2018 dhe duke dërguar njerëzit e parë në Mars në vitin 2026. Financimi mund të vijë nga qeveritë, ndërmarrjet dhe madje edhe përmes financimit të vetë njerëzve.

Pastaj, shumë larg, në të ardhmen, pasi të ekzistojnë bazat e para, e më pas kolonitë, në Mars, do të vijë sfida e formimit të terrenit - të bëhet Marsi si Toka. Kjo mund të përfshijë rritjen e presionit atmosferik duke shkrirë dioksid karbonin polar me energjinë bërthamore ose reflektorët diellorë, dhe duke shtuar kometa e asteroide të importuara. Kjo do të rriste temperaturat dhe do të lejonte kthimin e ujit të lëngshëm. Por do të kishte nevojë për mbrojtjen e një fushe magnetike artificiale. Algat ose cianobakteret mund të fillojnë prodhimin e oksigjenit për ta bërë atmosferën të frymëmarrshme. Tingëllon si material fantashkence, është e vërtetë, por kemi parë që shpesh herë bëhet realitet. (bota.al)





## Ilaçet natyrale që i keni në shtëpi



Doni të kujdeseni shëndetshëm për lëkurën tuaj? Çelësi ndodhet në kuzhinën tuaj. Më poshtë ju sugjerojmë disa produkte natyrale që funksionojnë shumë më mirë se çdo produkt kozmetik.

**VAJI I ULLIRIT:** Spruconi pak vaj ulliri në dorën tuaj dhe aplikojeni në zonat e thata të lëkurës.

**VAJI I KOKOSIT DHE SHEQERI:** Përzieri me kujdes një lugë me vaj kokosi me një lugë sheqer. Kujdes! Sheqeri nuk duhet të shkrihet tërësisht. Mund ta aplikoni në fytyrë nëse e keni atë me puçra, por jo vetëm.

**VAJI I KOKOSIT, MJALTI DHE KAFEJA E BLUAR:** Ndrohni me temperaturë jo të lartë një filxhan të vogël me vaj kokosi. Brenda tij hidhni edhe një lugë me mjaltë dhe gjysmë filxhani me kafe të bluar. Pasi masa e përfutur të ftohet aplikojeni në pjesën e trupit që dëshironi.

Kjo që sapo lexuat vlen për të gjithë ato persona që duan të kenë një lëkurë të pastër dhe të lëmuar, jo vetëm për personat që kanë probleme me të...



## Si të zbardhni dhëmbët

Të gjithë duam të kemi një buzëqeshje të bukur dhe të këndshme pavarësisht se jo të gjithë kujdesemi ashtu siç duhet për ta pasur atë. Vizitat tek dentisti si dhe larja e shpeshtë e dhëmbëve sigurojnë që kanë rëndësinë e tyre, por gjithashtu ju duhet të dini se zbardhja e dhëmbëve mund të arrihet edhe me metoda të tjera. Konkretisht me përdorimin e lëkurës së portokallit ju do të arrini të keni dhëmbë me bardhësi perfekte.

Siç edhe ju mund ta dini, portokalli përmban vitaminë C. Për të zbardhur dhëmbët ju duhet vetëm lëkura e këtij fruti. Me pjesën e brendshme të lëkurës, e cila është e bardhë, fërkojini dhëmbët mirë për disa minuta me radhë. Rezultatet do jenë të shkëlqyera...



# PESE VITAMINAT KRYESORE

Nuk ka asnjë trajtim më efikas për lëkurën sesa ato që e ushqejnë këtë të fundit nga brenda jashtë! Ne jemi çfarë hamë, është mese e vërtetë, e kjo gjë reflektohet në fytyrën tonë!

Ushqimi që hani nuk duhet të jetë vetëm burim energjie, por duhet të sigurojë të gjitha vlerat ushqyese, mineralet e vitaminat. Ndonëse këto të fundit gjenden dhe në trajtë kapsulash, efekti është më i madh kur ato merren përmes dietës ushqimore.

### Vitamina C

Shumica e njerëzve mendojnë se vitamina C është vetëm për forcimin e sistemit imunitar, por ajo që nuk dini

është se kjo vitaminë nevojitet edhe për prodhimin e kolagenit dhe mbron lëkurën nga rrezet e dëmshme ultraviole.

### Vitamina A

Kjo vitaminë ndihmon në parandalimin e puçrrave e shenjave kafe të fytyrës. Kjo vitaminë përshejton qarkullimin e gjakut, duke hidratuar në nivel qelizor lëkurën ashtu si dhe minimizon prodhimin e yndyrës.

### Vitamina E

Kjo është vitamina që mbron qelizat e lëkurës nga dëmtimet, cilado qofshin ato (nga toksinat, rrezet, etj). Kombinoheni këtë vitaminë me C-në dhe shtresa mbrojtëse e qelizave do të jetë maksimale.

### Vitamina B2

Ju gjithashtu duhet të përfshini vitaminën B2 në dietën tuaj, veçanërisht nëse vuani nga lëkura e thatë dhe e

acaruar.

Kjo vitaminë e mban lëkurën të butë, të hidratuar dhe ndihmon frymëmarrjen qelizore. Ushqimet që përmbajnë vitaminë B2 përfshijnë vezë, brokoli, kërpudha, fasule, sojë, kos etj.

### Omega-3

Acidet yndyrore Omega-3 ndihmojnë në mbrojtjen e membranës qelizore, sidomos kur jeni te ekspozuar ndaj rrezeve UV.

## Doni të eliminoni dhjamin?

Problemet shëndetësore jo gjithmonë janë të lidhura drejtpërdrejt me peshën. Kjo sepse ka shumë njerëz që janë mbipeshë, por nuk kanë probleme shëndetësore, ashtu siç ka edhe të tjerë që kanë peshë normale, por nuk iu numërohen dot problemet shëndetësore që kanë. Por... në momentin që rreth barkut fillon të 'shfaqet' yndyra, gjithçka komplikohet. Prandaj për të eliminuar shtresat e dhjamt në zonën e barkut, ju njohim me një përzjerje 'mrekullibërëse' që krijohet nga limoni, uji, soda e



bukës dhe majdanozi. Si ta përgatisni këtë përbërje? Për përgatitjen ju nevojiten: 1 kg limonë, 5-6 tufa majdanoz, 1 pako me sodë buke dhe 3 litra ujë.

Si fillim lani limonin dhe priteni në mes. Merrni një enë, mbusheni me ujë të nxehtë dhe hidhni sodë në të. Pastaj, në të njëjtën enë vendosni limonin dhe majdanozin për disa minu-

ta. Hiqeni majdanozin dhe limonin nga ena, prisni majdanozin në copa të vogla, edhe limonin gjithashtu. Merrni një enë tjetër dhe vendosni majdanozin dhe fetat e limonit. Hidhni 3 litra ujë dhe zieni përbërësit për rreth 2-3 orë.

Nga kjo përgatitje ju do të përftoni rreth 1.5 litra shurup, të cilin nëse e pini rregullisht për 15 ditë me radhë do të vini re rezultate habitëse. Rekomandohet të pihet esëll në mëngjes dhe vetëm një masë prej 100-200 ml. (E barabartë me një gotë rakie.)



## Dobitë mahnitëse të vajit të ullirit

Vlerat e vajit të ullirit janë provuar shkencërisht...Përdorimet e tij më efikase vihen re veçanërisht lidhur me kujdesin ndaj lëkurës. Përmbajtja e lartë e këtij vaji në acide yndyrore, përmendim këtu acidin oleik i cili ndihmon në rikthimin e 'lagështisë' natyrale të lëkurës.

Për më tepër, ky acid mbron membranat e qelizave ndërkohë që vitaminat, veçanërisht ajo E, luftojnë radikalet e lira. Në këtë mënyrë procesi i plakjes së lëkurës ngadalësohet. Ja disa nga përdorimet e vajit të ullirit:

**MASKË PËR LËKURË TË THATË...**Për këtë maskë përzieni 1 lugë gjelle me vaj ulliri, të bardhën e një veze, një lugë gjelle mjaltë dhe një lugë me tul avokado. Përbërjen e përfutur vendoseni në fytyrë dhe lëreni për 10 minuta. Rezultati do jetë i mrekullueshëm.

**USHQYES PËR DUART...**Hidhni disa pika vaj ulliri në duar dhe masazhoni lëkurën. Vendosni doreza plastike dhe lëreni vajin të veprojë për 15 minuta.

Publicitet

KOMUNA NAGORIÇAN I VJETËR  
Nr. 15-396 të datës 27.07.2017

Në bazë të nenit 35 paragrafi 3 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16), nenit 50 paragrafi 1 pika 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 5/02), nenit 95 të Statutit të Komunës Nagoriçan i Vjetër, Kryetari i Komunës Nagoriçan i Vjetër në vijim publikon:

### KUMTESË

**Për organizim të prezantimit publik dhe anketës publike në lidhje me** Projektin arkitektonik urbanistik për ndërtim të objektit për prodhim të kartonit në PK 3641, v.q Serava, KK Nagoriçan i Vjetër, komuna Nagoriçan i Vjetër, dokumentacion teknik nr. U-32/16 të përpiluar nga "URBAN GIS" SHPK - Kumanovë

Kufijtë e përfshirjes janë: PK 3641 KK Nagoriçan i Vjetër  
Përfshirja është me sipërfaqe prej 0,271504 ha.  
Anketa publike dhe prezantimi publik sipas Projektit arkitektonik urbanistik për ndërtim të objektit për prodhim të kartonit në PK 3641, v.q Serava, KK Nagoriçan i Vjetër, komuna Nagoriçan i Vjetër, do të realizohet me prezantim të projektit në sirtaret e komunës në lokalet e komunës Nagoriçan i Vjetër.

Anketa publike do të zgjasë 5 ditë pune duke filluar prej 31.07.2017 deri më 07.08.2017.  
Për kohëzgjatjen e anketës publike subjektet e interesuara fizike dhe juridike informacione më të detajuara mund të marrin në komunën Nagoriçan i Vjetër, departamenti për urbanizëm, veprimtari komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor.

Në afatin e theksuar, qytetarët dhe subjektet e interesuara juridike nga rajoni konkret të përfshirë me planin mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim, propozime dhe mendime në listat anketuese.

### PREZANTIMI PUBLIK

Më datë 01.08.2017 në ora 11:00 në sallën e Këshillit të komunës Nagoriçan i Vjetër organizohet prezantim profesional të Projektit arkitektonik urbanistik për ndërtim të objektit për prodhim të kartonit në PK 3641, v.q Serava, KK Nagoriçan i Vjetër, komuna Nagoriçan i Vjetër, dokumentacion teknik nr. U-32/16 të përpiluar nga "URBAN GIS" SHPK - Kumanovë

Kryetari i komunës  
Millovan Stojkovski

## URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221





Ne në Tokë "ndejmë" forcën e tërheqjes gravitacionale dhe praninë e saj, por nuk ndejmë fushën gravitacionale

Ishte Njutoni ai që bëri hapin më të madh në shpjegimin e Gravitetit. Sipas tij, forcat midis dy objekteve në tokë (p.sh. mollës dhe tokës) dhe ajo midis dy objekteve në univers (p.sh. Tokës dhe Diellit) janë të njëjta

A do të mundet njeriu të krijojë forcën gravitacionale artificiale? A do të mundet të shpjegojë shkakësinë e ekzistencës së kësaj force themelore të natyrës?

Hulumtimet mbi forcën gravitacionale i hasim që të grekët e lashtë, tek Aristoteli, sipas të cilit, çdo objekti që lëviz në natyrë, i duhet një forcë që vepron mbi të. Prirja e elementeve natyrore për t'u zhvendosur drejt qendrës së Tokës, përcakton dhe forcën shkakësore për lëvizjen e këtyre trupave drejt kësaj qendre. Ky është thelbi i gravitetit të Aristotelit, ku pranohet se trupat e rëndë bien me shpejtë se trupat e lehtë.

Këtë pikëpamje e hodhi poshtë Galileo Galilei, i cili duke lëshuar trupa me pesha (masa) të ndryshme nga kulla e Pizes, arriti në përfundimin se, kur nuk përfilltet rezistenca e ajrit, të gjithë këta trupa bien në toke në të njëjtën kohë.

Më vonë, ishte Njutoni ai që bëri hapin më të madh në shpjegimin e Gravitetit. Sipas tij, forcat midis dy objekteve në tokë (p.sh. mollës dhe tokës) dhe ajo midis dy objekteve në univers (p.sh. Tokës dhe Diellit) janë të njëjta.

Në fillim të shekullit XX, Albert Ajnshtaini hodhi idenë e tij të re mbi gravitetin. Sipas tij, hapësira përkulet nga një trup i rëndë duke krijuar një "gropë" apo "gjurmë" të ngjashme me një rrjetë elastike, mbi të cilën vepron një sferë me masë

# Misteret e gravitetit...



"m". Sa më e madhe të jetë masa e sferës, aq me e madhe është "gjurma" që formon mbi këtë hapësirë të lakuar. Sipas tij, efekti i Gravitetit është universal, ka gjithmonë veti tërheqëse, është i kudondodhur, dhe ai vepron mbi gjithçka pa dallim e me forcën e tij tërheqëse. Kjo e bën gravitetin të ndryshojë nga forcat e tjera themelore. Sipas Njutonit, masa i "tregon" gravitetit se si të krijojë forcën, dhe forca i "tregon" masës se si të përshpejtohet.

Sipas Ajnshtainit, masa "i tregon" hapësirës si të përkulet dhe hapësira "i tregon" masës se si të lëvizë. Për Njutonin, hapësira është e sheshtë, euklidiane dhe ekziston sistemi universal standard i referimit (pozicionimi i yjeve është fiks) në qetësi, në lidhje me hapësirën absolute, ndërsa për Ajnshtainin, hapësira mund të lakohet (përkulet) dhe gjithçka është relative.

Një parashikim i rëndësishëm i "Teorisë së Relativitetit" është ai i ekzistencës së valëve gravitacionale, apo valëzimeve në kohë-hapësirë e koz-

mosit. Albert Ajnshtaini thotë saktësisht se nëse këto vale gravitacionale janë ekzistonte duhet që "...ne saje të lëvizjes se elektroneve, atomet të rrezatojnë jo vetëm energji elektromagnetike, por edhe energji gravitacionale, ndonëse në sasi shumë të vogla".

Një nder misteret e fizikes është sesi ky gravitacion vepron mbi materien. Shkaku i ekzistencës së kësaj force mbetet sa hipotetik, aq edhe enigmatik. Sikur të mund të zbulohet efekti përgjegjës eksperimental i gravitetit, do të mundeshim ta kuptonim e ta njihnim më mirë atë.

Duke qenë se graviteti është një forcë apo manifestim i hapësirë-kohës se kudondodhur dhe vepron në një trajtë të pavarur nga forcat e tjera themelore, kjo do të thotë se ai vepron në një formë të pavarur mbi materien, duke u përfaqësuar nga një fushë graviteti e cila vepron mbi materien (mikroskopik), por nuk varet prej saj, në kundërshtim me forcën e cila varet nga masa që lakon

kohe-hapësirë në lidhje me të. Fusha gravitacionale ndikon mbi materien ndërsa forca gravitacionale varet nga masa (materiale e lendes) apo materia e lëndës, trupit, etj.

Konceptet fushë gravitacionale dhe forcë gravitacionale, pavarësisht se janë të të njëjtit manifestim të hapësirë-kohës, janë të ndryshme nga njëra-tjetra, për nga veprimi dhe vetitë mbi materien, ndërkohë që janë edhe të ndara nga forcat e tjera themelore. Në sistemin ku reflektohet prania e forcës së gravitetit, nuk mund të reflektohet prania e fushës së gravitetit për një vëzhgues të dhënë, në praninë e forcës apo të fushës dhe e anasjelltas.

Përshebull: Ne në Tokë "ndejmë" forcën e tërheqjes gravitacionale dhe praninë e saj, por nuk ndejmë fushën gravitacionale. Ndërsa grimcat e valëve diellore që bien mbi fushën e gravitetit të tokës, "ndejmë" fushën gravitacionale, por nuk "ndejmë" forcën e gravitetit.

Pra, forca gravitacionale është një manifest-

tim dukurie fizike në sistemin makroskopik, ndërsa fusha gravitacionale është një manifestim dukurie fizike në sistemin mikroskopik, por të dyja janë të kudo ndodhura dhe veprojnë në kuintesence ne raport me njëra-tjetrën.

Kemi një parim përcaktueshmërie "gravitet-fushë gravitacionale", pra nuk mund të evidentohet njëkohësisht dhe fusha gravitacionale edhe masa kuantike (apo grimca përgjegjëse për gravitetin), nëse ekziston gravitoni si grimce hipotetike e pa zbuluar me masë zero dhe spin (2) nuk mund të evidentohet gravitoni për një kohë të dhënë të barabarte, kur evidentohet fusha e gravitoneve, po aq sa nuk mund të evidentohet fusha e gravitoneve për një kohë të dhënë të barabarte kur evidentohet masa e gravitonit si pikë materiale grimcore, përgjegjëse për forcën themelore të natyrës: Gravitonin.

Nëse njeriu mund të krijojë një fushë elektromagnetike thjeshtësisht në formë eksperimentale, a do të mundet në të ardhmen të krijojë një fushë gravitacionale-artificiale? Përpjekjet e shkencëtarëve për të minimizuar misteret e kësaj fushe të fizikës se "gravitetit" janë të shumta, edhe pse rezultatet e pritura janë jo aq të kënaqshme, ndonëser përpjekjet nuk reshtin se ndaluri për t'i dhënë përgjigjen përfundimtare të shkakësisë së gravitacionit dhe origjinën e kësaj force themelore të natyrës.



## Kushtet e formimit të supernovave...

Fillimisht, Universi ishte shumë energjik që të mund të formoheshin yjet. Por teksa Universi u zgjerua dhe u ftoh, u bë i mundur për formimi i grumbujve të gazit. Ka një sugjerim që vjen nga sateliti "European Planck" se kushtet bënë të mundur formimin e yjeve brenda 500.000 viteve nga Big Bengu, por ka pasiguri në lidhje me këto vite të hershme. Si teleskopët hapësinorë dhe ashtu edhe detektorët e mikrovalëve kozmike, do të na ndihmojnë të zbulojmë më shumë në lidhje me historinë e hershme të Universit.

### Mekanika e Supernovave

Edhe pse ka teori se si funksionojnë supernovat, nuk ekzistojnë prova të mjaftueshme për të qenë të sigurt se ato janë të sakta. Për shembull, yjet neutrone largohen pas një shpërthimi supernova me shpejtësi të lartë, por askush nuk e di pse shpërthimi duhet të favorizojë vetëm një drejtim. Disa nga vëzhgimet më të dobishme mbi supernovat vijnë nga teleskopët hapësinorë me rreze X dhe gama si Chandra dhe Nustar, të cilët vazhdimisht shtojnë të dhënat që mund të na ndihmojnë të kuptojmë këto shpërthime masive yjore.

### A ka një popullatë të tretë yjesh?

Yjet klasifikohen në Popullatën I (ku futen ata që janë të pasur në metale) ose Popullatën II (të varfër në metale). Popullata e yjeve të vjetër në kategorinë e dytë, përmban më pak elemente të rëndë, për shkak se yjet e rinj të popullatës së parë fitojnë elementë të rëndë nga supernovat. Megjithatë, modelet kozmologjike sugjerojnë se duhet të ketë edhe popullata të mëdha yjesh të lashtë III, të përbërë thuajse tërësisht nga hidrogjeni dhe heliumi, dhe të formuar shumë shpejt pas Big Bengut. Këto lloj yjesh janë ende për t'u zbuluar, por teleskopi hapësinor Xhejms Ueb - që do të lëshohet në vitin 2018 - mund të ndryshojë gjithçka.



## A ekzistojnë universet paralele?

Të dhënat astrofizike sugjerojnë se hapësirë-koha mund të jetë "e sheshtë", në vend se e lakuar, dhe kështu që ajo vazhdon përgjithmonë. Nëse është kështu, atëherë rajoni që ne mund të shohim (dhe që e mendojmë si "universi") është vetëm një hapësirë e vogël në një univers pafundësisht të madh. Në të njëjtën kohë, ligjet e mekanikës kuantike, diktojnë se ka vetëm një numër të caktuar konfigurimesh të mundshme të grimcave në çdo hapësirë kozmike (10 në fuqi të 10 në fuqi të 122 të mundësive të dallueshme).

Pra, me një numër të pafundmë pjesëzash kozmike, rregullimet e grimcave brenda tyre janë të detyruara të

përsëriten - pafundësisht shumë herë. Kjo do të thotë se ekzistojnë pafundësisht shumë universe paralele: pjesë kozmike të ngjashme me tonin, si edhe pjesë që dallojnë vetëm nga pozicioni i një grimce, ato që ndryshojnë nga pozicionet e dy grimcave, e kështu me radhë deri në hapësirat që janë krejtësisht të ndryshme nga e jona.

A ka diçka të gabuar në këtë logjikë, apo rezultati i saj i çuditshëm është i vërtetë? Dhe nëse është e vërtetë, si mund të zbulojmë ndonjëherë praninë e universeve paralele? Shikoni këtë perspektivë të shkëlqyer nga 2015, që shqyrton se çfarëdo të thotë termi "universe të pafundme".

## Misteret e Iliadës...

Siç e dinë mirë brezat e shumta të nxënësve, vepra letrare përgjegjëse për katapultimin e historisë së Luftës së Trojës në imagjinatën kolektive të botës, është "Iliada". Kjo poezi epike greke është një nga më të famshmet në të gjithë historinë, por origjina e saj është e mbuluar me mister. Në qendër të gjëzës qëndron poeti të cilit i është atribuar tradicionalisht libri: Homeri. Ishte i verbër? A ishte Iliada produkt i imagjinatës së tij, apo ai po regjistronte një histori të vjetër, që ishte përcjellë gojarisht nëpër shekuj? A mos nuk kishte vetëm një Homer, por disa, që e shkruan legjendën në bashkëpunim? Nuk do ta dimë kurrë. Por mund të jemi mjaft të sigurt, se Iliada nuk u shkrua në kohën e ngjarjeve që ajo përshkruan (në epokën e vonë të bronzit), por diku midis 750 dhe 650 para Krishtit. Strukturat

shoqërore feudale që përshkruan Homeri mbajnë të gjitha shenjat daluese të asaj periudhe, ndërsa disa nga armët që përdorin heronjtë e tij, nuk kishin ardhur në Greqi deri në fundin e Epokës së Bronzit. Pavarësisht gjithë pasigurisë që rrethon Iliadën, nuk ka asnjë dyshim për ndikimin e saj të madh në letërsinë perëndimore - dhe, më konkretisht, atë britanike. Nga shekulli i 12-të, poema kishte depërtuar në kulturën britanike në një masë të tillë që, në historinë e tij të mbretërve të Britanisë, Geoffrey i Monmouthit shkruante se ishulli u themelua nga Bruti, pasardhës i heroit të Trojës, Eneas. Një vlerësim edhe më i madh erdhi kur, shkrimtari ndoshta më i madh i të gjithëve, Uilliam Shakespeare, krijoi veprën e tij "Troilus dhe Cressida", përreth një historie tragjike dashurie, me në sfond Luftën e Trojës. (bota.al)





## DASHI (20/III-20/IV)



Dita është e përshtatshme për punë të ndryshme, kultivim të bimëve apo kujdes për persona të moshuar. Janë shtuar gjasat që të zgjidhni një problem lidhur me trashëgimi, pension apo sigurim jetësor. Nëse keni shtëpi të madhe dhe obligime të shumta, mendoni për atë që të merrni një ndihmë.

## DEMI (21/IV-20/V)



Mund t'iu nënshtroheni paragjykimëve kur bëhet fjalë për dashurinë dhe thellë në zemër të mbyllni sekretin i cili po iu mundon. Megjithatë do të jeni të vetëdijshëm se sekretin mund të dalë në sipërfaqe atëherë kur më së paku e pritni duke sjellë hutim edhe më të madh sesa që pritët të jetë.

## BINJAKËT (21/V-20/VI)



Do të liroheni nga disa dyshime afariste dhe financiare. Nëse jeni duke pritur ndonjë porosi, ftesë apo marrëveshje, vetëm edhe pak durim se do të realizohet. Do të kënaqeni në shoqërinë e miqve të vjetër, vetëm kujdes që mos t'ia teproni me alkool dhe kalori.

## GAFORRJA (21/VI-22/VII)



Në aktivitetet e punës do të dëgjoni intuitën apo do të shërbehni me një kanal të fshehtë dhe lidhjen e fshehtë nga publiku. Më shumë vëmendje do t'iu kushtoni sporteve të ujit, megjithatë kini kujdes edhe nga disa fatkeqësi të fshehta.

## LUANI (23/VII-22/VIII)



Është theksuar nevoja për butësi, kujdes dhe përkrahje. Ndonëse do të flirtoni në mënyrë pak teatrale, rezultatet e mira nuk do të mungojnë. Do të ndjeheni më mirë në shoqërinë e të huajve sesa të njohshmëve dhe më këndshëm do të ndjeheni me miqtë sesa familjarët.

## VIRGJËRËSHA (23/VIII-22/IX)



Më shumë kohë të lirë do t'ua kushtoni obligimeve familjare, e ka mundësi të ndodh edhe një vizitë e një personi më të moshuar. Nëse takoheni me dashurinë e vjetër në ju do të zgjohet përsëri flaka e vjetër. Vështrë do të ballafaqoheni një trazim që do të ndajeni e analizat racionale do t'iu shërbejnë fare pak.

## PESHORJA (23/IX-22/X)



Konstruktimi jostabil financiar do t'iu nxjerr shumë telashe. Nuk do të mundni të përmbaheni nga shpenzimet ndonëse do të jenë të vetëdijshëm se kursimi është mënyra e vetme që të dilni nga borxhet njëherë e përgjithmonë. Nëse jeni të ftuar në ndonjë kremtë, mos blini dhuratë e cila do të jetë mbi mundësitë tuaja.

## AKREPI (22/X-21/XII)



Mund të prisni ngjarje interesante në dashuri. Do të gjendeni në një shoqëri të madhe në të cilën do të jenë disa persona që do t'iu kushtojnë vëmendje. Do të keni rastin që ta argëtoni partnerin me një dhuratë apo ju vetë do të gjendeni në situatë të tillë si mirënjohje për disa shërbime paraprake.

## SHIGJETARI (22/XI-21/XII)



Në planin emocional turbulencat do të jenë shumë të fuqishme, ndërsa rezultati i ngjarjeve është i panjohur. Në një mik të afërt do të gjeni ngushëllim, mbështetje dhe përkrahje. Gatishmëria e tij që t'iu dëgjojë, si dhe vërejtjet e mira do t'iu ndihmojnë që të qetësoheni dhe të gjeni një zgjidhje të pranueshme.

## BRICJAPI (22/XII-20/I)



Pavarësisht nga disa situata stresuese dhe pakënaqësisë e cila po iu përcjellë, nuk do të ndryshoni disponimin. Do të hulumtoni, do të bëni pyetje dhe do të njiheni me njerëz të ri. Me gatishmëri do të përdorni ndikimin e disa njerëzve në pozitë për të përmirësuar statusin tuaj shoqëror dhe afarist.

## UJORI (20/I-19/II)



Do t'iu pushtojë një stres i ndjeshëm dhe dëshira që t'iu rezistoni situatave të pakëndshme në dashuri. Do të mendoni se liria mund t'iu sjellë shumë më shumë kënaqësi sesa çfarëdo lloji lidhjes. Nëse jeni vetëm, do t'iu tërheq shumë një person i panjohur. Shikimet do të flasin më shumë se fjalët.

## PESHQIT (20/II-19/III)



Mos e lini t'iu ikë një dalje në mbrëmje, sidomos nëse jeni të lirë. Do t'iu bie në sy një person atraktiv e interesimi do të jetë i dyanshëm. Nëse udhëtoni jashtë kufijve, nuk do të kënaqeni vetëm me atraksione turistike dhe argëtim-shumë kohë do të shpenzoni edhe në shopping.



KOHA	BABAI I AKTORES NË FOTO, ÇAPLIN	Ç	LLOJ QENI, RETRIVER	REGJISOR AMERIKAN (VELLAU I XHULIUS STERNIT)	FILM ME AKTOREN NË FOTO	KËNGËTARI DEDA PARAFJALË GJERMANE	Mensur Mamuti	MONEDHA E HUNGARISE AKTORJA NË FOTO	F	FILM ME AKTOREN NË FOTO	PORTIERI SHQIPTAR, LIKA
KAFSHË ENGLASHME ME HARDHUCËN, PIKELORË											GRUP UDHËSASH KORALE NË SEJSHËLE
SATELITI										SHKRONJA E FLUT-DIT DHE E PARË BASKETBOLLISTIA PORTORIKANE, TAPIA	
AUTORI FRËNG, KAMY							IFSHËHTË IMPULSI				
KËNGËTARIA ANGLEZE, MEK KOLL							FUTBOLLISTI SPANJOLL, HERNANDEZ JODI				
SQUFURI		HYJNËSHA GREKE E HAKMARRJES PIKTORI YNË, KALESHI					NJË MUAJ VITI AKADEMIKU ALI				
KOHA	QYTET NË UKRAINË ISH GRUP MUZIKOR SUEDEZ						SHPËRBLIMI NË TË HOLLA, RROGA				
JO MORAL							QYTET NË FRANCË LËVIZIA RELATIVE				
KRYEQYTETI I ZVORËS						PARAARDHËSI YNË KALIJMI					TEMPERATURA CELSIUSI
FLORIRI				DORËSHTRËNGUAR, KOPRACE							

ZGJIDHJET: F, XHODI, EROL, RIKI, ANTO, Ç, ELTON, SALAMANDËR, TRABANTTI, ZHA, ALBER, INTIM, KIRSTI, ÇAVI, S, ATE, JANAR, ODESA, PAGA, AMORAL, LION, BERN, IIR, T, ARI, KURNACE.

## Sudoku


shumë i lehtë

shumë i vështirë

1		3						8										
	3	2				1	5		7		8		3	2	1			6
	6			1			3			1	4	6		8	7	9		
5				7	2			4		6	3			9		1		
6			5		4			2										
			1	3						7		4			3	5		
	8			5				7		2	6	8		5	9	3		
	5	9				6	8		8		7		9	3	2			5
7			9					5										

Shumë i lehtë: 145369728, 932748156, 867215439, 591872364, 673594812, 428136597, 284651973, 359427681, 716983245. Shumë i vështirë: 692741583, 758932146, 314658792, 263589417, 485317629, 971426358, 126875934, 847193265, 539264871.





## Si të shkurtoni kohën e larjes së rrobave

Kur vjen puna tek larja e rrobave, pjesa më e madhe e njerëzve thjesht ndjekin udhëzimet e paketimit të detergjentit. Por guruja australiane e pastrimit, Shannon Lush, thotë se kjo është e gabuar. Shannon ka rrefyer disa truke për të përshtetur procesin e larjes, dhe do të habiteni me to. Ajo thotë se gjëja me e rëndësishme që duhet të dini është se më shumë detergjent nuk i bën të më pastra rrobat tuaja. "Sapuni është me bazë yndyrnash. Kur fije kanë kontakt me caq shumë, tërheqin papastërtinë", thotë Shannon duke shpjeguar se sasia e tepërt i bën rrobat shumë shpejt më të papastra. "E dini kur peshqirët pasi i keni larë janë si me gjemba? Kjo ndodh për shkak të sasisë së madhe të detergjentit pasi ka yndyrë. Është si gjalpi kur e hedh në një tigan të ngrohur shkrin, dhe pasi ftohet forcohet prapë", vijon ajo. Për pak rroba rekomandohet 1/8 e matësit, ndërsa kur keni shumë rroba për të larë, rekomandohet 1/4 e tij. Për rezultate më të mira Shannon rekomandon të shtoni dy lugë gjelle sodë bikarbonat dhe dy lugë gjelle uthull në çdo larje. "Përdorni uthull të bardhë në vend të aromatizuesit të rrobave, aromatizuesi nuk punon gjithmonë. Ai ka bazë vaji, dhe gjithçka që bën është që përhap vajin në larje. Hidhni më mirë uthull dhe sa zbutës, e mbi të gjitha nuk lë aroma", thotë Shannon. Shannon thotë se njerëzit ankohen gjithmonë se rrobat nuk kanë erë dhe për këtë arsye e përdorin zbutësin. Por mund ti shtoni vaj esencial, por një sasi shumë të vogël, vetëm një pikë esence livandoje. Shannon thotë se kjo metodë shkurton edhe kohën tharjes me një të tretën. Një tjetër truk për të shkurtuar kohën e tharjes është shtimi i një pecete me robat e lagura. "Unë e urrej tharësen e rrobave, siç mund ti përdorin disa. Një pecete e thatë me robat e lara dhe ato do të thahen tre herë më shpejtë."

## George Clooney çon në gjykatë fotografimin

Paparacët mund të ndihmojnë për katalpultim drejt famës, por ndonjëherë i kalojnë caqet dhe këtë George Clooney e provoi mbi shpatulla, kur revista franceze "Voici" publikoi fotot e para të binjakëve të tij, pa e marrë pëlqimin e aktorit. I acaruar, ylli i "Ocean's Eleven" ka vendosur ta çojë çështjen në gjykatë. Clooney thotë se fotografi i "Voici" kaloi murin rrethues të rezidencës së tij, është ngjitur në një pemë të oborrit dhe ka shkrepur aparatun, duke i bërë në mënyrë të paligjshme foto fëmijëve, ndërkohë që ndodheshin brenda perimetrit të shtëpisë. Revista, sipas tij, do të japë llogari deri në një, përpara gjykatës. "Është siguria e fëmijëve të mi në lojë", shprehet 56 vjeçari. Aktori i famshëm dhe



bashkëshortja e tij, avokate e njohur dhe n j e k o h e s i s h t mbështetëse e të drejtave të njeriut, Amal, e njoftuan në muajin qershor ardhjen në jetë të dy fëmijëve të tyre, një djalë dhe një vajzë, Alexandër dhe Ella.

Por deri më tani nuk kanë dhënë asnjë detaj tjetër mbi të miturit, e as kanë publikuar ndonjë foto të tyre. "Voici" i kishte të premtin në kopertinë fotografitë e çiftit të veshur me rroba

plazhi, duke mbajtur secilin në krah nga një foshnjë. Ata duket se po ecin në kopshtin e Vilës së Clooneyt, pranë liqenit Como, në Itali. Binjakët janë fëmijët e parë të bashkëshorteve Clooney, që lidhën kurorë tre vjet më parë në Venecia, në një ceremoni madhështore, të mbushur me emra të famshëm të ekranit, por që prej atëherë janë përpjekur ta mbajnë jetën e tyre private sa më larg syve të publikut.

## Gjobë kush kalon rrugën me celular në dorë

Honoluluja është bërë qyteti i parë i madh në SHBA, që i ndalon këmbësorët të shohin telefonat celularë, të dërgojnë mesazhe, apo të përdorin çfarëdo pajisjeje elektronike, ndërsa kalojnë rrugën. Masa, që hyn në fuqi në tetor në kryeqytetin e Hauajit, ka si qëllim që të parandalojë lëndimet, madje edhe vdekjet që vijnë si pasojë e të ecurit të pakujdesshëm. Shkelja e parë e ligjit gjobitet deri në 35 dollarë, ndërsa përsëritësit deri në 100 dollarë. Ligji u firmos nga kryebashkiaku i Honolulu, Kirk Caldwell, pasi u miratua nga Këshilli Bashkiak me 7 vota pro dhe 2 kundër. Sipas legjislacionit të ri, asnjë këmbësor nuk do të kalojë



rrugën, apo autostradën, duke parë një pajisje portative elektronike. Përjashtim bën rasti, kur këmbësori i telefonon urgjencës apo policisë. Ligji, sigurisht që ka pasur kundërshtarët e tij, që thonë se autoritetet po e teprojnë me këto rregullore. Ndërsa të tjerë janë ankuar se ligji duhej të ishte më i rreptë, pasi përdorimi i celularit duhet ndaluar edhe për ata që ecin

në trotuar. Statistikat thonë se, nga viti 2000 deri në 2011-n, në SHBA u lënduan 11.100 njerëz për shkak të të ecurit të pakujdesshëm, ndërsa përdornin telefonin celular. Nuk ka raporte për vitet në vazhdim, por analistët thonë se shifrat duhet të jenë shumë më të larta, për shkak të rritjes së jashtëzakonshme të përdorimit të pajisjeve elektronike për komunikim.

## KALENDARI HISTORIK 31 KORRIK

- 431 - Zgjedhet Pope Sixtus III.
- 781 - Erupcioni më i vjetër i evidentuar i vulkanit Mt. Fuji (Data tradicionale japoneze 6 korriku, 781).
- 904 - Thessalonica bie në duart e arabëve të cilët shkatërrojnë qytetin.
- 1009 - Pietro Boccapecora bëhet Pope Sergius IV.
- 1451 - Jacques Cœur arrestohet me urdhër të mbretit Charles VII i Francës.
- 1703 - Daniel Defoe vendoset në pillory për shkak të krimeve.
- 1741 - Mbreti Charles Albert nga Bavaria okupon Austrinë e sipërme dhe Boheminë.
- 1930 - Emetohet për herë të parë radio programi The Shadow.
- 1945 - John K. Giles tenton të arratiset nga burgu Alcatraz.
- 1951 - Themelohet kompania Japan Airlines.
- 1971 - Programi Apollo: Astronautët e misionit Apollo 15 bëhen të parët që kanë ecur në lunarn rover.
- 1981 - Vdes Omar Torrijos në rrëzim aeroplani.
- 1996 - MIL-STD-1750A dekarohet joaktiv për përdorim në dizajn të ri.
- 2006 - Fidel Castro i le pushtetin përkohësisht vëllait të tij Raúl Castro.

## A E DINI SE...



Janë 22 vje në logon e kompanisë së madhe të filmit Paramount pictures

Në letrat e bixhozit mbreti me zemër është i vetmi pa mustaqe



Gjëja më e shpeshtë që harrohet nga njerëzit kur nisen për udhëtim është brusha e dhëmbëve.

## BARSOLETA



Sarma!

Avninë n' mahalle t'vet gjithmone e kishin thirr 'sarme'! Ni dit ai prej inatit e vran njanin. E lajmrojne rastin ne polici edhe e arrestojne. Gjate seances me deshmitar, kish qillu edhe njani qe e kish pa vrasjen. Avokati: Zotri X, pse ka ndodh vrasja. Deshmitari: Ket djaloshin ktu krejt e kan thirre... (tu u tut) e kan thirre... (gjen zgjidhje)... a e din kur e merr ni flet t'laknes edhe e mush me oriz e me mish? Avnia: Pshtille pshtille n'ta majt...

## THËNIA E DITËS

Më mirë është të ecim vetëm, sesa me turmën në drejtim të gabuar.

Herman Siu

